ADN-ja E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

Monografi letrare

Ideoi dhe përgatiti për botim

HALIL RAMA – Mjeshtër i Madh

Titulli:
ADN-ja E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT
Monografi letrare

Autor:
Halil Rama – Mjeshtër i Madh

Redaktor:
Prof. Bujar KAPEXHIU - *Nderi i Kombit*

Recensent:
Sakip CAMI

Konsulente:
Margarita XHEPA – *Nderi i Kombit*

Arti grafik:
Dashamir Vraniçi

ISBN
978-9928-367-09-9

Shtëpia Botuese
STREHA

Në 81-vjetorin e lindjes - Kushtuar shkrimtarit Shefki Karadaku të vlerësuar "një Esenin shqiptar" nga Moikom Zeqo dhe "Khajami i ditëve tona" nga Dr.Lutfi Turkeshi

I

PROFILI & REPORTAZHI & INTERVISTA

PROFILI

ADN-ja E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

https://fjala.al/2022/03/12/adn-ja-e-pandryshuar-e-shefki-karadakut/

• Dr. Lutfi Turkeshi, gazetar & studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e *vlerëson Shefki Karadakun si "Khajamin e ditëve tona".* Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet "Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panagjerikus" e të tjerë, dhe vëllimet poetike "Kënga e karrove të drithit", "Melodi të Shkumbinit", "Ylberi", "Lumi me njëqind zemra" e "Feniks" të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t'i nënshtrohej jetës edhe pse e vuante atë…

• Para pak kohësh, u botua në anglisht romani i Shefki Karadakut "PUTHJA E NGRIRE", nga një kopje e të cilit ju dhurua selive te huaja diplomatike në Tiranë. Dhe menjëherë vjen vlerësimi i ambasadorit gjerman Peter ZINGRAF për këtë roman tejet të arrirë që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar nga personalitete të botës letrare të kryeqytetit….







Në një shtëpi karakteristike, të lagjes Spahikorre, të qytetit të Elbasanit, 81 - vjet më parë lindi, mori shkollimin bazë dhe nisi rrugëtimin e jetës Shefki Karadaku, i cili ndër vite do të bënte emër si një nga poetët e prozatorët më të mirë në rang kombëtar. Këtë lagje, si dhe gjithë Elbasanin ai e konsideronte ADN-në e tij të pandryshuar. Në memorien e tij, sa qe gjallë, ruhej Spahikorrja e fëmijërisë, për të cilën me të drejtë pikëllohej kur e shihte se si është dëmtuar…, ruheshin banesat e traditës, të mbetura ende tashmë, si një dëshmi që dënon dhe akuzon!

I zhytur në nostalgjinë e kohës, ish - mësuesi dhe shkrimtari i talentuar rrëfente mjeshtërisht**:** "Ne, në Spahikorre i adhuronim pemët, veçanërisht ullinjtë; unë si poet, ca më shumë dhe, si të isha një druid i vërtetë, i kam kushtuar edhe një vjershë të veçantë njërit prej ullinjve të Spahikorres. Pale pastaj, shelgjeve dhe karakafteve hijerënda, apo shtegtimit magjepsës të shpendëve!". Mjafton qoftë dhe ky rrëfim i çiltër për të konkluduar se Shefki Karadaku, megjithëse një familjar i rregullt dhe përgjithmonë i obliguar, shpirtin e kishte prej bohemi të çliruar dhe të papërmbajtur.

Siç shkruan bashkëkohësi i tij Enver Kushi, brenda korpusit letrar, Shefki Karadaku ka sendërtuar shtëpinë e shpirtit të tij buzë Shkumbinit, atje ku *"ylberi ka rënë mbi brigjet e trishtuara"*.

Dhe kjo shtëpi e shpirtit të poetit, ka mbledhur brenda stinët dhe qiejt e Elbasanit, shirat zemërak, çeljen e karakafteve, zërat njerëzor, jehonat e largëta të fëmijerisë, këngët e Isuf Myzyrit, kuajt e hazdisur, kopshtijet e vendlindjes, nënën dhe babain, Nadiren dhe mallin për Çamërinë, Dorianin dhe Albanën, fëmijët e tij.

Shtëpia e shpirtit të tij...

Në këtë shtëpi të shpirtit të tij vijnë erërat e vjeshtës *"të m'i krehë flokët kaçurrelë"* apo ulen dhe ngrihen lejlekët. Përqark saj *"qielli plot me re i leckosur vjen"*. Dhe kur heq çatinë e kësaj shtëpie shpirti, poeti sheh *"qiellin plot me re që i leckosur vjen përqark..."*

Dhe, kur hap dritaret e kësaj shtëpie, shpirti, bashkë me valët e Shkumbinit që *"përplas jehonën e planetit"*, vjen Nadirja që i *"sjell erën çame si bukuroshe e magjishme"* dhe

"gëzimet misterioze të një atdheu të braktisur".



Në laboratorin krijues të Shefki Karadakut gjen një arsenal veprash krijuese**.** Nga "Kënga e karrove të drithit" te "TORAKS", ky krijues brilant prodhon emocione të freskëta, me origjinalitet të këndshëm e të besueshëm që gjelbërojnë humanizëm, me mesazhe befasuese, të ndjeshme e me sens dashurie njerëzore.

Karrierës së tij krijuese prej pesë dekadash, i shtohen gjithashtu edhe disa muaj të paharrueshëm që i kaloi në një fshat të humbur të rrethit të Elbasanit, kur jepte mësim në një shkollë fillore.

Studjuesi dhe analisti i zellshëm i veprës së tij letrare, Bardhyl Ajazi, në monografinë : "Elbasan, i bukur Elbasan" (*me syrin e poetit Shefki Karadaku*), ndër të tjera shkruan: "….Shefki Karadaku i perkiste një familjeje të mirëfilltë intelektuale. Babai i Shefkiut, Xhaferr Karadaku ishte një arsimtar, që pasi mbaroi atë të bekuar Normale gjithë jetën

ia kushtoi mësuesisë. Nëna e Shefkiut, Adile ishte një grua e kulturuar dhe arsimdashëse. Ajo bëri shumë sakrifica për shkollimin e fëmijëve të saj. Vëllai i Shefkiut, Astriti mbaroi studimet për gazetari dhe punoi për shumë vite në organet kryesore të shtypit. Motra e Shefkiut, Natasha, mbaroi studimet për mësuesi dhe punoi për shumë vite në arsim. Pra, Shefkiu, në detyrën e arsimtarit ishte në fushën e vet, ishte në botën e librave. Janë ato vite kur ndjeu shijet e para të kënaqësisë së heshtur krijuese, nga skicat, tregimet, reportazhet, monografitë historiko-letrare, për të vijuar pastaj për 20 vite në revistën prestigjioze "Ylli", si një nga zërat më të spikatur dhe si mbështetësi real e kurajoz i letrarëve të rinj nga i gjithë vendi.

FJALA KULTurë

E SHTUNË 12 MARS 2022
www.fjala.al

ADN-JA E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

Në 1-vjetorin e vdekjes dhe 81-vjetorin e lindjes të shkrimtarit

NGA HALIL RAMA

Vlerat aktuale në një studim madhor mbi gjendjen kishtare mesjetare në Kosovë

Vështrim analitik mbi librin studimor të dr.sc. Besim Morina "Gjendja kishtare në Kosovë në periudhën parasmane shek. VII-XV", LB, Prizren, 2020

NGA FATMIR MINGULI

Sapo doli nga botimi në vitin 2020, libri i dr. sc. Besim Morinës mbi një problem tejet delikat, një problem i parrahur mirë më parë, atë të gjendjes social-kishtare të mesjetës, mendoj se ishte një ngjarje në botën shkencore jo vetëm për Kosovën, por për gjithë trojet shqiptare.

Ky libër ka vlera unikale, dhe patjetër është një botim në rrjedhë të botimeve të prof. dr. Jahja Drançollit e disa studjuesve të tjerë. Dr. sc. Besim Morina ka patur një guxim të tejskajshëm që ka marrë përsipër botimin shkencor të këtij libri.

Pse e them këtë? Sepse jo vetëm në Kosovë por edhe në Shqipëri të pakta janë botimet për jetën sociale të mesjetës.

VIJON NË FAQEN 11

Pothuajse Njeri

Moderniteti në romanin e Agron Kostës "Pothuajse njeri".

NGA QAZIM SHEHU

TË MËDHENJTË E LETRAVE PËR KARADAKUN...

Shefki Karadaku me korpusin e tij letrar, ka hyrë denjësisht në historinë e letërsisë shqipe. Një bilanc më konkret e gjejmë tek libri "Absurdi Mbretëror" – (*Shënime kritike, ese, këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut)*, në të cilin autori i 35 veprave letrare në prozë e në poezi, portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës së tij. Gjejmë në këtë libër kolosët e letrave shqipe: Dritëro Agolli, Llazar Siliqi, Petro Marko, Adriatik Kallulli, por dhe personalitete të njohura të letrave shqipe, si: Moikom Zeqo, Roland Gjoza, Riza Lahi, Petraq Risto, Agim Cerga, Milianov Kallupi, Dr.Lutfi Turkeshi, Faruk Myrtaj, Sazan Goliku, Halil Rama e Sakip Cami, të cilët vlerësojnë maksimalisht veprën letrare të Shefki Karadakut ndër vite. Në librin "ABSURDI MBRETËROR", botuar në 75-vjetorin e lindjes së shkrimtarit, Bardhyl Ajazi ka përmbledhur artikuj kritikë dhe esse. *(Këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadaku*t).

Dhe nëse patriarku i letrave shqipe, **Dritëro Agolli** vlerëson konceptimin popullor të realitetit në përmbledhjen "Melodité e Shkumbinit" të Shefki Karadakut, ku evidenton gjuhën e pasur të vargjeve të tij të ngjashme me motivet popullore, si "*Vajza e mullixhiut", "Nata e fundit e aksionit*" e të tjera, **Kallulli** shprehet për pleksjen bukur e me forcë të ngjyrave, e heroikes me tragjiken, të fëlligështisë e dobësisë

morale të armiqve të egër. **Adriatik Kallulli** për një nga poezitë më të njohura shkruan se "Poezia e Shefki Karadakut është në shumë raste një poezi pikturë, ai e ndien që lexuesit i duhet shprehur në një mënyrë të tillë që të parafytyrojë me kthjelltësi atë që ka parë njëherë poeti". Shembulli tipik për këtë është poezia "**Kënga e karrove të drithit**", ku gëzimi për korrjen, për bollëkun e grurit shprehet me një kuadër plot lëvizje:

"Kur të fillojë të bredhë nesër dielli,/Në largësinë e fushës, si lejlek,/Atëherë, pas karrove të drithit,/Udhën e kaltër të arave do ndjek....."

Po ashtu, poeti ynë **Llazar Siliqi** do të shprehej se, "kur më 1967 Shefki Karadaku doli me vëllimin e tij të parë, '**Këngën e karrove të drithit'**, ne u gëzuem që radhët e poetëve shqiptarë u shtuan me një poet të ri, me një lirik të qetë e të ambël, me ndjenja të holla, me dorë piktori të akuarelit".

Ndërsa shkrimtari i madh **Petro Marko**, pasi ka lexuar novelën e Shefki Karadakut, të titulluar **"Rrugët e para**" shprehet: "Sikur ta kishte këtë botim në vargje dhe ta kishte pagëzuar po me këtë emër, ne përnjëherësh do të thoshim: poeti, pasi njeh rrugët e para të jetës, ka zbuluar në to fenomene dhe tinguj, ose ngjyra të reja dhe tani po na i dhuron me dashuri…."

Dr. Lutfi Turkeshi, gazetar & studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e vlerëson Shefki Karadakun si ***"Khajamin e ditëve tona"***. Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet "Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panagjerikus" e të tjerë, dhe vëllimet poetike "Kënga e korrave të drithit", "Melodi të Shkumbinit", "Ylberi". "Lumi me njëqind zemra" e "Feniks" të poetit e shkrimtarit Shefki

Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t'i nënshtrohej jetës edhe pse e vuante atë…

"Si feniks, shkëlqen me ide kuarci duke ndërtuar "udhë betoni"... I tillë është poeti Shefki Karadaku. Tërë vargjet e poemës 'Feniks' janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm... Ka poeti edhe idilin e vet të vendlindjes që është "***... me çuka, rrape-qiparisa dhe subtropiku mund t'i flasë qershisë, por jo ajsbergë..***.". Por, ka poeti edhe dashurinë e shprehur si Naimi e Çajupi: '***Të këndoj ty bukuroshe si alku, unë s'jam poet i vjetër melik, po zemra po aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik...'***, që pastaj të vijojë: '***Po zemra e kërkon nudon e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun floride të përqeshë...'***. Si të përfundojmë?! Shkurt, poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa më shpesh ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh. Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë", -shkruan ***Dr. Lutfi Turkeshi-Gazetar, studiues ("IDENTITETI SI KATARZË" - Gazeta "Fakti", 8 mars 2001, Shkup).***

Petraq Risto si redaktor i romanit "Puthja e ngrirë" vlerëson ndërthurjen plot dritë dhe hije, si një afresk bardh e zi nga autori, të lirizmit, heshtjes, frikës, rebelimit, ankthit, jetës, dashurisë….

Edhe **Moikom Zeqo** nuk e ka të vështirë për të deklaruar se Shefki Karadaku është një poet nga të spikaturit në lirikën shqiptare.

Shefki Karadaku portretizohet si një nga shkrimtarët e

dalluar të kohës.

Karadaku është një nga përfaqësuesit më të spikatur për gjininë e lirikës ku absorbohen përvojat e poetikave tradicionale me ato moderne e avangardiste evropiane dhe realizohet kundërvënia ndaj traditës letrare. Tipare të futurizmit, ekspresionizmit, surrealizmit, madje dhe krepuskolarizmit janë përthithur dhe pasqyruar në poetikat e këtij autori.

Koorpusi letrar i Sh.Karadakut përbën një thesar të çmuar...

Teksa lexon veprën e Shefki Karadakut, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare mjaft cilësore e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet: **"Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Argonautët", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Gjergj Elez Alia"**, si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Koorpusi letrar i Sh.Karadakut përbën një thesar të çmuar që rrezaton dritën e artë. Gjetjet metaforike, forca krijuese, gjuha e pasur e shpesh poetike, përdorimi mjeshtëror i fakteve, kronikat, përshkrimi i heronjve, legjendat dhe episodet e bëjnë të këndshme prozën e këtij shkrimtari.

Rrallë gjen në historinë e letërsisë shqipe një autor si Shefki Karadaku, të vlerësuar nga pena të spikatura si: Agim Cerga, Perikli Jorgoni, Milianov Kallupi, Riza Lahi, Jusuf Shahini, Leonard Veizi, Faruk Myrtaj, Mujë Buçpapaj, Ramazan Vozga, Namik Selmani, Sazan Goliku, Sakip Cami, Neritan Dragoti, Ahmet Banushi, Ermir Hoxha, Tomor Jolldashi, Mihal Disho etj.

Krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë

të tjera europiane. Revista letrare gjermane "Literatura Nr. 11, ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare "Marburg" e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

Para pak kohësh, me kontributin e familjes u botua në anglisht romani i Shefki Karadakut "PUTHJA E NGRIRE", nga një kopje e të cilit ju dhurua selive te huaja diplomatike në Tiranë. Dhe menjëherë vjen vlerësimi i ambasadorit gjerman **Peter ZINGRAF** për këtë roman tejet të arrirë që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar në botën letrare të kryeqytetit.



Nuk është rastësi që poeti e prozatori Shefki Karadaku mirërpritej e botohej kudo në trevat shqipfolëse, si në Prishtinë, Dibër të Madhe, Ulqin, Strugë etj. Madje në vitet

‘73-74 gazeta prestigjioze “RILINDJA” e Prishtinës botoi në 6 muaj radhazi novelën e tij “Kur kërcasin boçet e pishave”.

Trashëgimia letare që na la Shefki Karadaku me 13 vëllime me poezi dhe 12 romane e 10 libra me tregime e novela, që të gjithë me subjekt të zgjedhur e të arrirë, nuk është pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen që të mos ketë “Puthje të ngrirë”, që fjala e lirë të rrjedhë si “Ujëvarë”, që “Gjergj Elez Alia” t’u transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij, por edhe vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që “Shkumbini” të mos shkatërrojë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që “Elbasani i bukur” të çlirohet nga ndotja dhe të shndërrohet në turizmin tradicional shekullor. Ky është mesazhi që përcjell vepra e Shefki Karadakut.

Ndaj, shkrimtarë të tillë si Ai, që kanë sjellë risi në letërsinë tonë, meritojnë vëmendje nga kritika letrare dhe, në mungesë të Lidhjes së Shkrimtarëve, nga Ministria e Kulturës e nga Presidenti i Republikës. Personalitete si Ai, meritojnë vëmendje, sepse janë truri i kombit.

N’asnjë libër poetik, të cilët ai i krijoi dhe i botoi njeri pas tjetrit, dhe sidomos tek më i fundit me titullin sinjifikativ “TORAKS”, nuk mungon Elbasani; Karadaku është ajo kumria që s’e tradhtoi kurrë…Madje siç shkruan Kostandin Dhamo:

Ky libër, këtë herë, përveç teksit poetik, ngërthen midis faqesh edhe disa fotografi dhe vizatime, të hedhura gjithë fantazi fine nga vetë Shefki Karadaku. Këto vizatime së bashku me fotografitë, shpërfaqin jetën e tij midis shtëpisë së lindjes, brigjeve të Shkumbinit, tek kundron kumrien n’ajër, Bezistanin gumëzhitës, Kalanë, Sahatin, shelgun e pikëlluar që shkrehet mbi ujëra, dritaret pas pemëve të redaksisë së

Revistës Ylli, Rrugën e Elbasani, e çnuk tjetër…

Shefki Karadaku, nga Elbasani i kumries, kësaj embleme n'ajër, nga Elbasani i Kalasë me çezmat te porta që rrjedhin e rrjedhin si mikpritja dhe shtëpitë përbrenda me lule dhe vajza të bukura, nga Elbasani i Ditës së Verës, i Ballokumeve të ëmbla, i Shkumbinit shkumëzues, përgjatë brigjeve të të cilit stinët ndërrohen si dekore; nga Elbasani i Kristoforidhit, Isuf Myzyrit, Dhaskal Todrit, Vëllezërve Shpataraku, Bezistanit, Rrapit të Vojvodës, me poezinë dhe prozën e tij me vlera kombëtare, i dhuroi këtij qyteti një identitet të ri, Elbasani i Shefki Karadakut.



KUMRIE

Kumrie
Kumrie
Legjendë e shkruar në gjethë,
Tek fluturon ëmbël dhe lehtë,
Zgjon Elbasanin në mëngjes,
Duke mbajtur Yllin e Karvanit
Në sqep...

Bashkëshortja e tij, Nadirja pohon se :

"Shefkiu nuk e programonte kohën kur shkruante. Shkruante në shtëpi, në parqe e lulishte, kudo ku gjelbëronte muza e tij…..Kishte ditë që ulej para tavolinës dhe shkruante për 10 orë rresht. Shpesh çohej edhe nga gjumi dhe shkruante për disa orë edhe natën… Nuk kishte regjim të caktuar, por pas viteve ''90 ai shkroi me shumë temp dhe botoi shumë libra, ndërkohë që la në dorëshkrim disa vepra te tjera letrare".

Një vit më parë, më 16 mars 2021, familja Karadaku humbi njeriun e saj të dashur dhe që e bënte të ndjehej krenare. Ndërsa letërsia dhe kultura kombëtare humbën një nga autorët e saj më të shquar, kur mund t'i jepte akoma vepra të tjera, edhe më cilësore artistikisht dhe më të pasura emocionalsht. Shefkiu u shua vetëm fiziksht. Emri, veprat e shumta e me nivel të padiskutueshëm artistik, i kanë dhënë me kohë të drejtën e denjë të pavdekësisë dhe të prehjes në Parajsë! Ndaj dhe përkujtohet me madhështinë e nderimin që meriton në 1-vjetorin e vdekjes (16 mars 2022) dhe 81-vjetorin e lindjes, me një Akademi Përkujtimore në Muzeun Historik Kombëtar, jeta dhe vepra letrare e të cilit përcillet edhe në një film dokumentar të transmetuar e ritransmetuar nga Radiotelevizioni Publik Shqiptar (Kanali RTSH 3).

E shtunë, 12 qershor 2021

NACIONAL

studim ••• 15

Vepra e Karadakut është vlerësuar nga shkrimtarët dhe kritikët më në zë, si Kadare, Agolli, Siliqi, Kallulli, Jorgoni e Dhamo

80-VJETORI I LINDJES – ADN-ja E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

Nga Halil RAMA
"Mjeshtër i Madh"

Poeti dhe prozatori Shefki Karadaku, autor i 38 librave, të mërkurën më 9 qershor do të festonte 80 vjetorin e lindjes, por vdekja e ndau atë para 3 muajsh nga familja, miqtë e lexuesit e tij të shumtë. Ai njihet si një nga krijuesit më prodhimtarë e më cilësorë të letërsisë shqipe, në poezi dhe prozë, në gjinitë e tregimit, novelës dhe romanit.

Sh.Karadaku u lind më 9 qershor të vitit 1941 në një nga lagjet tradicionale të Elbasanit të quajtur Spahikorre. Jo më kot, këtë lagje, si dhe gjithë qytetin e Elbasanit ai e konsideronte si ADN-në e tij të pandryshuar. Vetëm disa muaj para se të largohej për në parajsën e përjetshme do më tregonte se si i ishte ngulitur në memorie Spahikorrja e Rëmijtërisë së tij, për të cilën ndjente pikëllim dhe dhimbje kur e shihte se si ishte dëmtuar. Ai kishte nostalgji për banesat e traditës, të mbetura ende tashmë si një dëshmi që dënon dhe akuzon. Madje, i zhytur në nostalgjinë e kohës, ish – mësuesi dhe shkrimtari i talentuar, do më rrëfente mjeshtërisht: "Ne në Spahikorre i adhuronin pemët , veçanërisht ullinjtë, njëmi proj të cilëve i kam kushtuar edhe një vjershë. Pale pastaj shelgjet dhe karaliçet bijërrinda, apo shtegtimi magjepsës i shpendëve...". Mjafton qofte dhe ky rrëfim i çfitë për të konkluduar se Shefki Karadaku, mngjithëse një familjar i rrugullt dhe përgjithmonë i obligjuar, shpirtin e kishte prej bohemi të çkurar dhe të papërmbajtur.

Kjo duket fare qartë qofë dhe në vëllimin poetik më të fundit "Toraks", që përshkohet nga një fill i holë lirike dhe malli prekës për vendlindjen e tij. Në 91 vjershat (pa titull) që mbushin 201 faqet e këtij vëllimi ndjehet aroma e vendlindjes së poetit, Elbasanit, ku ai u lind, u rrit dhe u formua si shkrimtar. Kësisoj, vendlindja vjen në këtë vëllim si mund e përjetimeve poetike të Karadakut, i cili si rralë kush thuu vargje për "gjethet ar, që rané nëpër sukat e Shkumbinit" dhe për "lejlekët që thirën fort, tek ikin nëpër tokat e Nadirit....". Po në këto përjetime poetike gjejmë edhe "rënkimet e një kumurije, që do të qëndrojë në atdhe....":

Poezia e Karadakut, poezi e këngës, e

Koorpusi letrar i Sh.Karadakut përbën një thesar të çmuar. Autori i 38 veprave letrare, ndër të cilët romanet: "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Sagë mbretërore", "Puthja e ngrirë" "Salamandrat", etj, është gjithashtu një poet nga më të spikaturit në lirikën shqiptare Krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe ne gjuhë të tjera europiane. Revista letrare gjermane "Literatura Nr. 11 ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare "Marburg" e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

veprash, që nga "Këngа e karrove të drithit", tek "Puthja e ngrirë", Vila e magjepsur" e deri te "Toraks", vepra këto që të krijojnë emocione të freskëta, për originalitetin e këndshëm e të besueshëm, që gjelbëron-jnë humanizëm dhe nga të cilat përcillen mesazhe befasuese, të ndjeshme e me sens dashurie njerëzore.

Poezia e këtij vëllimi është poezi e prejardhjes, është poezi e këngës, e ëndrrës, e dashurisë, e dhimbjes, e urtisë, e krejt në fund e përjetësisë. Libri fund e kryе shpalos ndjesitë e brendshme të poetit në raport me vendlindjen e shndërruar tashmë në muzëm e përjetimeve poetike, pa të cilën nuk gjen qetësinë shpirtërore e me të cilën tundohet

të dashurisë, mirësisë e urtësisë. tek "Vila

Vepra e Karadakut është vlerësuar nga Kadare, Agolli, Siliqi, Kallulli, Jorgoni e Dhamo

Për veprën letrare të Shefki Karadakut janë prononcuar me vlerësime pozitive kritikët dhe shkrimtarët me emër që nga Kadareja, Sterio Spasse, Periklli Jorgoni, Llazar Siliqi, Dritëro Agolli, Adriatik Kallulli, Xhezair Abazi, Fasili Haliti, Roland Gjoza, Petraq Risto. Poeti dhe shkrimtari Shefki Karadaku, do të vlerësohej nga shkiqui studimorë nga shkrimtarë dhe kritikë letrarë shqiptarë, mes të cilëve edhe Lutfi Kurteshi, Leonard Veizi apo dhe Konstandin Dhamo.

Karadaku është një nga përfaqësuesit më të spikatur për gjininë e lirikës ku absorbohen përvojat e poetikave tradicionale me ato moderne e avangardiste evropiane dhe realizohet kundërvënia ndaj traditës letrare.

Tipare të futurizmit, ekspresionizmit, surrealizmit, madje dhe krepuskolarizmit janë përfshirë dhe pasqyruar në poetikat e këtij autori.

Ndërthurja e tyre me përvojat individuale ka sjellë një poezi të re që u përgjigjiet ndryshimeve të shoqërisë shqiptare, si dhe kërkesave të vetë sistemit letrar shqiptar. Nga vepra e tij më të njohura përmendim: "Një mijë vjet dashuri", "Argonautët", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Gjergj Elez Alia", "Garderoba e ofiqarit gri", "Puthja e ngrirë", "Apokalipsi i gjetheve", "Argonautët ose 100 datë shqiptare që tronditën botën", "Sagë mbretërore" etj. Karadaku është poet i popullit dhe i problemeve të tij më qenësore, poet i problemeve historike dhe shoqërore.

"Në romanet "Puthja e Ngrirë", "Një mijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Pangjerikua" e të tjerë dhe vëllimet poetike "Këngа e të korrave të drithit", "Melodi të Shkumbinit" dhe "Feniks", poeti e shkrimtari Shefki Karadaku usnjëherë nuk do të ti nështrohet jetës edhe pse e vuan atë", shkruan kritiku letrar", doktor Lutfi Kurteshi.

Ndërsa shkrimtari Leonard Veizi do të shkruante se "një studim më konkret për krijimtarinë e tij e gjejmë te libri "Absurdi mbretëror" – (Shënime kritike, ese, këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karada-

KANË THËNË E SHKRUAR PËR POEZINË DHE PROZËN E KARADAKUT:

Petro Marko: KUR SHKRIMTARI E NJEH DHE E DO NJERIUN E THJESHTË

Poeti i ri, Shefki Karadaku, doli tani me një novelë, të titulluar "Rrugët e para". Sikur ta kishte këtë botim në vargje dhe ta kishte pagëzuar po me këtë emër, ne përnjëherësh do të thoshim: poeti, pasi njeh rrugët e para të jetës, ka zbuluar në to fenomene dhe tinguj, ose ngjyra të reja dhe tani po na i dhuron me dashuri…

Gazeta "Drita", 2 shkurt 1969

Llazar Siliqi, *Poet:* "MELODITË E SHKUMBINIT"

Kur më 1967 Shefki Karadaku doli me vëllimin e tij të parë, "Kënga e karrove të drithit", ne u gëzuem që radhët e poetëve shqiptarë u shtuen me një poet të ri, me një lirik të qetë e të ambël, me ndjenja të holla, me dorë piktori të akuarelit.

Gazeta "Drita", 13 janar 1969

Moikom Zeqo, *Shkrimtar, studiues:* LIRIKA POLISEMANTIKE E SHEFKI KARADAKUT

Poeti Shefki Karadaku, i njohur në vitet '60 si një talent i vërtetë lirik, të kujtonte një Esenin shqiptar të ndrojtur, tepër

modest, me trillet origjinale të imazheve të vendlindjes së tij. Lirika e tij imazhiniste qe e ngrohtë, plot ndjesi fusharake, me një romantikë të pranueshme, po me arketipë figurash popullore…

Gazeta "Drita", 30 janar 1994 - Libri "Feniks" përmbledh ditarët e tij intimë poetikë (vitet 1972-1985)

Dr. Lutfi Turkeshi - *Gazetar, studiues:* Karadaku, Khajami i ditëve tona

Pas shumë shekujsh, kur rebeli pasardhës do të tundë prapë selvinë, që e preku (vite më parë) me diç të "hekurt", si me turp do ta shoh se rreth saj do të mbijnë bota, sisteme, grushte shteti, piramida... Martesa njerëzish dhe qivure. Është ky mesazhi poetik i Khajamit të ditëve tona, poetit Shefki Karadaku, i cili me mëse 20 vepra në prozë dhe poezi amësoi në hapësirat e demokracitë letrare…

"IDENTITETI SI KATARZË" - Gazeta "Fakti", 8 mars 2001, Shkup

http://www.panorama.com.al/te-kujtonte-nje-esenin-shqiptar-te-ndrojtur-nga-driteroi-te-llazar-siliqi-e-petro-marko-si-e-vleresuan-shefki-karadakun/

(Artikull i botuar nga Halil Rama në të përditshmen "Panorama"- 16 mars 2022)

REPORTAZH

Bashkia e Elbasanit dhe Bordi Editorial Ndërkombëtar i gazetës "Nacional", tituj nderi dhe Çmim për poetin dhe prozatorin e mirënjohur.

AKADEMIA PËRKUJTIMORE – ELITA KRIJUESE VLERËSON VEPRËN LETRARE TË KARADAKUT

https://vizion.com.al/akademia-perkujtimore-elita-krijuese-vlereson-vepren-letrare-te-karadakut/

• "Të kujtonte një Esenin shqiptar të ndrojtur"- Nga Dritëroi, te Llazar Siliqi, Petro Marko, Moikom Zeqo e Lutfi Turkeshi, si e vlerësojnë Shefki Karadakun në dokumentarin artistik që u shfaq në Akademinë Përkujtimore para 100 personaliteve të letrave, si edhe në ekranin e Radiotelevizionin Publik Shqiptar, në kanalin RTSH 3

• Në filmin dokumentar që u shfaq më 16 Mars 2022, ora 11.00 në sallën "UNESCO" - Muzeu Historik Kombëtar, ikona e teatrit e kinematografisë shqiptare Margarita Xhepa - Nderi i Kombit, interpretonte mjeshtërisht disa nga poezitë

e lirikut famoz Shefki Karadaku….ndërsa për profilin krijues dhe vlerat ideoartistike të prozës e poezisë së tij, flasin personalitete të letrave e publicistikës si: Sadik Bejko, Xhevat Mustafa, Kozeta Mamaqi, Sakip Cami, Hyqmet Zane etj… Ky dokumentar që u transmetua më 17 mars 2022 edhe nga Radiotelevizioni Publik Shqiptar, Kanali RTSH 3, ka marrë vlerësime maksimale nga dhjetra personalitete të artit e letërsisë.

Në 81-vjetorin e lindjes dhe 1-vjetorin e ndarjes nga jeta, shkrimtari i mirënjohur Shefki Karadaku, autor i 10 romaneve, 12 novelava e 13 vëllimeve me poezi, me të cilët ka hyrë me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe, është vlerësuar gjatë një Akademie Përkujtimore për produktin e tij letrar mjaftë cilësor.

Në këtë event të organizuar nga Qendra Kombëtare e Artit dhe Letërsisë "Nacional" dhe Federata Shqiptare e Veteranëve, merrnin pjesë dhjetra personalitete të spikatura krijuese në rang kombëtar, mes të cilëve ***artistet e Popullit Tinka Kurti e Margarita Xhepa dhe Prof.Bujar Kapexhiu- Nderi i Kombit***.

Në çelje të këtij eventi mbresëlënës, më shumë se 100 shkrimtarë e artistë, familjarë dhe të afërm, që kishin mbushur sallën "UNESCO" të Muzeut Historik Kombëtar, ndoqën me interesim të jashtëzakonshëm ***dokumentarin artistik "ADN-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut"***, realizuar sipas skenarit tim, nga ***regjisori i talentuar Bledar Linza***. Të pranishmit në sallë provuan emocione të ngrohta kur në filmin dokumentar kushtuar këtij kolosi të letrave shqipe, ikona e teatrit e kinematografisë shqiptare ***Margarita Xhepa – Nderi i Kombit***, interpretonte mjeshtërisht disa nga poezitë e lirikut famoz Shefki Karadaku, ndërsa për profilin krijues dhe vlerat ideoartistike të prozës e poezisë së tij, flisnin personalitete të letrave e publicistikës si: poeti ***Sadik Bejko***, prozatori e publicisti ***Xhevat Mustafa***, shkrimtarja dhe gazetarja e mirënjohur ***Kozeta Mamaqi***, bashkëshortja e shkrimtarit, Znj.***Nadire Karadaku***, shkrimtari dhe publicisti ***Halil Rama***, poeti e publicisti ***Sakip Cami***, sidhe gazetari ***Hyqmet Zane*** nga Elbasani.

Në dokumentarin artistik "*ADN-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut*", veçanërisht Znj. **Kozeta Mamaqi,** e njohur për potencialin e saj krijues si gazetare, eseiste dhe tregimtare, solli në vemëndjen e publikut momente prekëse të viteve kur punonte bashkë me Shefki Karadakun në revistën Ylli, duke evidentuar krijimtarinë poetike e prozaike me të cilën Karadaku cilësohej si një nga zërat e rinj më të preferuar nga lexuesi, madje si Khajami i ditëve tona.

PROF.BUJAR KAPEXHIU: PROFILI I KARADAKUT, NË NJË DOKUMENTAR MJAFT CILËSOR

Për nivelin e lartë artistik, ndërthurjen mjeshtërisht të fjalës artistike me intervistat e ilustrimin me imazhet filmike e fotografike, duke përcjellë kështu një profil shumëdimensional të shkrimtarit Sh.Karadaku dhe mesazhet aktuale të veprës së tij letrare, dokumentari u vlerësua nga skenaristi, aktori dhe regjisori i mirënjohur ***Bujar Kapexhiu*** si dhe nga shkrimtarët e shquar: ***Dr.Mujë Buçpapaj, Sulejman Mato, Agim Pipa, Andon Andoni, Sakip Cami, Arben Iliazi, Kozeta Zavalani, Qazim Shehu, Josif Doja, Demir Rusi, Barie Çupi, Nafie Jella, Nexhbedin Basha,*** etj.

Dr. Mujë Buçpapaj, duke evidentuar individualitetin krijues dhe njerëzor të shkrimtarit Shefki Karadaku nënvizoi faktin se Ai ishte një individualitet i fortë njërëzor dhe poetik, ishte një lirik i çiltër, mjeshtër i vargut dhe i teknikës poetike dhe këto i mjaftonin për të qëndruar larg poezisë së angazhuar dhe brohoritëse që siguronte shpesh privilegje, karrierë dhe shpërblime zyrtare. Buçpapaj mendon se Shefkiu si poet nuk ishte i rehatshëm për kritikën. Ai ishte një zë i pagabueshëm poetik dhe lirika e tij mistike nuk kishte parasysh këtë kritikë, gjithmonë të njëanshme, por një liri individuale universale si një vepër me ndikim të gjatë, si një eksplorim gjuhësor dhe përvojë e rrallë njerëzore që i drejtohet sa bashkëkohësve aq edhe së ardhmes.

Shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur ***Xhevat Mustafa***, pasi evidenton faktin që krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë të tjera evropiane, si gjermanisht, anglisht....shpreh keqardhje sepse: "…fatkeqësisht, edhe pse ishte një nga shkrimtarët me më shumë tituj veprash të botuara, më të shquar e më të lexuar, sidomos pas vitit 1990, kritika letrare, Bashkia e Elbasanit dhe e Tiranës, Ministria e Kulturës, Ministria e Arësimit, Presidenca, nuk i kushtuan vëmendjen dhe nuk i dhanë vlerësimin që meritonte. Ndoshta, sepse nuk bënte pjesë në listën e shkrimtarëve, që kishin lënë Enver Hoxha dhe Ramiz Alia...? Ndoshta, sepse nuk iu bashkua si mbështetës fanatik asnjerës prej partive kryesore? Ndoshta, sepse iu shmang në prozë me vetëdije të plotë dhe jo pa llogaritjen e rrjedhojave, kallëpeve dhe temave të sheqerosura, me trajtime dhe zgjidhje skematike të realizmit socialist, duke pasur prodhimtari cilësore dhe të pëlqyeshme pas vitit 1990 ??? Ndoshta, sepse pati guximin që në novelat dhe romanet e tij të vinte gishtin në të këqijat e shumta të

diktaturës, sidomos ndaj njeriut, të drejtave dhe lirive të tij, e pas vitit 1990, në plagët politike e sociale të tranzicionit dhe të demokracisë allashqiptare?".

Në gjykimin e Xhevat Mustafës, proza në tri përmasat, pra në tregime, novela dhe romane e Shefki Karadakut, shquhet apo dallohet:

- për origjinalitet, për spektrin e gjërë të subjekteve, nga lashtësia deri në ditët e sotme;

- për narracionin apo rrëfimin e zhdërvjelltë e të natyrshëm;

- për strukturimin intrigues dhe mbërthyes nëpërmjet emocioneve të shumta e të forta nga faqja e parë deri tek e fundit…



Prof. Dr. Saemira Pino, e emocionuar u shpreh: "Mësova shumë për një njeri të letrave, që për fat të keq, kisha lexuar diku veç disa tregime të tij te 'Nëntori'. Doja t'ju uroja sidomos për dokumentarin shumë të mirë të realizuar nga Ju kryesisht. Urime dhe arritje të tjera…"

Ndërsa **Faruk Myrtaj**, shkrimtar, novelist, poet dhe përkthyes, që prej vitesh jeton e punon në Kanada, pasi e ka parë dokumentarin të transmetuar të enjten në darkë (17 mars 2022) nga Radiotelevizioni Publik Shqiptar - kanali RTSH 3, shkruan në faqen e tij në facebook: "Nderime për Shefki Karadakun. Njeri i rrallë, familjar i shkëlqyer, lirik i llojit të parë. Bravo dhe më tej për bashkëshorten e tij Nadiren, si mbështetëse dhe frymëzuese e përjetëshme e tij. Ta kujtojmë siç ishte!"

KARADAKU LINDI PËR TË KRIJUAR ARTIN E TIJ

Në emër të **Art Klub "Dibra", Dibër e Madhe, Z. Hysen Kosovrasti,** shkrimtar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në përshëndetjen që i solli Akademisë Përkujtimore, ndër të tjera shprehet: *"Shefki Karadaku erdhi disa herë, si i ftuar special në qytetin e Dibrës së Madhe. U njohtua me shumë poetë nga të gjitha trojet shqiptare, Tirana, Burreli, Peshkopia, Dibra, Kosova..., sidomos me kryetarin e klubit, Nebi Samarxhiu. Ata, disa që i njihte, e respektuan pa masë, sepse Shefki Karadaku është ndër intelektualët e rrallë që mori mbi supe përgjegjësi të rënda, në veçantësi ai punoi me shumë dinjitet në fushën e krijimit letrar si në prozë ashtu edhe në poezi".*

Sakip Cami – shkrimtar, poet dhe publicist i njohur, e konsideron Shefki Karadakun një shkrimtar të spikatur si në poezi edhe në prozë, në novelat dhe romanet e tij me subjekte dhe personazhe që të mbeten në kujtesë. Sipas tij, e veçanta e prozës së Karadakut është poezia e shkrirë brenda saj me figura letrare dhe artistike që të mrekullojnë. "Karadaku ka shkruar e botuar 10 libra me novela e 12 romane ku do të veçoja romanin "Puthja e ngrirë" , një roman i shkruar në vitet 1990 - 1991 që trajton egërsinë e diktaturës komuniste që po jepte shpirt duke vrarë e plagosur dhe kjo e dhënë nëpërmjet një çifti të rinjsh, Rrok Delisë dhe Zibelit, të ciëve falangat

komuniste ua ngrinë puthjen dhe ua mohuan dashurinë duke i vrarë në kufi",- tha ndër të tjera S.Cami.

Prozatori **Andon Andoni,** autor i disa vëllimeve me tregime e romane, pasi ka lexuar dhe analizuar romanin e Sh.Karadakut **"Puthja e ngrirë**" (të vlerësuar nga kritika letrare si një nga kryeveprat e tij) shprehet veçanërisht për natyrën moderne në portretizimin e personazheve.

"Romani ka një natyrë moderne për sa i përket portretizimit të personazheve. Janë natyra njerëzore, që në dukje kanë tipare të veçanta, fytyrë, veshje, shtat, etj, Ngjajnë dhe janë krejt të kundërt me njeri –tjetrin për sa i përket karaktereve, çuditërisht, që nga Pigali, Meku, Zurba Sina, dhe deri tek Basriu, Rroku, Zibeli, Kanadi, të ndarë ne dy kategori: tri të parët, edhe pse përmenden rëndom në roman, nuk kanë identikit, janë pa fytyrë, pa shëmbëllim, vetëm emra simbol, e megjithëkëtë janë kaq të qartë dhe prezent në sytë e lexuesit. Të tjerët, madje edhe dy shoqëruesit-vëzhgues, njëri me fytyrë të kuqe si spec dhe tjetri plot prenjka, janë të karakterizuar nga idetë që mbartin, mënyra e të jetuarit plot vitalitet, përmes sakrificës dhe jo rutinës", vlerëson A.Andoni.

Shkrimtari, dramaturgu dhe publicisti ***Arben Iliazi*** e vlerëson Shefki Karadakun një zë emblematik të lirikës shqiptare. "Duke e riparë nga optika e pas pesëdhjete e ca viteve krijimtari, veprën poetike të Tij, mund të themi se Karadaku është një poet i spikatur i letrave shqipe, që paraqitet me atributet e origjinalitetit të tij të patjetërsueshëm. Ai nuk është i ngjashëm me askënd, është plotësisht dhe thellësisht vetvetja**. Karadaku lindi për të krijuar artin e tij.** Është ndër të paktit poetë, i cili që në fillim synoi origjinalitetin dhe jo imitimin, konstruktoi vetveten, për të mos qenë i ngjashëm. Shefki Karadaku s'do të bëhet kurrë Mit. Ai do të mbetet poet

i përjetshëm i Dashurisë. Dhe duke qenë i Përjetshëm është Profetik. Ndërsa lexuesit e tij do mbeten të mrekulluar në çdo kohë, në çdo epokë..., -shprehet ndër të tjera Z.Iliazi.

Për poetin dhe analistin e mirëfilltë të veprës letrare ***Agim Pipa*** "Apostulli poezisë, i tregimit, romanit dhe letrave shqipe (këtë e them me bindje të plotë për vetë përmasat e mjeshtrit Karadaku) përbën sot një rast unikal jo vetëm në dukjen, në formën dhe elementë të tjerë të veprës së tij të madhe. Por mbi të gjitha, me përmbajtjen që priret të shkojë fjalë pas fjale, tingull pas tingulli, fonemë pas foneme, ligjëratë pas ligjërate, morfologji dhe sintaksë gjuhësore bashkë, me përmbajtjen që priret të shkojë pra drejt thellësisë së shpirtit të njeriut. Aty, ai ndjehet shumë mirë…"

Ndërsa poetja ***Adriatike Lami***, autore e më shumë se dhjetë librave (ndër të mirëpriturit e preferuarit nga lexuesi), pasi ka bërë një vështrim analitik të librit "TORAKS", ndër të tjera nënvizon faktin se "Poezia e këtij libri hapet në mënyra të ndryshme para lexuesit. Fiton dimensione që autori i quan kozmike, përmes fjalëve a shprehjeve; tokësore, rrugë të kaltra, qyteti me njëmijë bebe, etj. Kjo e afron këtë poezi me natyrën e poezisë filozofike dhe ndërkohë shtjellon format e të menduarit me përfytyrim të gjerë". Më tej ajo vlerëson se "Si poetët e mëdhenj, Shefki Karadaku ka qytetin e tij magjik. Magjia e këtij qyteti është vazhdimisht kërkuese dhe në zhvillim duke paraqitur evolucion artistik. Jo rrallë ndjesia njerëzore kalon në një dimension të lartë përqendrimi si psh në rastin: Kob i kumrive. Ai e quan shpesh kob i kumrive…. Ka një lloj trishtimi të natyrshëm, që buron nga fakti se poeti është zbulues dhe kërkon gjithnjë evolucion…."

Josif Daja, një tjetër mik i shkrimtarit Karadaku, erdhi disi ndryshe në këtë Akademi Përkujtimore, duke recituar

poezinë e tij "*Fisnik në shpirt, në art i fisëm*", nga e cila veçojmë vargjet mbresëlënëse: *"Fisnik në shpirt, në art i fisëm/ Virtytesh mbrujtur, gjithë ç'janë/ I Elbasanit tonë të shndritshëm/ Frymë, puls e nerv,- gjithë Elbasan…./ ...E deshi fort ai Shkumbinin/ Se lindur kish brigjesh të tij/ Të tijat valë tek shushurinin/ Në këngë i shndërroi, në poezi…/ Me këngët e Isuf Myzyrit/ Pat zënë ai të hidhte shtat/ Aty i mbante, ngrohtë, pranë gjirit / Të tijat këngë,të ëmbla mjaltë…."*

MAKSIM VINÇANI : SHEFKI KARADAKU ISHTE MIK I NGUSHTË I VETERANËVE

Nënkryetari i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL), Z.Maksim Vinçani, duke përshëndetur qindra pjesmarrësit elitarë në këtë Akademi Përkujtimore, ndër të tjera vlerësoi personalitetin krijues te lirikut e prozatorit të mirënjohur Shefki Karadaku, që sipas tij u shfaq madhështor nëpërmjet dokumentarit të promovuar në këtë event të orgnizuar në 81-vjetorin e lindjes dhe 1-vjetorin e ndarjes nga jeta, dokumentar ky i transmetuar edhe nga Radiotelevizioni Publik Shqiptar në kanalin RTSH 3. Ai vlerësoi gjithashtu trajtesat e disa prej personaliteteve të letrave që kumtuan rreth profilit dhe veprës së tij letrare.

"Kam kënaqësinë që në emër të Federatës Shqiptare të Veteranëve si bashkëorganizuese e kësaj Akademie Përkujtimore të falenderoj Familjen "Karadaku" si trashëguese e denjë e këtij gjeniu krijues. Kjo edhe për faktin se Shefki Karadaku, përveç talentit të rrallë në shkrimtari, ishte dhe një mik i ngushtë i Org.Bashkuar të Veteranëve, ku sa qe gjalllë

na ndoqi dhe vlerësoi me fjalën e tij të mençur e të rrallë, thuajse në çdo aktivitet promovues.

I tillë do të mbetet ai në kujtesën tonë, si poeti e prozatori që na la pas një trashëgimi të vyer letrare, si Njeriu shembull që frymëzon e do të frymëzojë brezat", u shpreh Z.Vinçani. Si bashkëqytetar i Elbasanit, ai apeloi që autoritetet ta vlerësonin shkrimtarin e madh elbasanas, duke i dhënë titullin "Qytetar Nderi", si dhe duke i vënë emrin e tij ndonjë institucioni arsimor apo kulturor të këtij qyteti.

Nderimi nga kryebashkiaku Gledi Llatja i Elbasanit dhe Qendra Kombëtare e Artit dhe Letërsisë "Nacional"

BASHKIA ELBASAN

I jepet titulli :

MIRËNJOHJA E QYTETIT

Z. SHEFKI KARADAKU

(pas vdekjes)

Me motivacionin :

"Për kontributin e shquar si shkrimtar, vepra e të cilit është identifikuese dhe përçuese e historisë, kulturës, traditave e cilësive identifikuese të trevës së Elbasanit, koorpusi letrar i të cilit përbën një thesar të çmuar që rrezaton dritën e artë në historinë e letërsisë shqipe."

Kryetari i Bashkisë

Gledian LLATJA

Nr 31 Date 16.03.2022

Me sugjerimin e ikonës së Teatrit e Kinematografisë shqiptare, aktores së madhe **Margarita Xhepa – Nderi i Kombit**, si dhe në konsiderim të propozimit të bërë nga

Qendra Kombëtare e Artit dhe Letërsisë "Nacional" dhe Federata Shqiptare e Veteranëve, kryetari i bashkisë së Elbasanit, **Z.Gledian Llatja** vlerësoi në 81-vjetorin e lindjes dhe 1-vjetorin të ndarjes nga jeta shkrimtarin Shefki Karadaku me titullin e Nderit "Mirënjohja e qytetit", me motivacionin:

"Për konributin e shquar si shkrimtar, vepra e të cilit është përçuese e historisë, kulturës, traditave e cilësive identifikuese të trevës së Elbasanit, koorpusi letrar i të cilit përbën një thesar të çmuar që rrezaton dritën e artë në historinë e letërsisë shqipe".

Çaste vërtetë emocionuese për bashkëshorten e shkrimtarit të Madh, ***Znj.Nadire Karadaku***, kur nënkryetari i Bashkisë së Elbasanit, ***Z.Artur Guni*** i jep asaj këtë titull të lartë nderi.

Dhe Nadirja, një nga gratë e njohura intelektuale të kryeqytetit, e karakterizuar nga shpirti i saj i veçantë krijues, do të falenderonte përzemërsisht qytetarin e parë të Elbasanit, si dhe oganizatorët e pjesëmarrësit në këtë Akademi Përkujtimore.

Vetë Z.Guni, po atë ditë do të shkruante në faqen e tij

në facebook: "I privilegjuar, të merrja pjesë sot në ambjentet e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, në Akademinë Përkujtimore kushtuar shkrimtarit të mirënjohur elbasanas Shefki karadaku, organizuar nga Nderi i Kombit Margarita Xhepa e shkrimtari e publicisti, "Mjeshtri i Madh" Halil Rama. Në emër të kryetarit të Bashkisë Elbasan, Z.Gledian Llatja, familjes së shkrimtarit të mirënjohur elbasanas Shefki Xhaferr Karadaku i dorëzova titullin e akorduar "Mirënjohja e qytetit (pas vdekjes)."

Shkrimtari Shefki Karadaku u vlerësua në 81-vjetorin e lindjes dhe 1-vjetorin të ndarjes nga jeta *edhe nga* ***Bordi Editorial Ndërkombëtar i Gazetës "Nacional"*** *me "****Çmimin për vepër jetësore****", me motivacionin:* ***"Vepra e tij, si shprehje e vuajtjes dhe guximit krijues, ndërthur bukurinë lirike, me narrativën tragjike të ekzistencës, fuqinë epike me kërkimin e së vërtetës, e cila ka ushtruar ndikimin më të madh në letërsinë bashkëkohore shqiptare, me mesazhe të forta për gjithë njerëzimin".***

E bija e tij, Albana - një notere e njohur, e respektuar dhe e vlerësuar nga qytetarët e klientët e saj në kryeqytet, do të shprehej e ngazëllyer pas marrjes së këtij çmimi nga ***Dr.Mujë Buçpapaj, një nga poetët, publicistët, analistët dhe politologët më të mirë në rang kombëtar, themelues dhe drejtues me kompetencë e profesionalizëm i kësaj qendre, si dhe i gazetës "NACIONAL****", në të cilën gjatë 10 viteve të fundit është botuar pjesë nga krijimtaria poetike e prozaike e Shefki Karadakut si dhe disa analiza të mirëfillta për veprën e tij dinjitoze letrare.*

INTERVISTA

Nadire Karadaku rrëfen 50 vitet e jetës me bashkshkortin e saj, shkrimtarin e mirënjohur SHEFKI KARADAKU

Gazeta "Nacional", 11 Gusht, 2021

Nadire Karadaku: *Shefkiu ishte në sintoni të plotë si shkrimtar dhe njeri i mrekullueshëm, dhe unë kam qenë me fat që për rreth gjysmë shekulli isha bashkëshortja e tij. Ai nuk jeton më, por kudo që rrotullohem në shtëpi, më duket sikur e kam pranë, pasi kudo prek libat e shumtë të tij që përbëjnë një pasuri tejet të vyer, jo vetëm për familjen, por parasëgjithash për kulturën tonë kombëtare*

Mjafton të kujtosh analizën e shqiptaro-maqedonasit, Profesor – Doktor Lutfi Turkeshi në gazetën "Fakti", (i panjohur për Shefkiun), i cili e quan "Khajami i ditëve tona" dhe "një autor i madh"… Moikom Zeqo e krahason me Eseninin, Halil Rama e quan "një poet dhe prozator gjenial", Enver Kushi e quan "poeti i reve"; Xhevat Mustafa shkruan në "Nacional" ditën që Ai ndrroi jetë se "U shua një yll i letërsisë shqipe", Erika Beermann, albanologe dhe studjuese e vendeve të Europës Juglindore e quan një nga autorët e famshëm të vendeve të Europës Juglindore dhe e boton me shkrimtarët më të mëdhenj të kohës në një antologji me karakter studimor në vitin 1995 në Gjermani…Shefi i Katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Sorbonës, Kristian Guut i shkruan se e vlerëson shumë lart krijimtarinë e tij.

- Nadire Karadaku është ndoshta nga zonjat e rralla, jo vetëm si frymëzuese e krijimtarisë së bashkëshortit të saj të ndjerë, shkrimtarit të mirënjohur e shumë të sukseshëm, Shefki Karadaku, por edhe mbështetësja e financuesja e botimit të 20 librave të tij. Noterja e mirënjohur, që në rininë e saj ka shkruar dhe botuar poezi, skica e tregime të arrira artistikisht dhe të vlerësuara nga lexuesi i asaj kohe, në këtë intervistë eksluzive për "NACIONAL" prezantohet jo vetëm si njohëse perfekte e letërsisë botërore e asaj shqiptare, por edhe si një kritike e mirëfilltë letrare.

- Zonja Nadire, më 16 mars 2021 u nda nga jeta shkrimtari i mirënjohur Shefki Karadaku. Ju si bashkëshorte, si u ndjetë në këtë moment të vështirë të jetës tuaj?

- Më 16 Mars 2021, rreth orës 10.30 u nda nga jeta bashkëshorti im, shkrimtari Shefki Karadaku. Nuk do mund ta harroj deri sa të jetoj atë moment të dhimbshëm. M'u duk

sikur toka m'u rrotullua nën këmbë dhe po rrëzohesha. Ai i mbylli sytë shumë i qetë, i rrethuar nga e gjithë familja e tij që e donte aq shumë, si bashkëshortja, fëmijët, mbesat, motra, bashkëshorti i vajzës, bashkëshortja e djalit si dhe disa miq të familjes.

- Pak gra shkrimtarësh u janë përkushtuar bashkëshortëve të tyre si ju ndaj Shefki Karadakut, duke i krijuar një mjedis të qetë familjar, mbështetur dhe inkurajuar atë për të shkruar dhe botuar librat, por edhe duke e këshilluar edhe me mëndime kritike. Nga ju buroi gjithë ajo dashuri e pashtershme ndaj Shefkiut?

- Unë e adhuroj letërsinë. Që në adoloshencën e herëshme kam lexuar klasikët e botës të përkthyer mjeshtërisht tek ne, si Tolstoin, Shekspirin, Dostojevskin, Pushkinin, Gogolin, Çehovin, Heminguejin, Remarkun, Drajzërin, Stefan Cvajk, Hygoin, Balzakun, Mopasanin, Gollsuorthin, Markez, Arçibald Kronin, Elsa Triole, e shumë e shumë të tjerë.

Në këtë këndvështrim, isha me fat që bashkëshorti im ishte poet dhe prozator me shumë talent.

Gjatë periudhës së diktaturës, Shefkiu botoi 9 libra, sigurisht duke u munduar të ishin brenda kornizave të lejuara nga diktatura. Krahas këtyre botimeve, duke filluar nga viti 1972 deri në vitin 1985 shkroi gradualisht vëllimin me poezi "FENIKS" dhe në vitin 1976-77 novelat që përmbledh vellimi "Arkadia e largët".

Mbaj mend se rreth viteve 1976 - 1977 kishte shkruar dhe përgatitur për shtyp një roman. E çoi në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri" dhe nga reçensionistët u dhanë vlerësime pozitive, ndaj dhe libri hyri në shtyp për botim. Por kur prisnim të dilte romani, u njoftua se ky roman ishte kthyer në karton.

Shefkiu ishte tepër i ndjeshëm dhe erdhi në shtëpi i dërmuar moralisht. Pasi mësova se pse ishte dëshpëruar aq shumë, i thashë: Ti e kupton se në ç'kohë jetojmë! A bëjmë një pakt bashkë?! Ti vazhdo të shkruash dhe shkrimet e tua do t'i lexoj vetëm unë, nuk do t'i çosh për botim. Dhe natyrisht, poezitë e "FENIKS"-it apo novelat e "Arkadia e Largët", nuk mund t'i dërgonte për botim, pasi kur doli në dritë botimi i tyre (viti 1993) ne do ishim harruar.

Dorëshkrimet e "Feniks"-it dhe "Arkadia e largët" si dhe romanit "Puthja ngrirë", i kam ruajtur në shtëpi me fanatizëm.

Poezitë e "Feniks"-it i daktilografoi vetë në redaksinë e revistës "Ylli", ku punoi për 20 vjet rresht. I përfundoi së daktilografuari rreth viteve 1986-1987. I kam lexuar mbasi i daktilografoi dhe i thashë:

Shefki, nëse do vijë një ditë që të botohet ky vëllim, unë do të të lutem që të mos ia japësh askujt për redaktim, pasi këto poezi nuk kanë nevojë për t'u hequr dhe as për t'u shtuar asnjë pikë dhe asnjë presje.

Natyrisht, Ai e mori në konsideratë sugjerimin që i bëra. Dhe unë nuk isha gabuar. "FENIKS"-i u prit mjaft mirë dhe u vlerësua me nota maksimale nga kritikë, specialistë të fushës

dhe dashamirës të letërsisë. Mjafton të kujtosh analizën e shqiptaro-maqedonasit, Profesor-Doktor Lutfi Turkeshi në gazetën "Fakti", (I panjohur për Shefkiun), i cili e quan "Khajami i ditëve tona" dhe "një autor i madh".

Moikom Zeqo e krahason me Eseninin, Halil Rama e quan "një poet dhe prozator gjenial", Enver Kushi e quan "poeti i reve"; Xhevat Mustafa shkruan në "Nacional" ditën që Ai ndrroi jetë se "u shua një yll i letërsisë shqipe". Erika Beermann, albanologe dhe studjuese e vendeve të Europës Juglindore e quan një nga autorët e famshëm të vendeve të Europës Juglindore dhe e boton me shkrimtarët më të mëdhenj të kohës në një antologji me karakter studimor në vitin 1995 në Gjermani.

Shefi i Katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Sorbonës, Kristian Guut, i shkruan se e vlerëson shumë lart krijimtarinë e tij.

- Shefkiu, sapo mbaroi studimet e larta për gjuhë letërsi shqipe, më 1971 u caktua redaktor në revistën "Ylli", në Tiranë, një revistë që u bë shkak edhe për njohjen dhe pastaj lidhjen tuaj? Si e kujton këtë kohë ?

- Në vitin 1971, me datën 1 mars, Shefkiu pa u diplomuar akoma, ishte student i fakultetit gjuhë-letërsi në Tiranë, u emërua redaktor dhe gazetar në revistën "Ylli". Unë në atë kohë punoja në këtë revistë, ku u njohëm e më pas krijuam familjen tonë.

- Si çdo familje e re dhe posaçërisht në atë periudhë edhe ju patët vështirësitë e ngritjes së familjes, përballimin e jetesës etj. Si e kujtoni këtë periudhë, si ishte jeta e një familje intelektuale e asaj kohe në Tiranë?

-Në atë periudhë, krijimi i një familjeje të re kishte vështirësi jo të vogla dhe një nga vështirësitë ishte fakti se nuk mund të kishe një shtëpi, ku mund të strehoheshe. Por ishim të rinj dhe e përballuam mirë faktin që na u desh të jetonim për më shumë se dy vjet si bohem.

- Shefkiu ra në sy të kritikës si lirik origjinal dhe me talent të spikatur qysh me vëllimin e parë me poezi "Kënga e karrove të drithit", botuar para se të vinte në Fakultet, por librat e mëvonshëm do ta vinin në majë të poezisë lirike shqipe, bashkë me disa prej bashkëkohësve të tij. Si punonte Shefkiu, kishte një regjim të tijin që e respektonte çdo ditë apo punonte kur i vinte fryëzimi?

- Shefkiu ka botuar që herët cikle me poezi në gazetat "Drita" e "Zëri i Rinisë", në revistën "Nëntori" etj, por botimi i vëllimit të parë "Kënga e karrove të drithit" më 1967, do të mbetet si një nga vëllimet me lirikat më dinjitoze dhe më të lexuara në atë kohë, pasi janë lirika në kuptimin e plotë të kësaj fjale dhe jo ditirambe për diktaturën apo diktatorin. Kjo është dhe një nga arsyet që e adhuroj letërsinë e Shefkiut, përveç faktit që vargun e tij në poezi e lexon dhe e rilexon me shumë endje.

Shpesh i thoja: Shefki, ndër shkrimtarët botërorë që adhuroj është Çehovi, novelat e të cilit i kam lexuar 6 herë, kurse poezitë e "Feniksi"-t tënd i kam lexuar 12 herë dhe ju kthehem sërish si nga e para. Po ashtu edhe novelave të "Arkadia e Largët", të cilat i kam lexuar mbi 5 herë, jo vetëm për tematikën e larmishme, por edhe për stilin krejtësisht të veçantë.

Shefkiu nuk e programonte kohën kur shkruante. Kishte ditë që ulej para tavolinës dhe shkruante për 10 orë rresht.

Shpesh çohej edhe nga gjumi dhe shkruante për disa orë edhe natën… Nuk kishte regjim të caktuar, por pas viteve ‘’90 ai shkroi me shumë temp dhe botoi shumë libra.

Përveç vëllimit me poezi “Feniks”, vëllimit me novela “Arkadia e Largët” dhe romanit “Puthja e ngrirë” që u shkruan në kohën e dikaturës dhe u ruajtën me shumë kujdes nga ne të dy, pas viteve ‘’90 shkroi e botoi shumë libra si: “Njëmijë vjet dashuri”, “Argonatutët”, “Vila e magjepsur”, Salamandrat”, “Filantropi”, “Gjenerali nuk dëshiron të vdesë kot”, “ Njëzet novela për dashurinë”, “Sagë mbretërore”, “Lumi me 100 zemra”, “Elbasan-dashuria ime”, “Gjergj Elez Alia”, “Toraks” etj… E adhuronte Elbasanin, të cilit i kushtoi disa libra. Njëherë i thashë: Sa shumë ke shkruar dhe sa shumë e do Elbasanin! Po Elbasani ç’bëri për ty?!

- Poetët janë njerëz me huqe të mëdha, tekanjoz dhe shpesh grinden edhe me vetëveten. Ju si i përballonit huqet krijuese apo njërëzore të Shefkiut?

- Po. Kam dëgjuar për poetë të ndryshëm dhe huqet e tyre. Dua të theksoj se Shefkiu nuk kishte huqe, ishte njeri i qetë, human, tepër i ndjeshëm, filantrop, shumë i ditur por njëkohësisht shumë modest, me shumë humor dhe shumë familjar. I deshi dhe i respektoi prindërit, vëllanë dhe motrën e tij deri në fund të jetës. E adhuronte familjen e tij dhe sakrifikoi shumë për të.

- Poetët mbahen si njerëz të dhembshur dhe humanist, biles edhe dorëlëshuar kur vjen puna për të ndihmuar miqtë, shokët në nevojë por edhe familjarët. Shefkiu si i kishte marrëdhniet me paratë, kursente apo duhej gjithnjë që ti t’ia mbaje llogaritë?

- Nuk mund të jesh një lirik brilant dhe të mos jesh i dhembshur apo human. Po e ilustroj me një ndodhi. Një ditë vjen në shtëpi dhe më thotë me shumë dhimbje: A e di që sot pashë një kolegun tim që ka qenë gazetar, ka botuar edhe dy libra dhe shiste banane në rrugë. Sa keq e kam ndjerë veten!!!….

Ju përgjigja se ne qemë me fat që unë punova shumë vite si notere, sepse të njejtin fat mund të kishim patur edhe ne. Tek kolegu i tij i mbeti mendja për shumë kohë.

Ndjeshmërinë e Shefkiut po e ilustroj edhe me një shembull tjetër. Ne kemi një shtëpi në një fshat të Tiranës. Shkonim në çdo fundjavë. E adhuronte atë shtëpi pasi natyra atje është e virgjër. Kur niseshim për në fshat nuk harronte të merrte me vehte ushqim për zogjtë apo për ndonjë kafshë shtëpiake që mund të kishte mbetur pa ngrënë (ne nuk mbajmë kafshë në shtëpi). Kënaqej kur ndihmonte financiarisht banorët e fshatit. Ishte njeri me zemër të madhe. Ndjente kënaqësi të paparë kur redaktonte librat që i jepnin shokët apo miqtë…dhe gjithshka e bënte falas dhe me shumë kënaqësi.

- Shefkiu ishte po kështu edhe aq i përkushtuar ndaj teje, të mbështeste dhe gjendej kudo. Pyetja ime ka të bëjë përsëri me ndonjë veçori njerëzore të tij?

- Në të gjitha kohët ka qenë njeri me mendime përparimtare. Në çdo periudhë të sikletshme që kam kaluar, kam qenë me fat që pranë vetes kam patur një shok të mrekullueshëm që me fjalët e kështillat e tij të lehtësonte çdo situatë të vështirë.

-A shpenzonte Shefkiu për botimin e krijimtarisë së tij, për bibliotekën e madhe dhe mirëmbjatjen e saj? Shpeshherë gratë e shkrimtarëve bezdisen nga shpenzimet e bashkëshortëve për botimet. Në këtë aspekt si kanë qenë

marrëdhëniet tuaja?

- Shefkiu nuk shpërdoronte. Ishte kavalier, i pëlqente që t'i qeraste shpesh shokët e miqtë, por pjesa e tij që nuk e njihte kursimin ishte shpenzimi për të botuar librat, pjesën më të madhe të të cilëve e falte.

Ai kishte shpirt artisti dhe jo tregtari…Të gjithë librat e Shefkiut, (26 botime pas viteve ‘’90) janë botuar nga vetë familja pa asnjë subvencion.

Sikurse ju thash më parë, unë e adhuroj letërsinë dhe krijimtarinë e Shefkiut e kam çmuar si brilante, prandaj kam patur kënaqësi të shpenzoj për botimin e librave të tij, i cili i la kulturës shqiptare 35 botime me vlera të mëdha artistike, por edhe për mesazhet që ato përcjellin.

-Në disa libra të Shefkiut dominon tema e patriotizmit. Nga i buronte kjo ndjenjë krenarie për atdheun dhe kombin?

-Shefkiu, përveç të tjerave ishte shumë patriot dhe nuk e kuptonte kurrë jetën jashtë Shqipërisë. Më kujtohet një moment, rreth viteve 1995-1996, në një bisedë me Kleanthi Koçin, një nga civilistët më të mirë të Shqipërise, por edhe me kulturë të gjerë, i cili më thotë: I kemi lexuar me një frymë familjarisht librat e Shefkiut dhe na kanë pëlqyer shumë. Por vetëm dua të di, me kë është, sepse librat e tij kanë sens kritik?

I thashë se edhe unë e kam pyetur Shefkiun për këtë, por përgjigja e tij ishte: **Jam me Shqipërinë dhe shqiptarët**, sepse sado i mirë të jetë një shtet apo një elitë e caktuar politike, gjithmonë ka vend për t'u kritikuar. **Dhe nëse shkrimtari bëhet palë me shtetin, ai nuk është më në misionin e tij**… Një shkrimtar dinjitoz është gjithnjë në opozitë me shtetin. Kjo është arsyeja që Ai adhuronte shkrimtarët e mëdhenj shqiptarë që nga Naimi, Çajupi, Ndre Mjeda, Migjeni, Fishta,

Kuteli, Poradeci, Petro Marko, të cilët i çmonte jo vetëm për penën e tyre të artë por edhe si njerëz dinjitozë.

Si prozator e poet brilant, por edhe si piktor shumë i mirë që i dha aq shumë vendit të tij, Shefki Karadaku u shpërblye me një pension fare modest.

Rreth tre muaj përpara se të ndrronte jetë, i them: Shefki, më habit fakti se përveçse je një nga autorët më të mirë që ka patur dhe ka Shqipëria, ti je dhe shumë njerëzor. Pse ky qëndrim kaq i heshtur ndaj teje?

- Ka një arsye m'u përgjigj se, **nëse letërsisë time do t'i jepej vendi që meriton, duhej të rrëzohej letërsia e realizmit socialist**, pasi në librat e mi është pasqyruar realisht jeta e çdo periudhe për të cilat kam shkruar, pa zbukuruar e idealizuar periudhat e vështira që kemi kaluar, veçanërisht atë të kohës së diktaturës. A nuk e sheh se me çfarë fanatizmi e

ruajnë atë letërsi ?!

Për ta përmbyllur do të thoja se Shefkiu ishte në sintoni të plotë si shkrimtar dhe njeri i mrekullueshëm, dhe unë kam qenë me fat që për rreth gjysmë shekulli isha bashkëshortja e tij. Ai nuk jeton më, por kudo që rrotullohem në shtëpi më duket sikur e kam pranë, pasi kudo prek librat e shumtë të tij që përbëjnë një pasuri tejet të vyer, jo vetëm për familjen, por parasëgjithash për kulturën tonë kombëtare.

II

NGA AKADEMIA PËRKUJTIMORE

MARGARITA XHEPA:

Poezia e Shefki Karadakut ka botë, ka ritëm e muzikalitet

Ikona e teatrit dhe kinematografisë shqiptare Margarita Xhepa, Artiste e Popullit dhe Nderi i Kombit shprehet për poetin dhe shkrimtarin e mirënjohur Shefki Karadaku:

"Në jetën time të gjatë artistike kam recituar shumë poezi të poetëve tanë. Gjithmonë më ka ngjitur më shumë poezia e poetëve shqiptarë. Kam recituar vjershat e poetit tonë të madh kombëtar Naimit, të Nolit, Ali Asllanit, Fishtës, Migjenit, Agollit e Kadaresë, por poezia e Shefki Karadakut më ka mahnitur. Shefkiun e kam njohur dhe lexuar që kur Ai punonte në redaksinë e revistës më të bukur të kohës me

emrin sinjifikativ “Ylli”.

Më erdhi shumë keq për ndarjen nga jeta të tij. Vdekja e një krijuesi e ndalon për një çast rrjedhën e jetës. Kur Nadirja, bashkëshortja e tij, juriste e njohur në Tiranë, më kërkoi që të merrja pjesë në dokumentarin kushtuar Karadakut, me gjithë moshën e thyer dhe shqetësimet shëndetsore, nuk mund ta refuzoja. U mahnita kur para se të nisja interpretimim lexova shumë poezi të Shefkiut nga vëllimet e zgjedhura “Feniks” dhe “Toraks” dhe nuk dija kë të recitoja e kë të lija sepse të gjitha ishin shumë të bukura. Poezia e Shefki Karadakut ka botë, ka ritëm e muzikalitet, ndaj e interpretova me shumë ndjenjë. Jam e lumtur që sado pak dhashë ndihmesën time në promovimim e veprës letrare të Shefki Karadakut”.

SHKRIMTARI SHEFKI KARADAKU, INDIVIDUALITETI KRIJUES DHE NJERËZOR

Dr. Mujë Buçpapaj

Në këtë përvjetor të ndarjes nga jeta të mikut tonë Shefki Karadaku, kemi rast për të risjellë fuqinë e veprës së tij letrare, si një korpus origjinal prej 35 veprash në prozë dhe poezi, e cila mendoj se pati dhe ka një ndikim në letërsinë tonë kombëtare.

Si studiues, kam vënë re se vendi i Shefki Karadakut në letërsinë shqiptare nuk është përcaktuar kurrë në mënyrë të kënaqshme nga kritika letrare dhe historianët e letërsisë dhe kjo mendoj për shumë arsye.

Së pari, Karadaku ishte një poet dhe prozator i rrallë që shkroi jashtë rrjedhave zyrtare dhe metafizika e harmonisë së tij krijuese nuk u vinte për shtat koncepteve të kritikës standarte të realizimit socialist.

Kjo kritikë nuk i dha vendin e merituar, por edhe Shefkiu ishte nënçmues si ndaj kritikës ideologjike ashtu edhe ndaj asaj klanore dhe të çorientuar të pas viteve 1990.

Së dyti, Shefkiu ishte një individualitet i fortë njërëzor dhe

poetik, ishte një lirik i çiltër, mjeshtër i vargut dhe i teknikës poetike dhe këto i mjaftonin për të qëndruar larg poezisë së angazhuar dhe brohoritëse që siguronte shpesh privilegje, karrierë dhe shpërblime zyrtare.

Shefkiu qysh me librin e parë me poezi "Kënga e karrove të drithit", botuar më 1967, shënoi një kthesë në lirikën e kohës, duke marrë admirimin e mijëra lexuesve. Ky origjinalitet vijoi i pazbehur deri në vitet 2010 kur ai e pasuroi më tej këtë poezi duke mbetur besnik i stilit të tij, teknikave dhe metrikës së tij klasike. Ashtu si Poradeci pati një inspirim të përjetshëm liqenin edhe Shefkiu e pati Elbasanin e tij, të cilit i kushtoi katër libra me poezi.

Së treti, mendoj se Shefkiu si poet nuk ishte i rehatshëm për kritikën. Ai ishte një zë i pagabueshëm poetik dhe lirika e tij mistike nuk kishte parasysh këtë kritikë, gjithmonë të njëanshme, por një liri individuale universale si një vepër me ndikim të gjatë si një eksplorim gjuhësor dhe përvojë e rrallë njerëzore që i drejtohet sa bashkëkohësave aq edhe së ardhmes.

Së katërti, gjuha, leksiku, ligjërimi, lënda, teksti, nënteksti, kuptimet dhe nënkuptimet, inteligjenca dhe filozofia krijuese, ishin shumë përpara mediokritetit që përgjithësisht kishte mbytur kritikën nga njëra etapë në tjetrën.

Qëndrimi ndaj veprës letrare të Shefki Karadakut ka zbuluar humnerën e madhe që ndan këtë kritikë dhe trupë studimore në përgjithësi me vlerat e mirëfillta letrare që i qëndruan dhe do t'i qendrojnë kohës, jo falë vlerësimeve të jurive klanore, nisur me kritere jashtë letare dhe jashtë estetike, por për shkak të fuqisë artistike dhe lidhjeve me të ardhmen. Shefkiu mbetet si poet lirik në historinë tonë të letërsisë, si vijues dinjitoz i kësaj tradite dhe brenda kësaj tradite të madhe

poetike shqiptare, me një numër të konsiderueshëm të poezive të tij të përzgjedhura nga librat: "Kënga e karrove të drithit", botuar më 1967, "Meloditë e Shkumbinit" 1968", "Ylberi" 1973, "Mozaik lirikash", 1977, "Toka e etërve" 1980, "Ujëvarë" 1983, "Feniks" shkrur ne vitet 1972 – 1985 dhe botuar me 1993 si dhe "Perëndimi i Gjatë", 1994.

Së pesti, Shefki Karaduku dhe vepra e tij në prozë janë një monument i vuajtjes dhe inspirimit të thellë te lirisë. Karadaku që nga romani "Puthja e ngrirë" 1993, deri tek "Vila e magjepsur", ka evokuar fatet tragjike njerëzore në kohë okupimesh ideologjike, moniste.

Ai përmes ndërthurjesh të jetës bashkëkohore në liri me historinë tronditëse të totalitarizmit, ka pasuruar prozën bashkëkohore dhe rritur atë, pavarësisht heshtjes së kritikës. Shefkiu ishte një mjeshtër i prozës, ishte një shkrimtar i lirisë, pra edhe "një shkrimtar pa leje" siç thotë një miku im. Ai mbijetoi vetëm falë talentit të tij, duke i dhënë akses jetës njerëzore përmes një rrëfimi të sofistikuar dhe magjepsës.

Ndryshe prej shumë krijuesve, Shefkiu si poet dhe shkrimtar ishte rezistent dhe indiferent ndaj strukturave të pushteteve në të gjitha kohërat. Në të gjithë prozën e tij si: "Rrugët e para " novelë 1968, "Kur kërcasin boçet e pishave", novelë 1973, "Puthja e ngrirë" roman 1993, "Arkadia e Largët", novelë 1993, "Njëmijë vjet dashuri", roman pjesa e parë 1994, "Argonautët", roman pjesa e dytë 1994, "Gjenerali nuk dëshiron të vdesë kot", Novela 1995, "Vila e magjepsur", roman 1996 etj, ai është një mbrojtës i fatit të individit.

Ai, shumë zhgënjime dhe disfata të njeriut shqiptar i sheh si pasojë e keqpërdorimit të lirisë nga strukturat abuzuese të pushtetit, prandaj si itelektual, si shkrimtar dhe njeri erudit, ishte skeptik i përhershëm ndaj tij. Në të gjithë prozën e tij ka

revoltë të fuqishme, ndaj devijimeve të shoqërisë, të kthesave dramatike të qytetërimit tonë, pasi ai ishte një eksplorues i shoqërisë së aryes, humanizmit dhe lirisë, tipare këto që e bëjnë atë një shkrimtar të gjithëkohshëm.

Së gjashti, Shefkiu ishte një shpirt melankolik i qytetit të origjinës së tij Elbasanit, një qytet ku ndërthuren kultura, mite dhe trashëgimi të forta të botës shqiptare. Kjo i ka mjaftuar për të qënë një poet sfidues ndaj zhurmave dhe ndikimeve jo estetike.

Kur lexojmë Shefkiun ai na detyron të dalim nga zhurmat e përditshme të ekzistencës tonë të kërcënuar nga varfëria, sëmundjet, epidemitë dhe luftrat, për të hyrë në magjinë e lirikave të tij, plot ndjesi muzikore dhe zëra që vijnë nga një botë tjetër mistike , ideale që ai është përpjekur të krijojë dhe rikrijojë për ne dhe për lexuesit që do të vijnë pas nesh.

Vepra e tij në prozë, si një faqe plot dramë e historisë, e shkruar me një zgjuarsi të madhe gjuhësore dhe e shprehur në forma të panumërta, sjell revoltën, protestën e njeriut të pafuqishëm kundër arbitraritetit të historisë tonë.

Ai i bën një shqyrtim të pakorruptueshëm kësaj shoqërie që është vetë jeta e tij, që është vetë jeta jonë, por edhe më tej është një histori e gjithë njerëzimit.

Bordi Editorial Ndërkombëtar i gazetës "Nacional"

I jep shkrimtarit Shefki Karadaku "Çmimin për vepër jetësore" me motivacion: "Vepra e tij, si një shprehje e vuajtjes dhe guximit krijues, ndërthur bukurinë lirike, me narrativën tragjike të ekzistencës, fuqinë epike me kërkimin e së vertetës, e cila ka ushtruar ndikimin më të madh në letërsinë bashkëkohore shqiptare, me mesazhe të

forta për të gjithë njerëzimin.”

Për Bordin Editorial Ndërkombëtar të gazetës “Nacional”

Kryetari
Dr. Mujë Buçpapaj

Certifikatë

Bordi Editorial Ndërkombëtar i gazetës “Nacional”

I jep shkrimtarit Shefki Karadaku

“Çmimin për vepër jetësore”, me motivacion:

“Vepra e tij, si shprehje e vuajtjes dhe guximit krijues, ndërthur bukurinë lirike, me narrativën tragjike të ekzistencës, fuqinë epike me kërkimin e së vertetës, e cila ka ushtruar ndikimin më të madh në letërsinë bashkëkohore shqiptare, me mesazhe të forta për të gjithë njerëzimin.”

Tiranë, më 16.03.2022

KRYETARI
DR. MUJË BUÇPAPAJ

KUR PUNONIM ME SHEFKI KARADAKUN NË REVISTËN "YLLI"

Kozeta MAMAQI

Mbas disa vitesh pune në gazetën "Adriatiku", të rrethit të Durresit, u emërova gazetare në Revistën "Ylli" në Tiranë. Ishte gëzim për mua, se ishte revista më e mirë që dilte në vend.

Kryeredaktori, Nevruz Turhani, mbasi më priti në zyrën e tij, më foli për sektorët që do të mbuloja. Më pas, më shoqëroi te zyra ku do të punoja. Më prezantoi me gazetarin që ishte atje e me të cilin do të ndanim atë zyrë.

- Shefki Karadaku- tha.

- Oh, thashë, poeti, shkrimtari. Kam lexuar prej tij.

Shefkiu vuri buzën në gaz.

U prezantova edhe me gazetarët e tjerë: Agim Cerga (Sekretar kolegjumi), Pirro Naçe, Dhimitër Ligori (foto-reporter). Kaq ishin. Revista dilte një herë në muaj.

Në të njejtën zyrë me Shefkiun nuk punova për shumë kohë. Ndihesha mirë, meqë ai ishte vëllai i Astritit, me të cilin kishim qenë sëbashku për katër vite në Universitet. Edhe ai ishte gazetar, shkruante bukur, ishte përherë i gjallë e plot gëzim.

Te Shefki Karadaku pashë gazetarin e zot, që përpiqej të realizonte shkrime të bukura, me argumente dhe arrinte të jepte më të mirën. Ishte i palodhur, këmbëngulës, skrupuloz në punë dhe shumë miqësor, i gatshëm për ndihmë në shoqëri, i butë në sjellje si ai.

Ne diskutonim, jo vetëm për materialet e shkrimet për numrin përkatës të revistës, por edhe për poezitë e tregimet që shkruante ai, për letërsinë në përgjithësi.

Në krijimtarinë e Shefkiut kish shumë sinqeritet, rrjedhje mendimi apo ndjesie me art, lirshëm.

Modestia, që kishte Shefkiu ishte aq e dukshme, aq e vënë re, sa të dukej që ish një me qënien e tij.

Them, që kjo dhe urtësia e mirësia në thelb të tij, u bënë shkaku, që edhe pse me një krijimtari shumë të pasur, të mos çmohej sa duhet e si duhet.

Dua të shtoj, që në ecurinë e suksesshme të Shefkiut në fushën e letrave, një shtysë e frymëzim për të ka qenë shoqja e tij e jetës, Nadirja, lexuesja e parë, inkurajuesja e palodhur. Unë jam dëshmimtare e kësaj të vërtete, që e kam ndjerë si një bukuri të dashurisë mes tyre.

DISA TIPARE DALLUESE TË PROZËS SË SHKRIMTARIT SHEFKI KARADAKU

Xhevat MUSTAFA

Është prej kohësh i mirënjohur fakti se shkrimtari Shefki Karadaku, që vdiq më 16 mars 2021, me "dashuri të parë" poezinë, na ka lënë një fond të pasur edhe në prozë. Pas afirmimit si poet me individualitet të spikatur për tematikën, lirizmin, meditimin deri në filozofim, figuracionin e pasur, të gjetur e të natyrshëm, më 1991, në mënyrë figurative mund të thuhet se ai "u divorcua" me poezinë dhe u lidh shpirtërisht, kohërisht dhe fizikisht me prozën. Nuk tregohem subjektiv, nisur nga qenia edhe vetë prozator, nëse shpreh opinionin apo bindjen se Shefki Karadaku u bë, mbeti dhe do të kujtohet më i madh si prozator se sa si poet.

Në gjininë e romanit ai shkroi dhe botoi romanet: "PUTHJA E NGRIRË" (1993, 2008), që personalisht do ta vlerësoja si kryeveprën e tij në prozë, "NJË MIJË VJET DASHURI" (Pj.I-1995), "ARGONAUTËT"(Pj. II, 1995, "VILA E MAGJEPSUR" 1996; "SALAMANDRAT" 1997, "FILANTROPI" 1999, "PANEGJERIKUS" 2000, "GJERGJ ELEZ ALIA" 2004; "SAGË MBRETËRORE" apo "100

ditët shqiptare që tronditën botën" (Roman epope, 2006), tri romane në një: "APOKALIPSI I GJETHEVE", "VILA E MAGJEPSUR" dhe "SALAMANDRAT" - 2017

Ndërsa në gjininë e tregimit e të novelës botoi : "RRUGËT E PARA" (Tregim, 1968), "ARKADIA E LARGËT" (Përmbledhje me novela, përkthyer edhe në gjermanisht, "GJENERALI NUK DËSHIRON TE TË VDESE KOT" - 1995, "KRRILLAT E SHIUT" - 1996, "LETRA MBRETËRVE", "20 NOVELA PËR DASHURINË", "GARDEROBA E OFIQARIT GRI" - 2016).

Nëqoftëse bëjmë një vështrim kohor do të na bjerë menjëherë në sy se brenda rreth 25 viteve , ai shkroi dhe botoi gati një roman apo përmbledhje me novela brenda një harku kohor prej rreth 16 muajsh. Për më tepër, ajo që është më e rëndësishme, ky rendiment i lartë sasior nuk e ka cënuar aspak cilësinë artistike të çdo libri, duke mbetur në kuotën e lartë të kapur qysh në fillim me "Puthja e ngrirë".

Shkrimtarë si Shefki Karadaku, të cilët kanë sjellë jo vetëm bollëk titujsh librash me cilësi të lavdërueshme e të lakmueshme nga shumica e kolegëve në poezi e prozë, por edhe risi të padiskutueshme në letërsinë tonë, meritojnë gjithmonë vëmendje nga kritika letraro-artistike dhe nga studjuesit e letërsisë sonë kombëtare. Aq më tepër që krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë të tjera evropiane, si gjermanisht, anglisht....Por, fatkeqësisht, edhe pse ishte një nga shkrimtarët me më shumë tituj veprash të botuara, më të shquar e më të lexuar, sidomos pas vitit 1990, kritika letrare, Bashkia e Elbasanit dhe e Tiranës, Ministria e Kulturës, Ministria e Arësimit, Presidenca, nuk i kushtuan vëmendjen dhe nuk i dhanë vlerësimin që meritonte.... Ndoshta, sepse nuk bënte pjesë në listën e shkrimtarëve, që kishin lënë Enver

Hoxha dhe Ramiz Alia...? Ndoshta, sepse nuk iu bashkua si mbështetës fanatik asnjerës prej partive kryesore? Ndoshta, sepse iu shmang në prozë me vetëdije të plotë dhe jo pa llogaritjen e rrjedhojave, kallëpeve dhe temave të sheqerosura, me trajtime dhe zgjidhje skematike të realizmit socialist, duke pasur prodhimtari cilësore dhe të pëlqyeshme pas vitit 1990??? Ndoshta, sepse pati guximin që në novelat dhe romanet e tij të vinte gishtin në të këqijat e shumta të diktaturës, sidomos ndaj njeriut, të drejtave dhe lirive të tij, e pas vitit 1990, në plagët politike e sociale të tranzicionit dhe të demokracisë allashqiptare?

Sipas gjykimit tim, proza në 3 përmasat, pra në tregime, novela dhe romane e Shefki Karadakut, shquhet apo dallohet:

- për origjinalitet, për spektrin e gjërë të subjekteve, nga lashtësia deri në ditët e sotme...;

- për narracionin apo rrëfimin e zhdërvjelltë e të natyrshëm;

- për strukturimin intrigues dhe mbërthyes nëpërmjet emocioneve të shumta e të forta nga faqja e parë deri tek e fundit;

- për gërshetimin me finesë, përpunim mjeshtror artistik, estetik, emocional, shije të realizmit kritik apo magjik me lirizmin dhe poetizmin, duke lënë qëllimisht apo me paramendim mundësi tek lexuesit, kritikët dhe studjuesit për të kuptuar dhe menduar se edhe në prozë ai ndjehej shpesh poet;

- për lehtësinë e ndërthurjes artistike mes linjave fiction dhe atyre realiste, historike, të përjetueshme, apo fryt i fantazisë krijuese dhe artistike...;

- për figuracionin e pasur, të gjetur, të çlirët;

- për përkujdesjen e madhe edhe për individualizimin me penelata të lehta fizike, shpirtërore e gjuhësor të personazheve,

sidomos të atyre kryesorë...

Stili i Shefki Karadakut si prozator dallohet edhe nga përdorimi artistik i fantazisë dhe imagjinatës për të krijuar realitetin, si dhe i referimeve plot lehtësi dhe origjinalitet i të shkuarës, në funksion apo shërbim të kohës që përjetojnë personazhet. Me këto karakteristika apo veçori artistike në norracion, kompozicion dhe në gamën e gjërë të mesazheve dhe apeleve, na bën të kujtojmë herë here, nga pak dhe jo si kopje, por duke mbetur vetvetja, SHEFKI KARADAKU dhe SHQIPTAR nga fundi i thembrës deri në majë të kokës, edhe shkrimtarin tonë të madh Petro Marko, shkrimtarin e madh austriak, Stefan Cvajk, atë gjerman Erich Maria Remark, shkrimtarët e mëdhenj meksikanë Octavio Paz dhe Gabriel Garcia Markez, shkrimtarin e mirënjohur argjentinas Ernesto Sabato....Përzierja dhe pranëvënia e reales dhe imagjinares, të çuditëshmes dhe ndryshimeve kohore, përshkrimeve ekspresioniste, elementeve të befasisë, i japin mundësinë autorit që nëpërmjet rrëfimit letrar të përshkruaj botën komplekse të personazheve, e të brendashkruaj në vepër realitetin jetësor të asaj kohe. Rrjedhja kronologjike e ngjarjeve vjen natyrshëm dhe shpesh në mënyrë jo-lineare, por me thyerje apo kapërcime të lehtësishme kohore, psikologjike, komunikimi... Interesante është bota shpirtërore e personazheve, e cila na zbulohet më shumë nëpërmjet veprimeve se sa dialogëve dhe rrëfimeve të autorit, duke zgjeruar kështu në mënyrë të ndjeshme hapësirën e komunikimit real dhe emocional me lexuesin. Autori përdor me sens mase e mjeshtri edhe referencat nga e kaluara, u jep ngjyra e karakteristika të reja protagonistëve të së kaluarës, duke u mundësuar atyre t'i flasin me natyrshmëri dhe dobishmëri kohës së sotme.

POEZIA E SENDËRTUAR NË PROZËN E SHEFKI KARADAKUT

Sakip Cami, *poet dhe publicist*

Shefki Karadaku është i spikatur si në poezi edhe në prozë, me novelat dhe romanet e tij me subjekte dhe personazhe që të mbeten në kujtesë. E veçanta e prozës së tij është poezia e shkrirë brenda saj me figura letrare dhe artistike që të mrekullojnë. Karadaku ka shkruar e botuar 13 libra me poezi, 12 libra me novela e 10 romane ku do të veçoja romanin "*Puthja e ngrirë*", një roman i shkruar në vitet 1990 - 1991 që trajton egërsinë e diktaturës komuniste që po jepte shpirt duke vrarë e plagosur, dhe kjo e dhënë nëpërmjet një çifti të rinjsh, Rrok Delisë dhe Zibel Sinës, të cilëve falangat komuniste ua ngrinë puthjen dhe ua mohuan dashurinë duke i vrarë në kufi.

Karadaku ka dhënë një kontribut të madh edhe për romanin historik ku do të veçoja romanin "Sagë mbretërore" që në fakt është një triptik me tre romane.

Pjesa e parë apo romani i parë i këtij triptiku me titull

"*Rebelimi*" flet për mbretërimin e shkurtër të Princ Vidit dhe ngjarjet që u zhvilluan në Shqipëri deri në largimin e tij dhe fillimin e Luftës së Parë Botërore. Ngjarjet tregohen me mjeshtëri artistike nëpërmjet personazhit kryesor Kanan Griva.

Pjesa e dytë titullohet "*Prag lufte*" dhe flet për kapitullimin dhe nënshtrimin e Mbretit Zog para fashistëve italianë që e gllabëruan Shqipërinë para se të fillonte zyrtarisht Lufta e Dytë Botërore.

Ndërsa pjesa e tretë me titull "*Eklips*" tregon si u eklipsuan Mbretëria dhe Parlamenti Shqiptar nga Mbretëria Italiane dhe gjasme qeverisja shqiptare në periudhën e Luftës së Dytë Botërore.

Nëpërmjet personazheve konkrete historikë dhe personazhit personifikues Kanan Griva, lexuesi futet dhe kupton vorbullën e ngjarjeve të popullit tonë nga fillimi i Luftës së Parë Botërore deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, periudhë me dritë hije edhe në ditët e sotme. Një roman tjetër i veçantë historik për nga mënyra e trajtimit dhe e të shkruarit është edhe romani "*Gjergj Elez Alia*" që bashkon legjendën, historinë dhe kumtin tonë të rezistencës ndër shekuj.

Të bën përshtypje se Karadaku në botimet e tij nuk ka vrapuar për nga sasia, përkundrazi libra si "*20 novela për dashurinë*" dhe 20 novelat e përmbledhura në librin me titull: "*Garderoba e ofiqarit gri*" tregojnë se Shefkiu i ka përmbledhur krijimet e tij në libra voluminozë të një linje apo subjekti.

Edhe botimet e para viteve 90 tingëllojnë aktuale edhe sot, sepse Shefki Karadaku ishte një shkrimtar modern i pëlqyer dhe i pakontensueshëm.

Mungesa e institucionit të kritikës letrare pas viteve 90 ka bërë që shkrimtarë e poetë si Shefki Karadaku të lihen mënjanë dhe të mos vlerësohen, ndërkohë që krijimet e tij janë botuar edhe jashtë Shqipërisë, por për të vlerësuar nuk është kurrë vonë.





SIMBOLIKA E ROMANIT "PUTHJA E NGRIRË" TË SHEFKI KARADAKUT.

Andon Andoni

Që në paradigmë të titullit të romanit "Puthja e ngrirë" të Shefki Karadakut, futemi përkitazi, në një botë simbolike, përmes reales dhe ireales, jetës dhe vdekjes, dashuri mes puthjesh dhe lektisjesh plot pasion në ngjizje të ardhmërisë dhe ngrirjes, e ngrira, e acarta, e ftohta prej akulli, në imagjinatën e një bote që mbetet pas në kohë dhe hapësirë dhe që është e destinuar të humbasë dhe shkrihet si akulli.

Dhe kësisoj, që në faqet e para të romanit futemi në një botë plot ndijimesh, brenda shpirtit të shqetësuar të shkrimtarit, në ato vite të kapërcyellit të madh, vitet 90, me përmbysjen e madhe dhe fillesat e një jete të re, të një ëndrre të madhe, kaq të dëshiruar prej nesh, prej shqiptarëve, për lirinë e munguar.

Përmenda më sipër simbolikën e këtij romani që në titull, pasi dhe vete struktura e tij është një simbolikë e thukët, nga fillimi deri në fund; me një oaz të quajtur Nag, ku parakalojnë jetë njerëzore, që nga spiunë dhe vëzhgues, piktorë dhe njerëz

të artit, intelektualë të spikatur dhe udhëheqës të përçudnuar dhe të përvuajtur të vetë sistemit të cilin, e kanë mbajtur në këmbë por edhe kanë ëndërruar heshturazi ta përmbysin.

Fabula është e thjeshtë; në një qytezë kaq të afërt me botën e jashtme, me të cilën mund ta lidhë vetëm një urë përmbi liqenin Çad, me Nag, ku bije vetëm shi i përbaltur, është ide dhe risi e mendjeve të çliruara nga dhuna dhe diktati i mendjeve të bjerrura prej intelektualësh dhe botës së artit.

Dhe do kujtoja për lexuesin, se pikërisht , në jetën reale të kapërcyellit të sistemeve në vitet 90, ishin pikërisht shkrimtarët dhe artistët që u përplasën me diktaturën duke i shkaktuar asaj krisjen e parë, në pranverën e '89-tës, dhe më pas me largimin e Kadaresë dhe më tej.

Shumë syresh ishin pjellë e vete sistemit. Zaten njihet fakti që indulgjenizmi është përqafuar prej rinisë intelektuale të kohës, me dëshirën për përmbysjen e etërve ideologjikë.. A nuk është dhe personazhi kryesor i këtij romani Zibel Sina, e dashura e Rrokut që ngrihet mbi sistemin që ka mbajtur në këmbë të atin dhe familjen e saj?

Duket se shkrimtari i mëshon përkitazi, idesë se "revolucioni; - tashmë në rënie, - ha bijtë e vet", ka motivuar linjën kryesorë të romanit.

Pikërisht kjo linjë është pjesa më e arrirë dhe më e bukur, e realizuar nga pena e autorit në këtë roman.

Por le ti kthehem edhe njëherë simbolikës.

Përdorimi i natyrës, i një përshkrimi rrëqethës, nga fillimi në fund me shi, përbaltje, zezim dhe gurë, është një nga aspektet më të realizuara të veprës.

Natyra vetë, qan pafundësisht, vuan pafundësisht, është e zezë dhe e zymtë si vetë jeta e këtyre njerëzve që degdisën në Bug dhe syrgjynosen në vetminë dhe zvetënimin e imagjinuar.

Sigurisht, ata që e pësojnë janë njerëzit shpirtmëdhenj nga njëra anë, që e duan jetën, por edhe atë për të cilët jeta hakmerret, pasi kanë qenë vegla e shërbëtorë të devotshëm të sistemit, si familja Sina.

Në roman, jo pa funksion autori ka përdorur mjeshtërisht emra personazhesh dhe toponime një rrokshe si Nag, Çad, Rrok, Mek, etj që kanë një tingëllimë dhe ngjashmëri me krismën e një arme në mugëtirë. A s'janë të tilla krismat që i ndjekin pas ikanakët e këtij vendi në arratinë e viteve 90, jetët njerëzore të mbetur nëpër telat me gjemba, simboli i izolimit totalitar?

Mjeshtërisht autori ka përdorur edhe një simbol tjetër të cilin do doja ta nënvizoja në këto radhë. Goditja sistematike e Kanad Dikës me gurë. Kjo skenë, që mbart në thelb makabritetin e një shoqërie të paguar për të qëlluar me gurë kundërshtarët, a nuk ngjason me atë të Jezu Krishtit?

"Le ta qëllojë i pari ai që nuk ka asnjë mëkat tek vetja". Dhe a nuk ishte shoqëria jonë, një mëkatare e madhe në pragun e viteve 90, me termin "të gjithë bashkëvuajtes". Ndoshta të gjithë ne në këtë roman frikshën do ti hedhim në tokë gurët e mëkatit, siç do bënin tek e fundit dhe gjykatësit e paguar të Kanad Dikës, vizionarit të hapjes me botën dhe rimëkëmbjes së qytezës Nag.

Romani ka një natyrë moderne për sa i përket portretizimit të personazheve. Janë natyra njerëzore, që në dukje kanë tipare të veçanta, fytyrë, veshje, shtat, etj, Ngjajnë dhe janë krejt të kundërt me njeri-tjetrin përsa i përket karaktereve, çuditërisht, që nga Pigali, Meku, Zurba Sina, dhe deri tek Basriu, Rroku, Zibeli, Kanadi të ndarë në dy kategori; tri të parët, edhe pse përmenden rëndom në roman, nuk kanë identikit, janë pa fytyrë, pa shëmbëllim, vetëm emra simbol, e megjithëkëtë

janë kaq të qartë dhe prezent në sytë e lexuesit. Të tjerët, madje edhe dy shoqëruesit-vëzhgues, njëri me fytyrë të kuqe si spec dhe tjetri plot prenjka, janë të karakterizuar nga idetë që mbartin, mënyra e të jetuarit plot vitalitet, përmes sakrificës dhe jo rutinës.

Duam të themi se me këtë mënyrë të shkruari, është treguar altrurist. Është kursyer tek përfaqësuesit e pushtetit që po rrënohet, i përfaqësuar vetëm me emra, dhe është dorëlëshuar tek personazhet kundërshtarë të regjimit.

Në roman, le të themi, pihet shumë konjak dhe fërnet, dhe bije çuditërisht shumë shi. A thua se me këtë motiv, të letrarizuar, autori ka dashur të "dehë" botën mbarë në kapërcyellin e vet, apo ti minimizojë tërë vuajtjet e mjerimet njerëzore përmes dehjes marramendëse dhe mpirjes së trurit?

Por ajo që është padyshim linja me e bukur e romanit, është dashuria e Rrokut me Zibelin. A thua se nuk i pengon aspak përkatësia shoqërore, rendi klasor dhe ekonomik? Në realitetin e kohës kur dy botë përplasen me antagonizma për jetë a vdekje, nuk ndodhte, porse në letërsi frikshën, po është e justifikuar dhe e përligjur kjo dashuri. Sikundër dhe antitezat e Kadillakëve dhe vilave plot shkëlqim, të familjes Sina, me kasollet e braktisura, bodrumin e Basriut dhe Rrokut, me krevate hekuri dhe kamionët që hiqen zvarre nëpër baltë, në roman janë të justifikuara.

Së fundi mund të themi se "Puthja e ngrirë" e Shefki Karadakut, botuar në fillim të viteve 90, vjen sot me këtë ribotim me tjetër frymë, me qetësinë e asaj çka mbetur në të shkuarën; me gëzimin e së sotmes që e përmend atë si një ëndërr të keqe si lajtmotiv për një jetë më të mirë të shqiptarëve, pas një burgu të hapur në sytë e botës. Dhe e shkuara është dhe përbën histori.

MEMOIR

SHEFKI KARADAKU - KY APOSTULL I POEZISË, ROMANIT DHE FILOZOFISË NË LETRAT SHQIPE

Agim PIPA

1.

Edhe tani e kujtoj mëngjesin e një vere të nxehtë, aty nga fillimi i viteve ’70 të shekullit të kaluar, kur dola nga shtëpia dhe mora rrugën drejt Lidhjes së Shkrimtarëve këtu, në Tiranë. Unë isha nxënës në shkollë të mesme, në gjak kishin filluar turbulencat e para të talentit, kisha botuar një poezi në vitin 1968 në gazetën “Drita”, kur isha në fillimet e adoleshencës dhe më ishte bërë zakon të dilja të djelave dhe të nxitoja drejt një librarie të vogël që shiste gazeta. Aty, merrja “Dritën”, por edhe “Nëntorin”, dy simotrat që në atë kohë ishin shkolla ime e poezisë dhe e letrave shqip. Zgjata dorën, mora “Dritën”, e shfletova fill tek “ballkoni” ose dyfaqëshi i mesit të saj, për të parë botimet e reja. E para, në krye të dyfaqëshit, e kujtoj mirë, ishte poezia e Shefkiut: “*Kënga e karrovë të drithit*”, ilustruar

bukur me një vizatim, i denjë për rrymën e impresionizmit të asaj kohe. I ndalur në trotuar, nisa ta lexoj, ose më mirë të them, e përpiva poezinë. Ndjeva trupin të më mornicohej. Gjoksi në fillim. Pastaj krahët, pastaj të gjitha gjymtyrët. Poezia ishte e përkryer dhe unë, në heshtje, bëlbëzova: "Je i madh Shefki! Të lumtë mjeshtër dhe faleminderit që ma bëre të bukur këtë mëngjes vere…!"

Vitet kaluan shpejt, Shefkiu sa vinte e bëhej më i afërt përmes poezisë së tij brilante, përmes tregimeve dhe sinqeritetit, ku binin në sy stili i zhdërvjelltë, muzika brenda poezisë dhe pjesëve të tregimeve, fjala dhe gjuha e pasur, aroma e lagjeve dhe kështjellës së lashtë të Scampinonit, ose Elbasanit.

Në fakt, ishte edhe kjo një arsye përse unë e doja dhe e admiroja dita ditës mjeshtër Shefkiun. Origjina ime, nga ana e gjyshit prej babës, ishte lagjia e vjetër "Kala" që kishte nxjerrë edhe ajo dhjetra talente, dhjetra poetë dhe shkrimtarë, dhjetra valltarë dhe argjendarë dhe, mbi të gjithë, Isuf Myzyrin e famshëm përtej kufijve të Elbasanit dhe Shqipërisë; Isuf Myzyrin që njihej në të gjitha trevat e Ballkanit për këngët e tij, për zërin kumbues dhe poetik, për lirizmin dhe magjinë e fjalëve në këngët e krijuara prej tij dhe me të cilat ai kishte bërë për vete veç popullit të Elbasanit, edhe atë të Durrësit, Tiranës, Beratit, Lushnjës, Shkodrës, Përmetit, Vlorës, Dibrës, Prishtinës dhe Gjakovës, Prizrenit, Tetovës dhe Shkupit.

Pikërisht në ato burime të pashtershme të artit tonë të madh, e përfytyroja dhe e mendoja mjeshtër Shefkiun. Ai ishte rritur në Elbasan, aty u bë burrë dhe më pas hapi flatrat, si pëllumb i bardhë dhe nisi fluturimet drejt rrugëve të atdheut, nën dritën dhe frymëzimin e usta Isufit, të profesor Aleksandër Xhuvanit, të gjuhëtarit të rrallë Kostandin Kristoforidhi, të

idealistit të madh Lef Nosi dhe sa e sa emrave të tjerë që u lindën dhe i dhanë shpirt qytetit të mjeshtër Shefkiut dhe qytetit të të parëve të mi.

2.

Apostulli i poezisë, i tregimit, romanit dhe letrave shqipe (këtë e them me bindje të plotë për vetë përmasat e mjeshtrit Karadaku) përbën sot një rast unikal jo vetëm në dukjen, në formën dhe elementë të tjerë të veprës së tij të madhe. Por mbi të gjitha, me përmbajtjen që priret të shkojë fjalë pas fjale, tingull pas tingulli, fonemë pas foneme, ligjëratë pas ligjërate, morfologji dhe sintaksë gjuhësore bashkë, me përmbajtjen që priret të shkojë pra drejt thellësisë së shpirtit të njeriut. Aty, ai ndjehet shumë mirë. Aty, tek lexuesi, tek njeriu i thjeshtë dhe i mirë, tek bujku dhe bariu, tek shkrirësi i furrnaltave dhe minatori, tek inxhinieri, mësuesi, agronomi, arkeologu, gjeologu, mjeku dhe historiani, peshkatari dhe endësja e qilimave, tek Rrapi i Bezistenit dhe tek zonjat që nxjerrin nga duart e arta ballokumet e Ditës së Verës. Apostulli i letrave shqipe Shefki Karadaku është gdhendur sot, si një gravurë me mozaikë të rrallë, në muret e shpirtrave njerëzorë.

Për vlerat ideoartistike të fenomenit Karadaku, Kritika letrare, Lidhjet e Shkrimtarëve, Akademia e Shkencave, shtëpitë botuese si institucione të ekzistencës madhore të librit shqip, revistat, portalet e kohëve e fundit, e kanë analizuar dhe glorifikuar në mënyrën më të mirë veprën, artin superior të Karadakut. Kështu unë nuk do të shprehem për to. Por, për një anë krejt të veçantë të këtij arti: anën filozofike në veprën e mjeshtër Karadakut. Poezia dhe proza e tij sublimojnë nga botimi i parë, deri tek fashikulli i fundit i romanit të tij të papërfunduar, për shkaqe dhe arsye tashmë të njohura. Apostujt

kështu lindin: të falin dashuri nga vetja dhe nga dashuria e Krijuesit dhe ta bëjnë atë dritë në shërbim të njerëzve.

Mbi tryezë kam një prej mrekullive të botuara nga mjeshtër Shefkiu, përmbledhjen me novela "Arkadia e largët", një ribotim i variantit të vitit 1994. E kam lexuar si i dehur, si i çmendur. Novela "Karibda", e para. Pastaj me radhë: "Stiksi i parë", "Ciklopi", "Olimpi", "Minosi", "Panciri", "Stiksi i dytë", "Stiksi i tretë", "Dritarja" dhe, në fund, "Arkadia e largët". O zot çfarë perlash! Çfarë arti dhe çfarë letërsie e madhe. Të gjitha novelat, pa përjashtim, janë të diskutueshme për çmime prestigjioze konkursesh në nivele e rangje kombëtare dhe ndërkombëtare. Të gjitha sjellë në formën më të mirë dhe në stilin e rrymave kontemporane futuriste, surrealiste, avanguardiste. Vende vende proza e mjeshtër Shefkiut shfaqet edhe si një pasqyrë e madhe e "Përroit të ndërgjegjes" së Xhojsit të madh. Por edhe e psikanalistëve, filozofëve dhe shkrimtarëve të mëdhenj: Niçe, Fojerbah, Frojd, Segal, Hygo, Balzak, Zhan Pol Sartr, Albert Camus, Samuel Beket, Erich Fromm, etj, etj. Mjeshtri ynë Karadaku duket sikur është lindur në Elbasan, Vjenë, Londër, Paris, Washington, Tokio, Madrid, Romë, Stamboll, Reikjavik. Proza e tij filozofike ka fytyrë dhe gjymtyrë universale.

Po ndalem pak tek novela "Karibda". Ku, brenda një humnere, apostulli i shenjtorëve të letrave shqipe Karadaku, zbulon realen dhe surealen; ëndërrën dhe gjendjen e vërtetë; frymëmarrjen e munguar dhe energjitë e mëdha mendore, intelektuale, shkencore dhe pozitivitetin që vjen nga një përmbajtje krejt e veçantë, e pangjashme me asnjë prej veprave në prozën shqipe dhe si një kapital tepër i çmuar për ndërgjegjen e lexuesve.

Po citoj:

"Të gjithë e kanë ndjerë, se në embrionin e secilit ekziston britma e mamuthëve të lashtë. Sa më tepër që jemi njerëz, aq më e mjegullt duket ajo kohë. Por natyra nuk ka mençuri e dashuri, por këmbëngulje dhe durim. Ajo e ndjen se ne jemi të dobët para saj dhe veç vepra e të gjithëve na bën më të fortë. Prandaj mundohet të na zhveshë nga ndjenjat, të na bëjë indiferentë si bishat. Kundër kësaj indiference mendova të përdorja gjithë arsenalin tim të brendshëm, nëse kisha më të tillë, për t'u bërë edhe unë një nga elementët e saj, si mamuthi, gurët, shkurret, akulli, uji, urithi, dreri. Por, e kuptova se ishte tepër e vështirë, sepse isha fare i vetëm përballë saj."

Po vazhdoj lundrimin në faqe të tjera të novelës, duke u ndalur në faqen 15 të përmbledhjes me novela, përsëri tek novela "Karibda":

"…sa shpesh dëgjojmë të thonë: "E theri…", "E vrau…", "E rrahu…", "E zhduku…", "E torturoi…", "E futi në burg…", "E la pa ngrënë…" dhe sa pak dëgjojmë fjalët: "Të dua!", "Të kam në zemër", "Je si shpirt…". Madje shpesh herë qeshim dhe bëjmë buzën në gaz si para një formule bajate ose shakaje pa kripë, që nuk e merr asnjeri seriozisht ta pohojë, sepse ka frikë, se mos i thonë: "shpirt pule". Unë e kam tani fjalën dashuri në buzët e thara nga mungesa e lëngjeve. Por ajo nuk më shpëton nga ideja, se nuk kam për të rezistuar shumë gjatë, sepse ajo e ka vendin vetëm atje, ku fytyra ime është e shpirtëzuar në miliona fytyra të tjera, si unë."

Po vijoj me harmoninë, muzikën, poezinë dhe mjeshtrinë e prozës së "Karibdës". Lexoni miq:

"Kam qenë me Jasonin në Kolkidë dhe kam predikuar paqen; me Gutembergun, kur shtypa Biblën e parë; me Pikason,

kur bëra pëllumbin e paqes" dhe ja dhurova njerëzve për t'u thënë: Ja tek e keni dashurinë, mos u bëni kurrë mamuthë, sepse për t'u bërë mamuthë është fare e lehtë. Kaloni këtë grykë (gryka ku gjendet heroi i "Karibdës) dhe kuptoni, se sa larg është njeriu dhe se sa e vështirë është të pranosh Ajnshtajnin; kur ndjen se tremijë vjetët e Hesiodit janë bërë hi para një dolomiti vigan dhe idesë, se përsëri ke filluar të lëvizësh pas me shpejtësi skëterre, po nëpër atë trase, ku kaloi Homeri dhe Galileu, por në mënyrë të kundërt, si nëpër një tunel, ku ndjen të gjitha dhimbjet që ka kaluar për të ardhur deri këtu e për të mësuar të nënshtrosh botën me një pendë dhe Kompas dhe jo me dhëmbë e me kthetra; sepse dhëmbët dhe kthetrat gjithmonë kanë shqyer e çarë, por asnjëherë nuk janë ngjitur deri në majën e kullës Eifel, ose deri në Bruklinin madhështor. Botën e ka udhëhequr një zemër e butë, e brishtë dhe vigane, ndoshta më e madhe se e Everestit…"

Të tilla paradigma dhe parabola letrare, nga tingulli tek ligjërata e drejtë, nga arsyetimi tek pathosi i arsyes, nga e djeshmja e mamuthëve tek e sotmja e kullës Eifel, në magjinë e prozës dhe në filozofinë e unit të Niçes, një un në ekuilibër të plotë mes ditës dhe natës, mes shiut dhe diellit, mes së mirës dhe të keqes, e gjen tek "Karibda" dhe në përgjithësi në prozën e bukur të mjeshtër Karadakut.

3.

Miq! Lexojeni dhe duajeni mjeshtrin e prozës shqipe Shefki Karadaku!

Duajeni për gjerësinë e fjalës dhe mendimin, për lirinë dhe arsyen, për paqen dhe dashurinë që ai na i dhuron falas, pa asnjë taksë, pa asnjë çmim!

Mjeshtri Karadaku është busti i ditës së bukur, është

dashuria dhe ëndrra, lagjia e lashtë e Elbasanit dhe Tiranës, e rrugëve që na çojnë drejt lumenjve dhe drejt deteve, drejt dritës dhe së ardhmes.

Ai është çfarë ne dëshirojmë të jemi, si poetë, si prozatorë, si romancierë dhe filozofë.

Ai sot këndon me gjuhën e lashtë ilire, gjuhën e të parëve tanë. Dhe ne duhet ta çojmë atë në toka dhe qiej të tjerë. Për t'i shpërndarë në gjuhë të ndryshme të botës mesazhet e artit dhe të letrave të mjeshtrit Karadaku! Ai është si ajri, si toka, si shiu, si dielli, si universi.

Miq! Mbajeni thellë ne zemrat dhe në shpirtin tuaj emrin dhe veprën e Shefki Karadakut!

Tiranë, 18 prill 2022

TIPARE TË PËRGJITHSHME POETIKE, PËRFTUAR NGA LEXIMI I LIBRIT "TORAKS", TË SHEFKI KARADAKUT

Adriatike LAMI, ***poete***

Kisha njohje të paktë mbi poezinë e Shefki Karadakut, derisa mora në duar dy vëllimet me poezi: "Toraks" dhe "Feniks".

Përballja e parë më shpuri në poezinë e mirë të para viteve '90. Shija e kësaj poezie sillej duke kombinuar mesazhet, linjat e thjeshta subjektore me veçoritë stilistike të vargjeve.

Gjatë leximit kontakti im i parë ishte me fjalë të veçanta të këtij autori. Mendoj që leksiku i tij poetik përmban fjalë që konfigurojnë Elbasanin. Madje përmbledhjen "Toraks", tek e cila dhe do të fokusohem, do ta përkufizoja si një poemë në vargje për Elbasanin.

Habitati poetik deri në detaje, përfshin përshkrimin e jetës në këtë vend dhe mënyrën sesi ajo lëviz duke përfshirë: sende, shpendë, njerëz dhe shpirtra njerëzorë.

Por në vargjet e këtij libri, Elbasani dhe Shkumbini bëhen bashkë për të na dhënë një perceptim magjepës që zakonisht është karakteristikë e gjinisë së përrallës. Ka një lumë që rrjedh në këtë poezi. Ka një qytet që fanitet, në pjesë të ndryshme të

rrjedhës së këtij lumi.

Lumi është sa real aq edhe kozmik. Fari poetik dhe njerëzor i poetit është Shkumbini.

Një figurë mjaft interesante e librit është Kumria, një zog që kthehet në simbol të komunikimit artistik të poetit me lexuesin. Ajo shëtit si heroi lirik, madje ndonjëherë duket sikur është vetë ai, dhe lë gjurmë jo vetëm në imazhe artistike, por edhe në ndjesitë e ndryshme përftuese.

Kumria sheh gjithçka, dëgjon gjithçka, lëviz kudo e është pjesë e botës dhe konotacionit shpirtëror.

Shpesh Kumria përcjell mesazhe, por nga ana tjetër atë mund ta shohësh thjesht identifikim, duke i lënë në dorë lexuesit pjesën tjetër përfytyruese. Ndonjëherë edhe ajo e nënkuptuar, filozofike.

Notat e lehta të trishtimit shoqërojnë heroin lirik përgjatë gjithë këngës së tij poetike mbi qytetin dhe ndjesitë njerëzore. Krejt natyrshëm lexuesi nuk percepton këngën e pakëndshme të kumrisë, por aftësinë e saj për të zbuluar si qenie e mbinatyrshme ndjesitë dhe përjetimet.

Është kaq e gjallë dhe me dinamizëm saqë të bëhet e domosdoshme, kur në pjesë të ndryshme të librit humbet dhe rishfaqja e saj është edhe kod poetik, edhe kënaqësi estetike, edhe pjesëmarrje e njëkohshme e heroit lirik në marrjen e energjisë poetike.

Si poetët e mëdhenj, Shefki Karadaku ka qytetin e tij magjik. Magjia e këtij qyteti është vazhdimisht kërkuese dhe në zhvillim duke paraqitur evolucion artistik.

Jo rrallë ndjesia njerëzore kalon në një dimension të lartë përqëndrimi si psh në rastin: “Kob i kumrive”. Ai e quan shpesh “kob i kumrive….”

Ka një lloj trishtimi të natyrshëm, që buron nga fakti se

poeti është zbulues dhe kërkon gjithnjë evolucion.

Poezia e këtij libri hapet në mënyra të ndryshme para lexuesit. Fiton dimensione që autori i quan kozmike, përmes fjalëve a shprehjeve: tokësore, rrugë të kaltra, qyteti me njëmijë bebe, etj. Kjo e afron këtë poezi me natyrën e poezisë filozofike dhe ndërkohë shtjellon format e të menduarit me përfytyrim të gjerë.

Pothuajse i gjithë vëllimi i ka poezitë pa titull, duke krijuar nga ana kompozicionale një poemë në vargje, me tipar fragmentarizmin. Nuk ka rëndësi kur nis dhe lexon poezinë pasi edhe në mes të saj, ti krejt papritur do të marrësh qartazi një mesazh apo një ndjesi të caktuar edhe pse nuk ke lexuar një pjesë të mëparshme.

Ndërkohë mund ta lësh në çdo moment leximin dhe duket sikur gjithçka mbaron aty, apo anasjelltas, sikur historia poetike vazhdon…

Nocioni i përsëritjes poetike ndihmohet shpesh nga kjo natyrë strukturore e vargjeve. Po flasim këtu për rimarrjet e koncepteve, emrave dhe ndjesive.

Shumë poezi poeti i lë pa titull, duke nënkuptuar vazhdimësinë dhe në të njëjtën kohë pavarësinë e tyre. Por poeti kur flitet për ndjenjë tepër të fuqishme në mënyrë të qëllimshme vendos emrin sikundër ndodh me poezinë dedikuese. Shembull i kësaj është sidomos poezia kushtuar nënës së tij Adilesë, por edhe pak të tjera si ajo. Një nga poezitë më të bukura është ajo kushtuar çames Nadire, e cila është një Tanushë në miniaturë pa kufij.

Ritmi në poezitë e këtij libri lëviz për shkak të përdorimit të natyrave të ndryshme strofore. Në "Toraks" hasim pa ndonjë rregull të caktuar poezi dyshe, treshe, pesëvargëshe apo monokolonë. Ka edhe të përziera, etj. Për këtë shkak ato

kanë edhe veçori të ndryshme. Poezitë dyshe janë më konçize, ato treshe ndërtohen me pak subjekt, ndërsa të tjerat kanë dimension kohor dhe vendor.

Nëse do të doje ta klasifikoje pak ndryshe poezinë e Shefki Karadakut, pa ngurim do të thoshe se është një poezi qytetase, ku lëvizin si në një film taksi, shoferë, kumri, ku mushmollat, hurmat e oborreve të vogla japin ngjyrat.

Ky peizash herë pas here thyhet nga periferia me: lumin, fushat, lejlekët, karrot, drithin etj…

Dhe po njësoj si piktura, kjo poezi sundohet nga vjeshta. Autori ka pikturuar në vargje vjeshtën dhe duket sikur kjo është dhe stina e tij shpirtërore.

Duke ecur nëpër poemë do ndeshësh emra konkretë poetësh të mëdhenj që duken dhe pranë natyrës poetike të Shefkiut siç ndodh me Elyar… Poezia e tij ka koordinata si e poetëve të mëdhenj. Ndonjëherë është edhe pak Nerudë.

Këto janë edhe udhërrëfyes për lexuesin. Portë informative dhe emocionale gjithashtu.

Shpesh ai përmend emra dhe vende mjaft të njohura, i jep përmasë vendlindjes… ndjesive për të.

Motivet dhe temat zënë një vend në dukje dytësor por që të mbeten në mendje. Temat janë: Mëmëdheu, qyteti, liria, shpendët simbolikë, referimet e ndryshme të personazheve, vende që kanë një histori të caktuar, etj.

Në formë më të shkurtuar do të rendisja disa karakteristika të tjera të poezisë së Shefki Karadakut në vëllim e tij "Toraks".

Megjithëse poezi pa rimë, lexohet lehtësisht falë imazheve të thjeshta që ndjekin njëra –tjetrën.

Disa poezi herë pas herë janë si këngëza të vogla gazmore jo nga motivet, por nga gazmimi që përcjellin. Sikur luajnë fushave, fshatrave etj, sikundër është poezia ne faqen 40 te

libri "Toraks" ku kemi një peizash fshati lëvizës.

Më lart thamë se është krejt i veçantë në përshkrimin e qytetit. Njerëzit vijnë përmes përshkrimit qytetas. Njerëz të butë dhe hurma si frut me ngjyrë toke. Si vjeshta, si trishtimi. Poezia ka mesnatë të zhurmshme dhe ditë të qetë. Nata e poetit është e mundimshme, ndërsa dita sjell jetën reale. Shpesh femra është një vajzë e largët që përthyhet nën këtë qytet.

Ka një distancë të poetit nga heroi këngëtar i poezisë së tij.

Elbasani me rrapin, fushat, këngët, kumritë, dasmat, Shkumbinin, ullishtat, birraritë, vallen karakteristike të malenakes, lejlekët, mushmollat, gjineshtrat e lumit, shelgjet, etj, është një qytet që duket sikur ka gjithçka.

Një pjesë e poezive janë pakëz filozofike me një varg të gjatë kryesisht. Jeta, vdekja, ëndrra, rendja qetësia, koha, garojnë bashkë. Pasi filozofon kthehet sërish në pakëz lirikë, ku lejlekët zëvendësojnë kumritë.

Kemi shpesh edhe ndërthurje motivesh.

Përzierje motivesh si te poezia "*kitara ime"*…ku kitara, ylli, kali, hëna, sjellin muzikë në poezi;

Kitarën time të përbotshme,
E vodhi hëna nëpër fushë,,
Mbi jele ylli i mëngjesit,
Mbi jele kali e përhumbi,
Kitara ime ska më tela,
Akord tragjik i ikjes sime…

Autori është në kërkim të një dite më të mirë… I palodhur nga pritja, nga zgjimi njësoj, nga pagjumësia natën ai shpreson. Poezia ka riciklim motivesh edhe brenda një libri.. por duken si stinë të ndryshme. Poemthat janë plot figura

letrare; krahasime, metafora, pasthirma, epitete.

Ka edhe disa këngëza shpirti. Poeti këndon mallin, rininë, hapësirën, mbrëmjet.

E dashura e poetit është larg…. Ajo vjen pranë vetëm kur ngopet me ëndrrën qytetase.

Poezia kushtuar Adilesë, nënës, është nga më të bukurat, lulet dhe gojëdhënat lidhen me të.

Nëna është kaq e thjeshtë dhe kaq e lartësuar. Është borë që shkrin dhe ndërkohë bie mbi çdo mendim.

Temat e zakonshme si vjersha "Në revistën 'Ylli" ndërthuren me pak lirikë.

Nostaligjia gjëmon kudo…

Dhe po të vazhdosh të lexosh, të shfaqet një poezi tradite në varg e motiv. Diku diku shfaqen menjëherë figura fanstastike si:

"Kali i bardhë e hëngri mbrëmjen… metaforë.

Ndonjëherë ka disa tema të largëta… koha e luftës, por që vijnë përmes një lirizmi, ku dominon një figurë femre me portret gërsheti, ëndërrimtare e virgjër me portokajtë etj.

Bota, qyteti, lagja, shtëpia, femra, ndjenja, formojnë një enumeracion herë ngjitës e herë zbritës.

Duket sikur poeti, heroi qëndron në një kënd të qytetit dhe rrëfen çdo detaj të tij, plus përjetimet.

Bashkë me poetin shëtisin nëpër qytet Lorka me Elyar.

Po bashkë me poetin shëtisin nëpër qytet edhe heroi dhe lexuesi i kësaj poezie.

Elbasani ka një Orfe.

SI E NJOHA POETIN E SHKRIMTARIN ELBASANAS SHEFKI KARADAKU

Hysen Kosovrasti

Njohja me shkrimtarin Shefki Karadaku qe e rastësishme. Takohemi në Tiranë, ku unë kisha shkuar nga Dibra e Madhe te miku im Edip Daçi, i ardhur këtu rishtas nga Peshkopia. Duke shëtitur nëpër bulevardin e Tiranës, kryeqytetin e të gjitha trojeve shqiptare, Edipi më sugjeroi që të pimë nga një kafe me shkrimtarin Shefki Karadaku. E pranova me kënaqësi, sepse ai shpeshherë më kishte folur për të. Për pak kohë, pasi e lajmëroi Edipi, u paraqit një burrë flokëkaçurela në Sheshin "Skënderbe". Ne e sodisnim, nga tavolina para lokalit "Opera". Edipi ia bën me shenjë... Ai u ngjit shkallëve dhe para se të ulet u prezantova dhe u përqafuam shqiptarçe, dibrançe. Pasi këmbyem disa fjalë ai nxjerr nga çanta ca libra të tij dhe mi dhurron. I mora me kënaqësi. Biseda u zhvillua miqësisht sikur të ishim njoftuar vite më parë. Duke pirë kafenë i propozova që ai do të jëtë i ftuar nga Art Klub i Dibrës në lexim letrar. E pranoi pa hamendje. Erdhi disa herë, si i ftuar special. U njoh me shumë poetë nga

të gjitha trojet shqiptare, Tirana, Burreli, Peshkopia, Dibra, Kosova..., sidomos me kryetarin e klubit, Nebi Samarxhiu. Ata, disa që i njihte, e respektuan pa masë, sepse Shefki Karadaku është ndër intelektualët e rrallë që mori mbi supe përgjegjësi të rënda, në veçanti, ai, punoi me shumë dinjitet në fushën e krijimit letrar si në prozë ashtu edhe në poezi.

Shefki Karadaku ka qenë i përkushtuar në punën e tij si njeri krijues që të bënte për vete, jo vetëm me veprat e shumta që i ka dhënë letërsisë, por edhe kur kuvendonte. Edhe pse nuk fliste shumë, por kur fliste, fliste i qetë, ngadalë dhe me takt. Kjo e bënte tërheqës dhe ta dëgjoje me vëmendje, sepse shprehjet e tij ishin filozofike dhe të kuptueshme për të gjithë shtresat e lexuesve.

Të shumtë janë kritikët, nga më të mirët që kanë shkruar për krijimtarinë e disa veprave të tij. Ndër ta edhe Dr.Lutfi Turkeshi, Dr. i gazetarisë, studiues nga Dibra e

Madhe, tani i ndjerë. Dr.Turkeshit kur ishte kryetar i Klubit Letrar të Dibrës i pata dhënë dy libra nga ata që m'i dhuroi Karadaku. Ai bëri një shkrim me shumë përmbajtje e stil të kulluar, për gazetën "Fakti" në mars të 2001, që botohej atëherë në Shkup. Dr.Turkeshi, si studiues është i qindra e qindra shkrimeve si recenzent. Për Shefkiun shkrimin e titulloi: "Karadaku, Khajami i ditëve tona…" Shkrimi u vlerësua nga shumë kritikë letrarë si punim shkencor. Në takimin e fundit ishte shumë i gëzuar. Ka bërë takime edhe me kryetarët e Komunës, sepse ata në shenjë respekti i siguronin, në sallë, radhën e parë. Kur lexonte vjershat duartrokitjet ishin frenetike nga e gjithë salla. E, ai nuk nguronte t'i falenderonte për organizimin e këtij takimi dhe mikpritjen e dibranëve. Ditën e fundit, të mbrëmjes letrare të vitit 2019, sikur kishte një parandjenjë se nuk do të vijë më në Dibër. Kishte dëshirë t'i vizitonte lagjet, qytetin nga kodra e malit Deshat dhe Kalanë e Sfetigradit, Kalanë e Skënderbeut. Këtë dëshirë na e plotësoi Ilir Kosovrasti. Shefkiu këtë e quajti "qershia mbi torte". Unë i jam mirënjohës se në dy libra, të financuara nga Ministria e Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut , e kam pasur si recenzent poetin dhe shkrimtarin Shefki Kardaku.

Familjarëve, shokëve dhe miqve iu lumtë për respektin që i bënë në përvjetorin e 81-të të lindjes dhe një vjetorin e ndarjes nga jeta, sepse personaliteti i shkrimtarit në fjalë e meriton jo vetëm nga ju por nga të gjithë që e njohën. Ndër ta edhe të Dibrës së Madhe.

Shfrytëzoj rastin të përgëzoj zonjën Nadire (bashkëshorten e tij të nderuar), bashkë me familjen dhe shkrimtarin e shumë veprave dhe shkrimeve nëpër gazeta me vlerë, Halil Rama, për realizimin e një dokumentari që i kushtohet jetës dhe veprës të të madhit krijues të gjinive letrare.

Shefkiu i ndjerë ishte një krijues me peshë, si në poezi ashtu edhe në prozë. Me ndarjen e tij nga jeta, edhe Art Klub "Dibra" humbi një anëtar të devotshëm, sepse ai sa herë që vizitonte Dibrën, i jepte një lëng të shijshëm…



SI E KUJTOJ VËLLAIN TIM SHEFKIUN

Natasha Karadaku

Të shkruash kujtime për Shefkiun duhen faqe e faqe të shumta, sepse e gjithë jeta jonë ka qenë me kujtime të bukura, të mbushura me surpriza, dashuri për prindërit, respekt për njëri-tjetrin.

Shefkiu ishte fëmija i parë nga martesa e Adiles me Z.Xhaferr Karadaku. Nga kjo martesë lindën edhe dy fëmijë të tjerë: Astriti dhe unë Natasha.

Lindëm dhe u rritëm në një shtëpi karakteristike elbasanase, me dashuri e përkujdesje të madhe.

Nëna ime Adileja kujtonte se Shefkiu ishte një fëmijë i veçantë. Fëmijërinë e tij e kaloi mes dashurisë për natyrën, zogjtë, lulet e pemët. Rrinte me orë të tëra jashtë me bashkëmoshatarët e tij të Lagjes Spahikorre, me të cilët kishte marrëdhënie të veçanta. Ai shquhej për shpirtin e tij altruist, të dashurisë e respektit për shokët e më gjerë. Kjo dashuri iu rrit dita – ditës nga udhëtimet e tij bashkë me prindërit në vendet ku babai ynë shkonte si mësues.

Tregonte një rast nëna nga udhëtimi në fshatin Xhyrë të Librazhdit, ku Shefkiu ishte mahnitur me natyrën shkëmbore të fshatit, duke e krahasuar me minaretë e xhamive. Imagjinata e tij nuk njihte kufi. Qëndronte me orë të tëra duke soditur ketrat, zogjtë, mëllenjat që gëlonin në kopshtin pranë shtëpisë sonë. Mbaj mend që ai kalonte pushimet verore në natyrë, në ullishte e në lumin Shkumbin. Më është fiksuar në kujtesë kur ai sodiste një tufë pëllumbash me gëzim e dashuri për orë të tëra. Në një rast,-tregonte nëna, ai mbajti e mjekoi një kumuri të vogël, të cilën e lëshoi sapo ajo u shërua. Ai u rrit në një mjedis të bukur natyror me pemë, kafshë, zogj, kumuri, ketra, mëllenja e pëllumba, e të gjitha këto ndikuan në formimin e Shefkiut të vogël.

Në shtëpinë tonë të vjetër karakteristike babai ynë kishte shumë libra në një dhomë të saj. Pikërisht në atë dhomë (odë e quanim), Shefkiu në adoloshencë mbyllej aty me orë të tëra në morinë e librave, që pasi i kishte lexuar shkruante poezi, duke mbushur fletët e fletoreve. Shtëpia e natyra ishin muza e Shefkiut. Aty u zhvillua talenti i tij, sepse ai ishte talent i lindur.

Ç'farë të thuash më parë për Shefkiun? Për dashurinë e madhe që kishte për nënën e babain, për vëllain e motrën?! Ishte njeri i rrallë, fisnik, i ndjeshëm, zemërmirë, altruist në kuptimin e vërtetë të fjalës. E duke u rritur në këtë mjedis të ngrohtë familjar, mes njerëzve e natyrës nuk kishte si të bëhej ndryshe, veçse një talent i rrallë, se ai i tillë kishte lindur.

* * *

Viti 1975. Isha emëruar mësuese në një fshat pranë qytetit tim të lindjes, Elbasanit. Dita e parë e fillimit të vitit mësimor. Në mes të kësaj atmosfere festive mu shfaq në oborrin e shkollës vëllai im , Shefkiu. M'u duk e pabesueshme, zemra ime sa nuk doli prej vendit. Ai, vëllai im, shpirti im kishte udhëtuar kilometra të tërë rruge me makinë e në këmbë për të më uruar për fillimin e vitit të ri mësimor.

Nuk do t'i harroj sa të kem jetën sytë e tij jeshilë, të qeshur e plot dritë e sidomos fjalët e tij plot ngohtësi në një ditë të tillë të veçantë. Ai ka pasur përkujdesje të rrallë ndaj meje si motër që kur kam qenë fëmijë. S'do ta harroj kurrë lasdimin si motër e vetme me dy vëllëzër.

Dashuri e respekt të madh shfaqte Shefkiu edhe për dajë Samiun e dajë Kamer Karadakun. Nga takimet me ta ruante

kujtime e mbresa që e shoqëruan gjatë gjithë jetës.

Në kujtimet e mia vend të veçantë zënë festimet e Ditës së Verës që ishin aq të gëzueshme në familjen tonë, si në të gjitha familjet elbasanase. Në asnjë rast Shefkiu nuk mungoi për ta festuar këtë ditë me nënën e babain që i donte e i respektonte aq shumë. Sëbashku me bashkëshorten e tij, Nadon nuk munguan për asnjë vit, duke na shtuar gëzimin e harenë e kësaj feste tradicionale. Kujtoj me nostalgji përgatitjen e gjelit të detit e të ballokumeve, ëmbëlsirës karakteristike të Ditës së Verës, festimet me sofrën plot të shoqëruara me këngët e bukura të Isuf Myzyrit që babai im i këndonte aq bukur, i shoqëruar edhe nga Nadoja, zëri melodioz i së cilës kumbonte aq këndshëm.

Vizitat e Shefkiut me familjen e fëmijët ishin të zakonshme; ato shndrroheshin në ditë feste ku gëzimi familjar ishte i pafund. I tillë ishte Shefkiu, vëllai im i mirë që asnjëhëre nuk e harroi vendlindjen, shtëpinë e tij karakteristike elbasanase në Lagjen Spahikorre.

* * *

Gëzim i papërshkruar, jo vetëm për Shefkiun, por për të gjithë familjen tonë ka qenë botimi i librit të tij të parë. E festuam me madhështi e kështu do të vijonim të festonim e gëzonim edhe për botimet tjera, ku me talentin e tij të rrallë Shefkiu po afirmohej si një nga shkrimtarët më të kërkuar e të preferuar nga lexuesi. Ai vazhdoi të shkruajë e botojë vepra dinjitoze në poezi e prozë që e mbushnin me gëzim e krenari familjen tonë.

Këtë krenari e shfaqnin veçanërisht dy prindërit tanë të mrekullueshëm. Kjo edhe për faktin se ishte rast i rrallë që dy vëllezër nga e njejta familje u bënë gazetarë e shkrimtarë të

mirënjohur.

Ditë e veçantë për Shefkiun dhe për gjithë familjen tonë ka qenë 11 Marsi 1973 kur Shefkiu u martua me Nadon. Gëzimi i madh e shpërfilli atë ditë të ftohtë pragpranvere. Nadoja me fustan të bardhë e kurorë shkëlqente, por shkëlqimi më i ndritshëm ishte vetë Ajo që rrezëllente e tëra me nurin e bukurinë e saj të rrallë. Komshinjtë e admironin me dashuri dhe e krahasonin atë me një lule me bukuri të pashoqe. Të gjithë ishim të lumtur, por më e lumtur ishte nëna jonë që sa s'fluturonte nga gëzimi. Mbi të gjitha kujtoj lumturinë e Shefkiut që e shprehte në gjithë pamjen e tij. Dhe kishte të drejtë. Sëbashku ndërtuan një familje të lumtur e solide dhe sollën në jetë, mirërritën dhe edukuan dy fëmijë të mrekullueshëm.

Kujtime të paharruara janë ato ditë kur lindi Doriani. Mbaj mend se nëna, babai, Shefkiu e të gjithë ne sëbashku e gdhimë mes gëzimit e haresë. Babai luante në veglën muzikore violinë. Kishte vite pa i rënë, por atë natë tingujt e violinës u dëgjuan gjatë. Ishte gëzim i pafund për lindjen e Dorianit. Shefkiu ndjehej i lumtur e i plotësuar për jetën e tij familjare të mrekullueshme.

Kështu ndodhi edhe me lindjen e Albanës, e cila solli gëzim të paparë në familjen tonë. Të dy, Doriani dhe Albana ua shpërblyen prindërve me arritjet në shkollimin e formimin e tyre profesional dhe me familjet që kanë krijuar.

Gjithsesi, çast i paharruar për të ka qenë kur Albana u largua për në Itali. Ato ditë do më thoshte: "Ka ikur shpirti im, më duket sikur nuk marr dot frymë…Për mua jetojnë Nadoja, Albana, Dorjani…!".

Ai e adhuronte familjen e tij. Nadoja ishte mbështetja e tij më e madhe. Ndaj dhe shpesh përsëriste se Nadoja është

oazi i qetësisë e lumturisë së tij. Gjatë gjithë jetës ajo i dha suportin më të madh. Qe frymëzimi në krijimtarinë e tij letrare, redaktorja dhe kritikja, por edhe mbështetësja kryesore e botimit të librave, veçanërisht pas ‘’90-tës.

* * *

Kujtoj një rast tjetër të vitit të trazuar 1997. Ditë maji, data 8. Shefkiu i qeshur e i hareshëm u shfaq në oborrin e shtëpisë sonë në Elbasan për të festuar ditëlindjen e mbesës së tij të vogël, Adelës që e donte aq shumë. Mu duk e pabesueshme, si ëndërr, e Ai me qetësinë që e karakterizonte tha: Nuk mund të mungoja në këtë ditë të shënuar të mbesës sime. Dhe nuk mungoi në asnjë ditëlindje të saj, sa qe gjallë. Ai ishte gjithnjë pranë nesh në gëzime e sa herë të kishim nevojë për të. Një dajë i mrekullueshëm, i dashur si Ai janë të rrallë. Gjithnjë vinte me dhurata të bukura e të çmuara, me kukulla, arushë e çfarë t’i donte zemra e tij e madhe.

Kujtime që s’mund të harrohen: vizitat e tij të shpeshta në Elbasan, kur vëllai ynë Astriti ishte sëmurë. Ai vinte bashkë me Nadon, bashkëudhëtaren e tij të pandarë për t’iu gjendur pranë e për t’i shprehur dashuri të jashtëzakonshme vëllait.

Fati më solli në Tiranë për vazhdimin e universitetit nga vajza ime Adela. Tashmë ne takoheshim më shpesh. Kujtoj me nostalgji ato kohë kur rrinim me orë të tëra duke biseduar e Ai që e ndizte bisedën ishte Shefkiu. Kujtonte me detaje momente nga fëmijëria, jeta në Elbasan, me prindërit etj. Kujtonte me shumë mall nënën tonë, Adilen, duke e cilësuar grua të fortë, të mençur e fisnike. Kishte kujtesë fenomenale dhe si një enciklopedi e vërtëte dhe një erudit i rallë i kalonte kufijtë e reales.

Shefkiu kujtonte shpesh kohën e kaluar me vëllain e tij

Astritin. Kujtime të bukura si vëllezer dhe si gazetarë. Shefkiu ishte i lumtur dhe atë e shfaqte hapur. Mbaj mend kur në fillim marsin e 2021 e mori në telefon nga Italia, nipi i tij, Iliri. Sytë i qeshën dhe mbasi mbaroi telefonatën më tha: Djemtë e Astritit, Ardiani e Iliri janë të mrekullueshëm; I dua fort dhe ju uroj më të mirat familjeve të tyre.

Në një rast tjetër më tregon kujtimet me nënën e Nados, Feruzen. E vlerësonte si një grua të rrallë, fisnike e shumë mikpritëse. Kujtonte me nostalgji kur çonte Albanën e Dorin tek ajo. "Kur arrinim gjenim ngrohtësi, stufa me dru bubullonte. Ajo dhe nusja e saj e mrekullueshme, Myrvetja na prisnin e përcillnin me dashuri, ngrohtësi dhe respekt", - tregonte Shefkiu.

Fjalë të bukura dhe për Rukon, motrën e Nados, gruan e rrallë, të mençur e fjalëpak, noteren e shquar. Kujtime të bukura që ai i tregonte me dashuri, sepse ajo ishte një lidhje e gjallë me familjen e gruas së tij.

Kurrë s'e harroi shtëpinë e tij të lindjes në Elbasan që ka qenë muza e tij e përherëshme. Gjithnjë më porosiste: Natasha, bëju të fala të gjithë komshinjve e shokëve që i donte dhe e donin aq shumë. Kishte mall dhe nostalgji për shtëpinë ku u lind, ku u përkund, ku dëgjoi ninullat e para e ku e hodhi hapat e parë. Më thoshte shpesh: puthe shtëpinë në çdo cep të saj. Këtë e përsëriste çdo herë deri në mes të marist 2021. Dhe unë do vazhdoj ta puth atë shtëpi deri sa të kem frymë sepse është amanet i Shefkiut dhe amanetin s'e tret dheu.

Atë s'e kemi më fizikisht mes nesh, por e kemi shpirtërisht, kemi kujtimet e paharruara e mbi të gjitha veprën e tij letrare që e veshi me pavdekësi.

FISNIK NË SHPIRT, NË ART I FISËM

JOSIF DOJA

Kumti i zi që një ditë mora
Josif, Shefkiu ynë na la,
M'i dridhi trup e shpirt saora
Se ish i helmët sa më s'ka.

I thashë zemrës së tij ndër vete,
Ashtu në pikëllim të rëndë:
Po pse, po pse buzët ia qepe
Kur kish ndër to akoma këngë.

Si ndjeu mirë zemra ç'i thosh
I pikëlluar shpirti im,
-Në jetë ta mbaja bëra çmos
M'u gjegj ajo, -poetin tim.

Paçka se unë s'do të rrah më
Se s'ka zemër që përjetë rreh,
Do rrojë poeti përgjithnjë,
Arti i tij që mortje s'njeh.

Fisnik në shpirt, në art i fisëm,
Virtytesh mbrujtur, gjithë ç'janë,
I Elbasanit tonë të shndritshëm,
Frymë, puls e nerv - gjithë Elbasan.

E deshi fort ai Shkumbinin
Se lindur kish brigjesh të tij,
Të tijat valë tek shushurinin
Në këngë i shndërroi, në poezi.

Me këngët e Isuf Myzyrit
Pat zënë ai të hidhte shtat,
Aty i mbante, ngrohtë, pranë gjirit,
Të tijat këngë, të ëmbla mjaltë.

Gjuha e Kristoforidhit,
Kjo shqipja jonë, se ç'mrekulli,
E kthjellët porsi dritë e syrit,
Shefkiut i pat bërë magji.

Se ish magji e shënjtëruar,
Hyjnor ish dhe i saj shkëlqim,
Me të një jetë i dashuruar
Ky Shefki Karadaku ynë.

* * *

Poet s'u bë veç falë dëshirës
Se që në djep poet pat qenë
Qëkur duart e nënë Adiles
E tundnin butë siç bën çdo nënë.

Fisnik në shpirt, në art i fisëm,
Virtytesh mbrujtur, gjithë ç'janë,
I Elbasanit tonë të shndritshëm,
Frymë, puls e nerv, - gjithë Elbasan.

14 Mars 2022

III

PJESË TË ZGJEDHURA NGA KRIJIMTARIA E SHEFKI KARADAKUT



KARIBDA

Ajo ishte gryka më e thellë që kisha hasur ndonjëherë. Grykë të tillë mund të takosh njëherë në njëqind vjet. Unë rashë në të, pasi kalova një qafë fare të vogël gurësh e shqopash të blerta dhe në fillim nuk ma mori mendja se pas saj do të vinte kjo grykë e thellë, që i ngjante kanioneve polare. E mora krejt si një dalje të zakonshme, prandaj eca plot besim nëpër fillimin e saj, pa më vajtur ndër mend se shumë shpejt do të humbisja orientimin nëpër atë mori gurësh, shpellash e bimësh, që sa vinin bëheshin gjithmonë e më tepër jo mikpritëse. Pas një çerek ore e kuptova se po zbrisja në tym. Ajo grykë vinte e ngushtë në fillim, pastaj zgjerohej gradualisht duke gjarpëruar në një formë tepër të ndërlikuar, kthesë pas kthese, por pa e marrë vesh, se nga ç'anë kisha zbritur. Aty nga mbrëmja e kuptova, se kisha bërë veçse një rreth të madh, që nuk kishte as dalje, as hyrje. I lodhur, i uritur, me këmbët që më dhembnin në shputa, u shtrëngova më në fund të zë vend në një guvë të vogël dolomitësh ku era e ftohtë të hante më pak. Guva qe disi e ngushtë dhe mua m'u desh të përthyhesha pak për të gjetur një pozicion të rehatshëm. Nuk ndeza as zjarr, për arsyen e thjeshtë se shkrepëset i kisha harruar në xhepin e xhakoventës. Për një moment më lindi mendimi të ndizja zjarr duke fërkuar dy drurë, por më mungonte durimi dhe këmbëngulja e njeriut primitiv. Qesha me vete dhe nuk e di përse mendova se e gjithë kjo qe një situatë vërtetë absurde, një moment fatal, kur njeriu bën diçka që mund t'i kushtojë më vonë sa qimet e kokës, por që asnjëherë nuk e parashikon

se kur vjen e sa do të zgjasë.

Qe një natë e errët, sipër së cilës qëndronin si llampadarë të prishur yjet përshkënditës. Kisha uri. Nuk kisha vënë gjë në gojë qysh dje në mëngjes, kur u largova nga kantieri, pa e marrë me mend se nuk do të kthehesha më që nga ai çast fatal. Meteorët e rrallë, që binin më jepnin përshtypjen se nuk isha më në tokë, por diku, në hënë ose në mars, brenda një fushe, rrotull së cilës qenë fshirë njëherë e mirë kufijtë e jetës dhe të vdekjes, dhe se gjithë këtë lojë tragjikomike njerëzore, e drejtonin pa dashje disa forca të egra, që respektonin vetëm rendin e gurëve dhe të shkëmbinjve kozmikë.

2.

Mëngjesi lindi i plogët, i verdhë, i lodhur. Pashë me një shpresë të rilindur pas asaj nate që kaloi me zor, dhëmbët më të uritur se unë të gurëve, që rrethonin anembanë, si ushtarë prehistorikë, luginën e thellë, që ndoshta nuk ishte shënuar në asnjë hartë të botës. Duhej të qe një nga ato luginat e pavëna re, që as unë, as Sheremeti nuk i kishim hedhur në hartën topografike të rrethit M. ose e kishim kaluar si një gjë, që nuk ngrinte shumë peshë në gjeologji. Tani ajo po ma merrte hakun dhe kishte pothuajse një gjysmë dite dhe një natë, që nuk pushonte së më lodhuri, së më demoralizuari. Qëllimin e saj të fshehtë unë e nënkuptoja fare mirë. Me siguri ngulmonte të më jepte të kuptoja se kurthet e natyrës nuk mund të merren me aq mospërfillje sa ç'i merrja unë dhe se gjithmonë në to egziston mundësia që njeriu t'i humbë për një moment të gjitha ato që ka fituar me zor në këto dymijë vjet qytetërimi të pandërprerë, me një lëvizje të pakalkuluar mirë, të bërë nga besimi i tepruar, ose nga mendimi se ai e kishte arritur më në fund fitoren mbi të gjitha ato që ka përreth dhe te të cilët ai

sheh në mos aleatë, disa vëzhgues indiferentë, që nuk e kanë zgjuarsinë e tij, prandaj nuk mund t'i prishin asnjëherë punë.

Elementi i vetëm që më lidhte hëpërhë me njerëzit qe era: nëpër të mund të çoja ose të merrja teletajpe po të mundja, por unë akoma nuk e zotëroja siç duhej kodin e lashtë të erërave, prandaj më mbetej vetëm të prisja ose të vëzhgoja lojën e saj të hollë me gjethet e brishta të kaçubave në buzë të guvës me dolomitë. Po të kisha pasur një daulle, mund të kisha dhënë ndoshta deri në kantier sinjale me shkop, por me sa vura re, era ndërroi menjëherë drejtim dhe tani frynte jo më nga juglindja, por nga veriperëndimi, kështu që, edhe po të kisha pasur tambura, sinjalet e saj era do t'i çonte nja dhjetë kilometra larg.

Era, sikur ta ndiente se dikush po mendonte për të, u fut në grykën e boshatisur nga të gjithë qëniet e gjalla dhe fërshëlleu me bilbilin e vet homerik. Mërdhiva dhe u shtrëngova dhe më tepër me xhupin e hollë të pambuktë, duke menduar jo më për urinë, po për këmbën që po më dhembte nga kyçi e lart. E kisha përplasur mbrëmë tek tentova të provoja të çaja luginën, në një gur shtufi, pak më larg se hyrja ku rrija. Nuk i dhashë rëndësi dhe e mora thjesht si një përplasje të vockël, por ajo nuk kishte qenë aspak e tillë. Rënkova nga dhimbja, kur tentova të ngrihesha në këmbë. Rashë përsëri në atë shtrojë të fortë dhe gjëja e parë që më ra ndër mend në atë çast fatal qe mundësia se unë mund të vdisja tanimë ose nga uria, ngaqë nuk mund të bëja asnjë hap më tej, ose ngaqë nuk mund të më gjenin më, ashtu siç isha futur në atë luginë qorre, ku dhe korbat vinin rrotull e rrotull dhe nuk guxonin të zbrisnin në ndonjë gur të saj. M'u kujtua historia e një njeriu, që vdiq në një luginë polare. Zgjata kokën dhe u mundova t'i largoj mendimet për vdekjen, duke kërkuar me sy ndonjë

dalje nga ai pus gurësh dhe dolomitësh statikë. Përballë meje qëndronin, as dyzet-pesëdhjetë metra më tej, një varg granitesh piramidalë, gati të bardhë, kokat e të cilëve shponin me rreptësi kupolën e ngjyer me gri të qiellit të madh. Pak më anash, vinte shpati i thiktë i një mali me shkurre dushku, tek i cili mund të ngjitesha po të kisha me vete litarë dhe këpucë alpinisti. Vetëm në veri ravijëzohej shtrati gati i padukshëm i një lugine, ndoshta vazhdimi i luginës ku kisha rënë, por edhe pas saj vinin majat e bardha të disa maleve të tjerë.

E pashë që fati më kishte ngritur një kurth të ri, por tanimë jo nga njerëzit, por nga natyra. Nuk e prisja një kurth të tillë, të paktën ato ditë, që do të zbrisja në qytet për të pirë me shokët. I nënshtruar para këtyre grackave, që po më ngjanin për keq, kontrollova xhepat, ku gjeta një cigare, por shpejt u kujtova se nuk kisha me se ta ndizja. Përplasa me furi dorën dhe u lëshova një mallkim shkëmbinjve që më kishin vënë si viktimën në mes e po luanin me mua si macja me miun.

3.

Shpeshherë më ka qëlluar të ankohem për veten e shokët që kam njohur. Kam thënë se disa nga ata janë të poshtër, disa disi më të mirë. Por nuk e kam ndjerë mungesën e tyre dhe të jetës kaq shumë sa në këtë botë indiferente gurësh. E kuptova se kisha bërë me ta një gabim tragjik: kisha qenë tepër egoist me të gjithë. Kisha zbuluar nga vetja vetëm atë pjesë të zemrës, ku kultivohen vetëm gjërat dhe ndjenjat e dyshimta dhe jo atë pjesë që ruan me xhelozi gjënë më të bukur të njeriut: dashurinë.

Natyra që më rrethon sot është e shurdhër, e verbër. Tek ajo, tek era që luan tani fletët e rralla të kaçubave, te dëbora që ka nisur papritur të fletëzojë si një burim pambuku, te gurët

stereotipë, me maja, thepë, gropa, të çara, ekziston vetëm instikti i lashtë i sendeve: indiferenca. Indiferenca nuk mund të zërë kurrë tek asnjëri vendin e dashurisë. E keqja është se unë kam dashur shumë pak, më tepër kam urryer; jam bërë xheloz edhe për gjëra që nuk më takonin, egoist për ata që në lojë me jetën kishin më tepër risk, i keq me atë që mund t'i jepja. Tani të gjitha këto nuk më hyjnë fare në punë, sepse këtu nuk ke kujt t'i ankohesh për ato që kanë ndodhur aq mbrapsht atje poshtë, por ato në njëfarë mënyre më ngushëllojnë dhe më forcojnë besimin se po të dish të dashurosh si duhet, edhe loja e ndjenjave të zeza, nuk do t'i hapë aq telashe njerëzve sa ç'i hap deri tani në përmasa aq vigane.

U shtriva më mirë, për ta pasur më të lehtë për të menduar e kritikuar veten. Për një moment e harrova fare urinë e dhimbjen, por ato tani që nuk po mendoja më për arsyen, dolën përsëri në pah dhe filluan të më torturojnë njëra në stomak e tjetra në këmbë. Qenë nga gjërat më të lashta, që unë kisha trashëguar nga kopetë e mamuthëve dhe ato sot kur po harroja fare se isha njeri si të gjithë dhe se ritmi i zemrës po dobësohej përballë instikteve të egra, që më rizgjonte natyra nga thellësia e shekujve, filluan të gërryejnë me këmbëngulje besimin te logjika dhe intelekti.

Për të mos u dorëzuar para tyre, u zvarrita pak e dola në buzë të guvës. Për një moment e ndjeva veten më mirë dhe ky përmirësim me dy presa më dha kurajë për të menduar dhe njëherë se ç'do të bëja më tej për të dalë nga ai pus i thellë.

4.

Nata është koha e orgjive të vjetra në natyrë. Orgjia filloi me shtimin e erës, që tani më detyroi të tërhiqesha më thellë në shpellën e ngushtë, pasi piva ujë në një pellg aty afër.

Flokëzimi i dëborës qe ndërprerë, por u shtua mjegulla, që m'i shoi edhe ato shpresa të pakta të shpëtimit nga shokët e mi. Ata me siguri më kërkonin në qytetin M. ose në Tiranë, ku u kisha thënë se do të shkoja dhe nuk ua merrte mendja se mund të kisha rënë në këtë kanion hënor. E shtriva këmbën e ftohur pak më drejt dhe e mbështeta kokën në një gur për të dremitur paksa. Por, me sa duket, fjeta pak, sepse u ngrita me tërsëllëm nga uria dhe dridhjet. Pashë orën me fosfor: tetë pa një çerek. O Zot, thashë i dëshpëruar me vete, edhe sa orë të tmerrshme nate më kanë mbetur për të ardhur përsëri mëngjesi, kur dhe ideja se mund të më gjejnë më lehtë, është më e fortë? Për të shpëtuar nga ankthi e frika fillova t'i bindem kujtimeve të largëta, disa qyteteve të vjetër që depërtonin me mundim nëpër kujtesën e lodhur. M'u kujtua dasma e vajzës së tezes. Para syve të mendjes feksi një derë, e hapa atë dhe përpara më doli daja me lugë në dorë. "Shyqyr, - mendova i lehtësuar, - paskam shpëtuar më në fund nga kjo dreq luginë". Ai më ftoi të ulesha. U ula, mora gotën e rakisë në dorën që më dridhej nga emocioni dhe me gjithë shpirt urova çiftin e sapomartuar. E kisha dashur si motër Florën dhe mendimi se ajo tani i përkiste një bote tjetër, më ngacmonte ndjenjat për të dashuruar edhe unë ndonjë vajzë si ajo. Hodha sytë përqark. Pak më tej qeshte një bionde e lezetshme, me sy të mëdhenj e vetulla të çiftëzuara bukur në pjesën më të mirë të ballit të bardhë. "Është Diana", -më pëshpëriti daja në vesh, që e kishte ndjekur me kujdes vështrimin tim, - sapo ka mbaruar fakultetin dhe është emëruar mjeke në qytetin e vogël C." Rakia dhe gëzimi e bënë punën e vet, kërceva me të disa herë, aq sa një shok më pëshpëriti në vesh: "Na ike dhe ti". Qesha me këto fjalë pa të keq, që pas pak ia përsërita edhe Dianës, sa dhe ajo filloi të qeshë si unë. "Kam uri,",-thashë papritur. Ajo

u zbeh dhe më pa me kujdes. “Mos je sëmurë, Mark?” – më pyeti ajo. “Jo, vërtet më hahet shumë.”. “Po ti gjithë këtë kohë ke ngrënë e pirë pa hesap”. “Mos ke problem me stomakun?”- më pyeti pastaj. “Diana, mos ki frikë”, - iu përgjigja dhe, pa mbaruar ajo fjalët mirë, hëngra menjëherë një kofshë pule të pjekur. “O Zot, - tha ajo fytyrëprishur, - do të vdesësh, Mark”.

Papritmas përplasa njërën faqe në gurin që kisha nën kokë. Thirra nga dhimbja dhe u zgjova. E gjithë ajo që pashë kishte qenë vetëm një ëndërr mashtruese.

5.

Dita e re erdhi e ftohtë, e acartë.

U ngrita me stërmundim dhe zura të përshkoj, si në jerm pjesën e zhveshur dhe të akullt para guvës me dolomitë. Rrëshqisja herë pas here në akullin transparent që qe formuar në pellgjet e vegjël të ujit. Shpova me duar një nga ato dhe piva pak ujë. Nuk më shijoi fare. Pashë njëherë me sytë, që po më iknin, konturet si pa jetë të luginës. Një parandjenjë më thoshte se shokët po më kërkonin diku aty afër, pa u shkuar fare nëpër mend se isha pak më tej, sa një e shtënë pushke. Provova të thërras, por më doli një britmë e dobët, sikur zërin të ma kishte vjedhur dikush. Duhet të bëja patjetër diçka për të shpëtuar. Por e ndieja se nuk kisha fuqi të përballoja një marshim tjetër nëpër kanionin e ngrirë. Një zë i brendshëm më thoshte, që të rrija në vend e të prisja. Ata nuk do të vononin shumë, sepse kantieri qe fare pranë asaj gryke të zezë. Pasi të kërkonin në qytetin M. dhe në Tiranë, shokët me siguri do të rikthehesin në këtë grykë, ose në një tjetër, gjersa të më gjenin. Po sa kohë do të kalonte deri atëherë? Gati një natë e një ditë, filloi dita e dytë. Deri në sa ditë do të rezistoj me këmbë të sëmurë dhe uri si ujk? Tre, pesë, shtatë. Kisha dëgjuar njëherë se si

pesë marinarë rusë kishin duruar pa ngrënë dyzet ditë, duke u ushqyer me shollën e këpucëve. Ngrita këpucët dhe qesha. Nuk kishin fare shollë, por gomë poroze dhe me sa di unë, goma nuk hahet kurrë, edhe nëse je duke vdekur nga uria.

Më erdhi një mendim që më tronditi gjer në palcë. Ai ishte rreziku i lodhjes dhe i urisë, i cili tentonte të më zhvishte nga të gjitha ndjenjat që më udhëhiqnin deri tani. Të gjithë e kanë ndjerë se në embrionin e secilit ekziston britma e mamuthëve të lashtë. Sa më tepër që jemi njerëz, aq më e mjegullt duket ajo kohë. Por natyra nuk ka mençuri e dashuri, por këmbëngulje dhe durim. Ajo e ndien se jemi të dobët para saj dhe veç vepra e të gjithëve na bën më të fortë. Prandaj mundohet të na zhveshë nga ndjenjat, të na bëjë indiferentë si bishat. Kundër kësaj indiference mendova të përdorja gjithë arsenalin tim të brendshëm, nëse kisha më të tillë, për të mos u bërë dhe unë një nga elementët e saj, si mamuthi, gurët, shkurret, akulli, uji, urithi, dreri.

Por e kuptova se kjo gjë qe tepër e vështirë, sepse isha fare i vetëm përballë saj. Ose më mirë, isha gjysmë njeriu. Në këtë dualizëm, që po më torturonte për vdekje, nuk kisha me vete asnjë aleat, veç kujtimeve dhe dashurisë. I zgjoja ato edhe nga pjesët më periferike të kujtesës dhe të zemrës dhe i hidhja vazhdimisht në luftë kundër urisë, lodhjes, frikës, vdekjes. Por edhe ato ishin lodhur tanimë së ardhuri nga larg dhe tentonin të vinin gjithmonë rrallë e më rrallë në kanionin e vdekur. Edhe dashuria, që më ndriçonte pak më parë si fener, po venitej orë pas ore, sepse edhe zemra që e ushqente qe lodhur së duruari. Mendoja se sa e vogël dhe e brishtë ishte ajo në këtë luftë vigane, por sa gjatë e me sa dashuri e këmbëngulje na mbante në këmbë. Atë flakë brenda zemrës na e ka ndezur fati i madh. Për ta ushqyer nuk duhet shumë mund, sepse ajo na

e jep pothuajse falas dashurinë, por ne shpeshherë nuk dimë ta përdorim atë ashtu siç duhet, e nënçmojmë, e quajmë gjë të brishtë, që nuk na hyn shumë në punë në përleshjen e ashpër me njëri-tjetrin; përballë dashurisë vëmë urrejtjen, mizorinë.

M'u kujtua se sa kishte qeshur një shoku im kur dëgjoi një djalë, që i thoshte një vajze: "Të dua më shumë se jeta!".

Isha i bindur se ai e donte më fort se jeta, sepse kishte futur në mes të saj dhe vajzës dashurinë, që nuk e kanë as buka, as drita, as kafshët, as kopetë e egra. Këtë privilegj e kam vetëm unë dhe ai. Por sa shpesh dëgjojmë të thonë: *"E theri…", "E vrau…", "E rrahu…", "E zhduku…", "E torturoi…", "E futi në burg…", "E la pa ngrënë…" dhe sa pak dëgjojmë fjalët: "Të dua!", "Të kam në zemër", "Je shpirt njeriu…". Madje shpesh herë qeshim dhe bëjmë buzën në gaz si para një formule bajate ose shakaje pa kripë, që nuk e merr asnjeri seriozisht ta pohojë, sepse ka frikë, se mos i thonë: "shpirt pule". Unë e kam tani fjalën dashuri në buzët e thara nga mungesa e lëngjeve. Por ajo nuk më shpëton nga ideja, se nuk kam për të rezistuar shumë gjatë, sepse ajo e ka vendin vetëm atje, ku fytyra ime është e shpirtëzuar në miliona fytyra të tjera, si unë."*

6.

Kam qenë me Jasonin në Kolkidë dhe kam predikuar paqen; me Gutenbergun, kur shtypa Biblën e parë; me Pikason, kur bëra pëllumbin e paqes" dhe ja dhurova njerëzve për t'u thënë: Ja tek e keni dashurinë, mos u bëni kurrë mamuthë, sepse për t'u bërë mamuthë është fare e lehtë. Kaloni këtë grykë dhe kuptoni, se sa larg është njeriu dhe se sa e vështirë është të pranosh Ajnshtajnin; kur ndjen se tremijë vjetët e Hesiodit janë bërë hi para një dolomiti vigan dhe idesë, se

përsëri ke filluar të lëvizësh pas me shpejtësi skëterre, po nëpër atë trase, ku kaloi Homeri dhe Galileu, por në mënyrë të kundërt, si nëpër një tunel, ku ndjen të gjitha dhimbjet që ka kaluar për të ardhur deri këtu e për të mësuar të nënshtrosh botën me një pendë dhe Kompas dhe jo me dhëmbë e me kthetra; sepse dhëmbët dhe kthetrat gjithmonë kanë shqyer e çarë, por asnjëherë nuk janë ngjitur deri në majën e kullës Eifel, ose deri në Bruklinin madhështor. Botën e ka udhëhequr një zemër e butë, e brishtë dhe vigane, ndoshta më e madhe se Everesti. Nga ajo kanë rrezatuar miliona zemra të vogla, si dritat në një natë të thellë, ndriçimi i tyre ka qenë gjithmonë homerik, nga ato ka mbirë fjala e lashtë "të dua".

Kur dikush ka thënë "të urrej", e ka shembur kullën e Londrës me një shkop të vogël. S'është dashur veçse një sekondë, që të digjet bibla e Gutembergut. Sekonda ka nënshtruar mijëra vjet dhe i ka rënë Arkimedit me kthetra, ka shuar trekëndëshin magjik nga rëra fatale dhe ka grisur me urrejtje portretin e Kopernikut.

7.

Mungesa e dashurisë këtu më bën më fatkeq se kurrë. E ndjej se ajo më ka lënë një boshllëk të pakorrigjueshëm në shpirt. Megjithatë, nuk dua të mësohem me mendimin se mund të jetoj pa të, sepse ajo zë shumë vend në jetën e gjithë njerëzve, ashtu siç zë tek unë. Magjithatë kjo luginë polare, e sulmuar nga dëbora dhe era, e shkretë deri në ngjethje, pa zogj dhe kafshë të egra, më ka kthyer pesëmijë ose gjashtëmijë vjet më pas, në kohën që unë isha mamuth dhe më udhëhiqnin në jetë jo ligjet e dashurisë dhe të arsyes, por instiktet shtazarake, që më detyronin të bulërija dhe të kërkoja ushqim.

Ndryshimi i njeriut në mamuth tek unë u shoqërua me

vuajtje të mëdha. Qime gri e të gjata më mbuluan pothuajse për një orë. Qenë qime të ashpra e të forta kafshësh, që mbinin poshtë rrobave të ngrira si thakë të përmotshëm. E ndjeja se kjo ishte dita e fundit kur unë isha edhe mamuth edhe njeri, kur ende nuk më qe transformuar gjithçka në një trup të pandjeshëm kafshe të egër, por ende jetoja si centaur, herë me kokë mamuthi, herë me kokë njeriu.

Kjo qe periudha më e vështirë, që kisha jetuar ndonjëherë, pas së cilës ndieja zbrazjen e ngadalshme të shpirtit nga dashuria, simpatia, ndjenjat dhe mbushjen e vendit të lënë bosh me mizorinë dhe çmendurinë e kafshës. Në momentin që e kuptova se nuk isha më taman njeri, nga buzët e mia të çara prej mamuthi doli ulërima ngjethëse e një bote të ndarë në dy pjesë armike. Përplasa krifën e madhe prej leshi dhe ngula të katër kthetrat e forta në borë, si të parandjeja se tani e tutje nuk kisha asnjë punë me atë që kisha braktisur pa vetëdije, por me instiktin e lashtë që kërkon prenë e vetë.

Nga buzët e mbuluara me qime të ashpra doli papritur ulërima më ngjethëse në botë, ulërima që shemb Luvrin.

8

Kjo grykë kanioni është ndoshta kufiri i fundit të botës së gjallë dhe të vdekur, kufiri i tejskajshëm i mamuthit dhe në anën tjetër i Erazmit.

Përtej këtij caku me siguri fillojnë hapësirat e shurdhuara nga heshtja. Mbase unë jam eksploruesi i parë i saj. Por kjo nuk ka shumë rëndësi tani për tani, në kohën që po më mbërthen gjumi dhe apatia. E kundroj me neveri veten: dukem një mamuth distrofik. Qimet më kanë zbritur deri në akull. Kam përshtypjen se ato nuk mund t'i presë as sëpata. Jam mamuthi i fundit, që jetoj nga epoka e akullnajave. Fyti im po fiton çdo

çast e më shumë nuancat e lashta të bishës, ndërsa lëkura merr moment pas momenti formën e koracës së breshkës.

Po në qoftë se nuk dua të bëhem taman bishë, është e nevojshme të vrapoj nëpër luginë drejt qafës së njerëzve. Kjo është masa më e efektshme që mund të marr kundër çmendurisë dhe shurdhimit të plotë.

Udha drejt grykës është e lodhshme, tmerrësisht e lodhshme. Para vështrimit tim prej mamuthi luajnë haluçinacione njerëzore të harruara. Vetëm kujtesa dhe logjika nuk më kanë braktisur akoma përfundimisht. Zemra dhe truri i njeriut rezistojnë brenda me tërbim, ato ende ruajnë me fanatizëm hijen e botës që lë pas. Jam akoma si centaurët, me lëkurë e trup mamuthi dhe me kokë njeriu. Kam përshtypjen se do të ndahen nga minuta në minutë në dy qenie të ndryshme, njëra me kokë e tjetra me trup, për të mbetur, gjithsesi, i varrosur në këtë luginë herë si njeri e herë si thundrak. Kthej kokën dhe vë re nëse vjen akoma Moxarti pas meje. Por qenka vetëm krifa e lashtë e neandertalasit.

9.

Sa e llahtarshme është ndarja me njerëzit që dashurojmë! Sa e tmerrshme vdekja, që merr trajtat e kësaj gryke me formë labirinti, vdekja e njeriut vetëm, në zemrën e shkretëtirës së heshtur, që ka hijen e bishës. Është një vdekje që nuk lë fare gjurmë, as në shkëmb, as në tokë, as në ajrin e ngopur me grimca dëbore.

Të paktën të më shoqëronte zëri i Orfeut, ose lëvizja e erës, që sjell nga përtej ngacmimi i botës së Botiçelit, që nuk më përket më. Por edhe era ka pushuar së lëvizuri, si për inat. Nuk do të më sjellë në zvarritjen time prej centauri, paramendimin se diku, atje lart, pas asaj gryke fatale, ekziston

një formë tjetër jete, e përkundërt me këtë ikje gjysmë bishe – gjysmë njeriu. Shkund kokën e rëndë, me qime gri e krifë luani, për të ndarë kufirin e arsyes dhe të instiktit. Përballë meje vjen një bishë tjetër, që ka mbirë nga një epokë plakë; ajo bulërin si unë; ka po ato përmasa vigane, por nuk zotëron si unë kufirin e nevojës dhe të ndjenjës. Ajo ka qëndruar para meje e mbirë si nga një përrallë mistike, e burgosur në instiktet e saj, e magjepsur nga krifa ime e re. Megjithatë, nuk tenton të bëjë asnjë lëvizje afrimi, sepse me sa duket e ndien se tek unë akoma rreh diçka që nuk shkon për të, një trup i huaj, një lëndë e frikshme, e cila ka komanduar dikur topuzët dhe që tani komandon armë të tjera më të llahtarshme se ato që e vranë atë dikur. E inatosur, bie në gjunjë dhe ulërin me zë, që të ngre përpjetë qimet e kokës nga tmerri.

10.

Mbase tani isha vërtet një mamuth i vërtetë. Apatia më kushtoi një milion vjet jetë. Çaja indiferent nëpër pjerrësinë e luginës dhe ende mendoja, megjithëse me një pjesë të trurit të asfiksuar në kafkë, se gjithshka kishte marrë fund një herë e mirë. Qimet e bardha tani po më pushtonin edhe buzët, edhe mjekrën. Megjithatë, pa iu bindur instikteve të lashta të kopesë, çaja me këmbëngulje drejt daljes së kanionit të ngrirë. Më kishte pushtuar dëshira, që të shikoja për herë të fundit atë që kisha lënë mijëra vjet prapa, atëhere kur natyra më urdhëronte të bëja për të mbetur gjallë, trasenë polare nga Arktiku në Alaskë.

A mund t'i rezistonte vallë zemra ime këtij tundimi të lashtë? Por ajo ishte akoma e fortë, e ndieja nën lëkurën e trashë e qimet vigane se ajo rezistonte t'i bindej plotësisht tekave të natyrës, mundohej me të gjitha forcat, si një motor që

jep maksimumin e energjisë së vet, për ta ndaluar këtë rikthim në hije, pulskonte pikat e fundit të gjakut tim të butë, për të ndaluar transformimin e ndjenjave dhe të dashurisë në një vrapim të çmendur drejt kullotave dhe gjumit. Ndieja rrahjet e saj të tmerrshme, regëtimat kryeneçe, brenda kafazit të zi, se si lëshonte në eter mesazhet e fundit të njeriut për t'i lajmëruar njerëzit e tjerë se ajo ishte në kufirin e një bote të ndarë në dy pjesë dhe se kalimi nga njëra te tjetra, përmbys ligjet e vjetra të evolucionit dhe fshin vijën ndarëse të intelektit me goditjen e verbër të bishës.

Eci nëpër dëborë gati i mjerë dhe apatik. Nuk e di nëse do të arrij të vazhdoj akoma atë që kam lënë përgjysmë diku, në botën e arsyes e të dashurisë. Largimi nga njerëzit paska një çmim të keq. Ai nuk i reziston indiferencës dhe këmbënguljes së gjërave, që nuk dinë se si ta shprehin atë që mendojmë ose ndjejmë ne. Ato veprojnë, instikti i shtyn vetëm drejt urisë; midis urisë dhe gjumit ekziston një botë e errët shqisash të vjetra, këmbëngulja e të cilave u fshihet njerëzve, sepse e ndiejnë se tek ata kanë një armik po aq të lashtë sa veten, udha e të cilëve është ndarë diku nëpërmjet një lufte për jetë ose vdekje. E kuptoj se tani tek unë veprojnë njëkohësisht të dy ekstremet e kësaj lufte; qindra mijëra vjet përleshen në trupin tim prej centauri, dëgjohen ulërima të largëta mamuthësh dhe klaviçenbali i Bahut, kërcasin dhëmbët e bizonëve dhe shkëlqejnë anijet kozmike.

Vetëm tani po e kuptoj rëndësinë e asaj që mendoj dhe që dua, tani që nuk e kam më dhe po ma marrin instiktet e verbëra. Tentoj të pohoj se po kthehem pas, fare pa dëshirë, ose më mirë, me njëfarë neverie të lehtë për paaftësinë time dhe për atë që më pret atje si ndëshkim mizor. Por unë nuk e kërkova asnjëherë me ndërgjegje këtë gjë, ajo erdhi pa më

lajmëruar dhe pa më thënë se çfarë fajesh laja për të tjerët ose veten me të. Tani natyra ishte e plotfuqishme dhe po bënte çast pas çasti ndërrimin total. Ecja si mamuth, duke iu bindur asaj. Mund të pohoj ende me arsye se nuk po eci më si më parë me dy këmbë, por me katër gjymtyrë. Tërhiqem për të mos mbetur në kurthin e këtij kanioni të nëmur. Tërhiqem dhe ulërij si mamuthët, megjithëse kam bindjen se dua të dal prapë në grykë, ku kam shpresë të gjej prapë ata që dua. Provoj shanset e fundit të jetës. Kam një udhërrëfyese të fshehtë që e fsheh nga dhëmbët e bishës: DASHURINË. Ajo di se ku më çon, sepse është gjëja më e bukur që kam arritur. Ajo duket sikur fle, por në fakt rri zgjuar, më udhëheq me shkopin e dirigjentit, më largon nga ulërimat e lashta dhe shpreson me këmbëngulje të më kthejë përsëri në Shën Pjetër, për t'u thënë njerëzve se mesazhi i saj nuk mbaron as me Rafaelin, as me Çajkovskin, as me Brakun.

Gryka është ende larg dhe mua më mundon frika nëse do t'ia dal. Apo jo. Ulërima ime tund sistemet diellore dhe guvat e nëndheshme. Trokoj me katër gjymtyrë, me ankthin që të shpëtoj një orë e më parë, pa më mbërthyer përfundimisht dimri i madh i vetmisë së krifave me bar.

(Marrë nga libri me novela "ARKADIA E LARGËT" – Faqe 3-24).

PUTHJA E NGRIRE

- Fragment romani -

XXVI

Zibeli erdhi me vrap të nesërmen në mëngjes, para se të nisej Rroku tek ajo.

Ai po lante sytë, kur Zibeli hyri vetëtimthi në rrethin e lodhur të bebeve të tij. Gati vraponte nëpër atë baltë ngjitëse si mastiç, me çizmet e përveshura mirë deri në pulpat e bukura, e freskët e gjallëruar nga lajmi i papritur që i dha Basriu një ditë më parë.

- Zibel! - thirri Rroku.

- Rrok!

Emrat e tyre, të thënë pothuajse në të njëjtën kohë; tingëlluan pabesueshëm në atë rrafshnaltë internimesh e vuajtjesh. Ajo u hodh në krahët e tij me frymëmarrjen, që e trondiste gati të tërën, e përcëlluar nga ajri e shiu i pabesë, ku ishte ruajtur diçka nga ajo brishtësi e tejdukshme, që Rrokut i kujtohej me mallëngjim. I mbështeti me zjarr buzët e veta tek të sajat, si t'i vendoste në një perusti të nxehtë. Ajo u mbështet e lodhur tek ai, pothuajse e ngjitur për trupi, si të tentonte të bashkonte me të organet nën një element të vetëm të botës, Rroku ndjeu se si po i gurgullonte sërish gjaku, për të cilin kishte pasur mendimin se ishte ftohur ose mbaruar. Nuhaste i dehur aromën e faqeve të saj si të pjeshkës, ku tronditjet, vdekjet, dhimbjet kishin filluar të vizatonin tatuazhet e para

të mizerjes.

Në atë jerm të pabesueshëm shikimesh, trupash, puthjesh ai mundi të vërë re sytë e saj të bukur, të cilët dikur nuk i kishte parë me aq hollësi sa atë ditë; kishin pothuajse bebe të tejdukshme si uji, që mbuloheshin me qepalla të zeza e që bënin kontrast me verdhësinë verbuese të flokëve. I kapi leshrat e saj me dorë, si për të kuptuar sekretin diellor të tyre. Ndjeu në pëllëmbë kërcitjen e tyre të lehtë, përkëdhelëse, që i rrëshqiste si xhelatinë në lëkurën e ashpër, diçka afër kristalit të artë. Ai ishte kristali më magjepsës që i kishte blatuar ndonjëherë njeriu natyrës. I përfshirë nga epshi, ai tentoi ta tërhiqte drejt shtratit.

- Nesër! - i tha ajo ngulmuese, por me nxitim.

- Mirë! - pohoi i bindur Rroku. E dinte se kur thoshte ajo "jo", ishte e pamundur t'a ndërroje mendjen.

U ulën mbi një arkë të vjetër, që ai e solli nga një qoshe e stallës. Përmes dridhjesh të njëpasnjëshme, ajo u mbështet sërish tek ai. Kishte një ndjenjë frike se mos edhe Rroku do ta braktiste, ashtu siç e kishin braktisur gjithë të tjerët. Me sa dukej, ende vuante nga vdekja misterioze e të atit, rrethanat tragjike të së cilës përbënin që nga ajo kohë, thelbin e bisedave të pafundme të Artemisit me tezen. Ajo e puthi prapë fuirishëm. Edhe Rroku e përqafoi ngadalë, duke ndjerë deri në dhembje dëshirën për të.

- Ç'kam hequr atë natë që erdhëm, Rrok, - ka qenë një natë me shi dhe krejtësisht e zbrazur nga miqtë, që më parë sa s'na mbysnin çdo natë me përkujdesje.

- Miqtë e pozitës thuaj më mirë, - ia priti Rroku. - Miqve të tillë mos ia pafsha kurrë sytë!

- Sidoqoftë, kemi hequr shumë, - vazhdoi ajo me kokën e hedhur lodhshëm mbi supin e tij, - Pigali dhe Meku e çuan

hakmarijen deri në fund.

- Është gjëja e vetme që dinë ta bëjnë pa kurrfarë gabimi, - tha prapë Rroku me një ton sarkastik.

- Sikur të mos mjaftonin gjithë ato vuajtje që hoqëm pas vdekjes së babait, na çuan në pjesën më të keqe të kësaj rrafshnalte.

- Mirë që s'na futën në burgje, si të tjerët, - foli Rroku si për t'i dhënë kurajë dhe e afroi pranë vetes. - Sidoqoftë, - shtoi ai për t'ia larguar mendjen nga ato gjëra të bezdisshme, - kjo gjë s'do të ndodhë gjithë jetën. Ata janë në fundin e pushtetit të tyre. Dhe fundi, zakonisht është më i hidhur se fillimi. Nagu po shembet gradualisht nën shirat që s'mbarojnë. Atë natë që ika unë, filluan të shemben fasadat e para në sheshin Pigal. Ai, Zibel, tani për tani po tret dhjamin e fundit që i ka mbetur, në qoftë se ka ende dhjamë të tllë.

- O zot, - psherëtiu ajo, - po me ne ç'do të ndodhë?

- Si me të gjithë ata që vijnë, jetojnë këtë gjë pa dashje, ne do t'i përshtatemi rrethanave.

- Në ç'mënyrë, Rrok?

- Fare lehtë. Duke e braktisur makinën që mbytet.

Ajo mbeti e shokuar. Nuk i kishte vajtur mendja te kjo gjë fare e thjeshtë, të cilën i vëllai, Berti, e kishte bërë sa qe Zurba gjallë. Por ajo vetë nuk e kishte dashur këtë lloj braktisje.

- Sidoqoftë, kjo është shenjë dobësie, - foli ajo.

- Ndoshta, - pohoi Rroku, - por nuk është kurrsesi ashtu siç mendon ti, Zibel. Ne na detyrojnë rrethanat e vdekjes për ta bërë këtë, na detyron dhuna. Njeriu nuk është fajtor para ligjit, kur diçka e bën para se të ndodhin rrethana të detyruara tragjike për të ose për të tjerët. Mjaftojnë ata që kanë lënë kokat për të mos qenë sentimental, Zibel.

Ajo ndenji një çast si në mëdyshje. E kuptoi se, në thelb, ai

kishte të drejtë. Ndoshta të gjitha ato që i thoshte atë mëngjes Rroku, ia kishte thënë pak më parë Basriu, por ajo, megjithatë, kishte pasur një fije dyshimi në fjalët e tij.

- Diçka do të ndodhë, Zibel, - i tha ai përkëdhelës, - gjersa bota lëviz pa prerë. Kjo është fija e shpresës që udhëheq gjithçka në botë.

Ai ngriti kokën dhe pa se qielli ishte mbuluar prapë me re shiu. Ato vinin nga humbësirat e rrafshnaltës si një kope e zezë lopësh qiellore që nuk po u zinin këmbët dhé gjëkundi. Në pellgjet e ngrohura ranë aty për aty pikat e para të shiut, paralajmërues të shirave të tjerë më të bollshëm.

- Po mamanë si ta lë? Po tezen?

Ato, edhe sikur të duan, nuk mund ta bëjnë një ikje të tillë. Le të rrinë më mirë aty ku janë.

- O zot, - ia priti ajo e mërzitur, - s'mund ta bëj këtë gjë, Rrok. Do të ishte një vrasje për ato dy të mjerat.

Ai e afroi lehtë e lehtë dhe i përkëdheli flokët që i shkëlqenin ftohtë.

- Shtrëngomë! - thirri ajo deri në një marrëzi dhe filloi të dëgjojë me ankth rrëqethjen e trupit të tij.

U rrokullisën verbtazi në shtratin e ngushtë, pa u parë në sy.

- Sa e bukur je, Zibel!

Ajo qeshi e shpenguar. Më në fund kishte ndodhur, si dikur, dhënia e saj pa asnjë rezervë. Ai e ndiente se ajo tashmë mendonte shumë për të.

- Je më e bukur e zbuluar, Zibel.

- Vërtet? S'mund të rri gjithë jetën zbuluar, si një statujë, - qeshi ajo duke zbuluar një palë dhëmbë të bukur e të shëndoshë.

- Rri dhe pak, Zibel! - i tha ai ethshëm, - kam nevojë për

ty sonte.

- Nuk mundem, Rrok. Më pret mamaja.

- Harrova fare.

U zhduk dhe pjesa e fundit e torsit të saj të ngjeshur, e përpirë nga fustani i saj i trashë prej leshi, që u lëshua shpenguar mbi kofshët e plota.

- U bëre e padukshme, - i tha ai me buzë në gaz, por edhe me njëfarë trishtimi.

- Mirupafshim! - i tha ai , e shoqëroi te dera dhe më pas, e përcolli një pjesë rrugë, pa mundur të shkëputej nga ideja se tek ajo përsosej gjithmonë diçka që s'mund të arrihej lehtë.

XXVII

Lëngimi i Kanad Dikës i ngjante një pështjellimi të pambaruar dhimbjesh, çastesh delirante, heshtjesh të gjata. Disa herë i qe afruar pragut të vdekjes, por nuk e kishte kaluar, megjithëse e dëshironte një gjë të tillë. Të mbesës, megjithëse e telekosur nga ajo pritje e gjatë, i vinte keq për të dhe mundohej t'ia lehtësonte dhimbjen. Doktori i fundit kishte hyrë në atë kullë të shkatërruar tri javë më parë, para se vigjiluesit të merrnin urdhër të prerë për ta izoluar Kanadin nga gjithçka e gjallë me botën përreth.

Për t'u hakmarrë, ata nuk i paguanin më rrugaçët që të qëllonin çatinë e dërrmuar, dritaret pa xhama, dyshemetë e thyera, sepse kjo nuk u leverdiste më, por filluan ta qëllojnë vetë me gurë, nëpërmjet një hakmarrjeje, që i qetësonte disi shpirtrat e tyre. Gurët e parë i hodhën një mesnatë të errët, ndërsa në ditët që pasuan, i hidhnin dhe ditën, pa u bërë merak se kjo gjë mund të binte në sy të gjithë Bushtrimës. Përballë kësaj mynxyre të re, të gjithë heshtnin të zbrazur nga kuraja e

dikurshme. Në të vërtetë, ato ditë guximi i lashtë që këndohej në balada me aq eshk nga rapsodët në ditët e festave, ishte zëvendësuar me një pritje emfatike të nënshtruarish. Boshllëku moral midis kullës së sakatuar të Kanadit dhe Bushtrimës së shurdhuar nga shirat dhe fjalimet entuziaste të Pigalit rritej çdo ditë e më tepër.

Ndjeu hapin e lehtë e të pakët të mbesës, që si një engjëll shpëtimtar thyente zinxhirin e pandërprerë dhe të pamëshirshëm të vigjiluesve.

- Të solla pak bukë e djathë, xhaxha, - i tha ajo me zërin e saj përkëdhelës.

Ai u përkul dhe e puthi në ballë.

- Jam më mire sot, Ketrin, - i tha ai. -Më ndihmo të shkoj deri në banjë.

Kur u kthye, bëri si bëri dhe u mundua të rregullonte shtratin që binte erë. Vajza e vogël qe mësuar tanimë me palëvizshmërinë e tij dhe nuk i bënte asnjë përshtypje as zhuli mbi jastëkun e fortë, as buburrecat që përsilleshin në hekurin e krevatit, që zhdukeshin porsa ajo u binte me peshqirin e këmbëve.

Ai nisi të hajë pak bukë, aq sa mund të hante një njeri, të cilit nuk i interesonte më se ç'bënin të tjerët në tryezë.

- Më sill pak shishen, Ketrin! - i tha ai, pasi la përkrah krevatit pjatën dhe një pjesë të djathit të pambaruar.

Vajza u step për një moment kur i hodhi sytë në pjatë.

- As këtë s'e ha dot? Xhaxha, po vret veten me duart e tua, - tha pikëllueshëm, gati e përlotur. Ishte e vetmja qenie në Bushtrimë, që guxonte sheshit të ndiente se ai ishte më të vërtetë për të ardhur keq.

- Mua më ka vrarë Pigali me kohë, Ketrin! - foli ai.

Pastaj Kanadi rrëmoi nën jastëk, nxori prej andej një dosje

të lidhur kryq e tërthor me fije spangosh dhe ia vuri në dorë.

- Këto shënime, Ketrin, do t'i mbash në shtëpi. Kur të bjerë Pigali dhe ne të lidhemi sërish me botën përtej liqenit Çud, botoi në shtyp. Me honorarët që do të marrësh, bli një fustan nusërie. Dua që të bëhesh nusja më e bukur në Bushtrimë, ose më mirë Miss Bukuria e parë e këtij vendi.

Sytë e saj të zinj, me bisht, si sy aziatikë, u ngulën te sytë e tij të tretur thellë zgavrave. Pa mundur t'i rezistonte më ngashërimit, iu hodh në qafë me të gjithë vrullin e krahëve të hollë. Ndjeu, përmes xhaketës së saj të vjetër, se si u drodh trupi i tij kockor. Edhe Kanadi më në fund po dëneste. Ishte më tepër një dënesje që i përkiste gëzimit sesa humbjes së afërt.

- Do të vij prapë në darkë, xhaxha, - i tha ajo kur po ndahej afër mesditës, - do të sjell doktor Pandalejmonin. Kaq herë më është lutur.

- Mos u lodh kot, Ketrin, - i tha ai shtrirë sërish në dyshekun e fortë, - ata s'lënë asnjë mjek të futet tek unë. Është e kotë ta provosh.

- Megjithatë, do ta sjell, - këmbënguli ajo.

Ai mbeti përsëri vetëm në anijen e vet të thyer.

Dalëngadalë po binte dhe një natë tjetër. Hyrja e saj paralajmërohej nga një errësim i përkohshëm i horizontit të qëlluar ligsht nga shiu i pandërprerë. Zgjati dorën e thatë si pergamenë në arallëkun midis kanateve të pambyllura mirë. Pëllëmba e kthyer u lag me diçka të ftohtë, të qullur. "Dëborë, - tha ai, - shyqyr se na mbyti shiu!. Vërtet po binte dëborë. Fërfëllima e lehtë e flokëve të saj ndihej në boshllëkun e madh që qe krijuar midis reshtjes së shiut dhe flllimit të menjëhershëm të flokënajave të ftohta. U mbështoll edhe më shumë me jorganin e vjetër. Ndërrimi i atmosferës sikur i

solli një prehje të menjëhershme, të pritur nga ai me dëshirë. Mbylli qepallat por, në kohën që po e merrte gjumi, dëgjoi se si në korridorin e shkatërruar u rrokullis një gur tjetër, më i rëndë. Rrokullisja nëpër shkallë shungulloi në një mënyrë tronditëse për të gjithë kullën e shembur.

"Është guri më i rëndë që kanë hedhur", - psherëtiu hidhur. Tani kullës nuk i kishte mbetur gjë tjetër veç skeletit dhe mureve. Pastaj krisi diçka tjetër atje poshtë. Përgjoi me ankth. E kuptoi se ishin rrënuar shkallët që lidhnin katin e parë me të dytin. "Ah, - qeshi ai, - kam mbetur në një kullë ku s'ka më as shkallë, as dysheme, që është si një trup midis tokës e qiellit, që si përket më asgjëje të gjallë e as të vdekur". Ai ishte askurrkushi i përrallës, që do të fluturonte nga Bushtrima drejt planetëve të largët, i përpirë nga erërat qiellore dhe magma kozmike.

Sytë, gati fëmijërorë, u munduan të shquajnë se deri ku kishte vajtur mbarsja e Bushtrimës me dimër të bardhë. Ajo vegjetonte atje tej, e shpërndarë proporcionalisht në sukat dhe në majat shkëmbore, e shkatërruar nga era dhe erozioni i paprerë, si një qytet, që i kishte munguar gjithmonë dheu dhe bari, për t'u zbutur deri në finesë dhe plogështi. Kulla e tij qe mu në majë dhe nga ajo majë mund të sundohej më lehtë hapësira përpara, ku fërfëritja e paprerë e flokëve të borës, i jepte gjithçkaje një gjumë universal. Edhe atij i vinte gjumë, sepse edhe ai ishte grimcë e këtij universi të shkatërruar nga vullkanet, mallkimet, era, shiu, njerëzit. Vuante së brendshmi mëkatet e të parëve dhe të atyre që do të vinin patjetër, po nëpër ato rrugë shkëmbore të ashpërsuara nga mungesa e delikatesës. Para bebeve të tij të lodhura, nga të cilat po largohej edhe flaka e fundit e një zjarri të lashtë, hidheshin flokënajat e pafundme të dëborës, që vareshin jo më nga retë,

por nga Marsi, Saturni, Plutoni. Ai pa se si përtej udhëve që shkonin kryq e tërthor botës ecte një njeri, i cili zvogëlohej proporcionalisht, si një figurë që dëshironte të arrinte cakun për nga ishte nisur për këtu. "Ah, - tha ai, përgjumësh, - të njoh, ti je Kanadi i vogël. "Po, - tha njeriu që po ikte prapëtazi andej nga kishte dalë dikur nëpërmjet dhimbjesh të një tjetre, - unë jam Kanadi burrë, djalë, fëmijë dhe tani askurrkushi. Unë jam bora, era, gurët që ruajnë përjetshëm forcën për të ripërtërirë edhe atë që duket e pathyeshme: vdekjen".

Dhe ai ecte në prehrin e saj. Prehri qe i butë dhe ai, nga kënaqësia, ktheu kokën për të parë se kush qe ajo. "Jam unë, - tha një zë i panjohur. - Kjo rrugë do të të çojë drejt Bushtrimave të tjera". Ai qeshi me vete, pastaj ndjeu se diçka po e pengonte ta pyeste se kush ishte, sepse po e përpinte gjumi i bardhë, ai gjumë për të cilin tani nuk kishte nevojë as për zemër dhe as për gjak si të gjallët.

XXVIII

Zhurma erdhi e papritur dhe pikërisht në atë moment kur ai kurrsesi nuk e priste të vinte e tillë.

Sapo qe mbështetur, me mendimin se arratisja do të ndodhte në orët e vona të natës. Pasi hëngri pak bukë e djathë, u shtri të merrte një sy gjumë. U zgjua pikërisht atëherë kur dikush godiste derën me shkelma. Ai u zgjua dhe përmes zemërimit, që e bënte akoma të hezitonte të vishej apo jo, dëgjoi zërin e shqetësuar të Basri Memës, që e thërriste pas murit.

- Rrok!

U vesh me shpejtësi, i shtyrë dhe nga frika se mos iknin pa atë. Kapi ç'mundi në atë terr të thellë si qymyri, të qullur

nga shiu, që sapo kishte zëvendësuar dëborën e shkrirë. Ata e prisnin pak më tej, në njëshkolonë, të pushtuar nga etja dhe ankthi.

Hodhi me të shpejtë kapuçin mbi kokë dhe zuri të këqyrë me kujdes e nervoz njerëzit që fllluan të ecnin. Ai priste diçka. E njohu tek mënjanohej disi nga të tjerët.

- Zibel!

Ajo i doli përpara, me atë veshje si prej kozmonauti. Iu mbështet ngadalë në gjoks.

- Do të çajmë vallë, Rrok? – pyeti Zibeli.

Fryma e saj e goditi drejt e në hojëzat e hundës. U përkund gati si i dehur dhe, pa pritur që ajo të reagonte, e puthi lehtë e shpejt në buzët e ftohta e të tendosura.

- S'di përse kam shumë frikë, - shtoi më pas ajo.

- Mos u shqetëso, e dashur, - i tha ai duke e ndjekur me një hap të sigurt dhe duke e tërhequr lehtë nga xhupi, - kjo ikje vazhdon çdo natë. Kallauzët e dinë se ku mund të na kalojnë më lehtë.

- Do të lagemi deri në palcë.

- Me mushama e ke këtë xhup?

- Po, - tha ajo, - megjithëse këtij shiu nuk i shpëton asgjë.

- S'kemi shumë rrugë për të bërë, - ia ktheu Rroku, - mund të zgjasë deri në tri orë.

- Një shekull thuaj më mirë.

Vargani i të arratisurve, i pashkëputur nga njëri-tjetri, zbriti gati në vijë të drejtë luginën e mbushur me ujë. Ecnin drejt perëndimit, atje ku Rroku kishte parë gjithmonë me shpresë malet me maja të rrumbullakosura.

Midis grykave të shtrembra e të gjymtuara nga uji, bënin roje vigjiluesit e armatosur, pas shpinës së të cilëve nxinte tej e ndanë, si një mur i ri kështjelle, kloni i përbërë nga tela

me gjemba e zile alarmi. Megjithatë, kalimet e shpeshta të njerëzve kishin hapur në të shtigje të gjera ku lidheshin natën qen të mëdhenj kufiri. Prapëseprapë çdo natë kalonin dhjetëra të arratisur, një pjesë e të cilëve kapej ose vritej pa paralajmërim.

Po kalonin nëpër një shpat të pjerrët e të rrethuar nga një krehër bokërimash, që zymtonin me majat e tyre gati metalikë. Ecnin brinjazi dhe Zibeli këlthiste lehtë nën çdo hap që hidhnin, sepse kishte frikën se mos rrëshqitnin dhe binin në fund të hinkës së mbushur me mister. Rroku, që ecte pas saj, nuk ia ndante sytë, i përpirë nga mendimi se deri ku do të nxitonin nëpër atë ferr nate dhe frike, ku çdo figurë fantazmagorike, e vizatuar keq në sfondin blu, krijonte tek ai idenë e një ankthi të madh. Papritmas, Zibeli u anua dhe klithi mbytazi. I kishte rrëshqitur këmba dhe tani kapej vetëm me njërën dorë në xhupin e Rrokut. Ushtoi një bubullimë e çuditshme në mes të atij terri të shushatur. Duke e tërhequr lehtë, ai e ngriti nga sqetullat, në kohën që ajo mbahej e pafuqishme në krepat rrëshqitës me majat e gishtërinjve të ngrirë.

- O zot, - thirri ajo vajtueshëm, - s'mund të eci më tutje, Rrok!

- Edhe pak, Zibel, - ia ktheu Basriu, që e tërhoqi me kujdes për të evituar një kthesë tjetër të rrezikshme, - punë momentesh.

- Po harxhoj fundin e forcave, - foli ajo duke gëlltitur lotët.

- Është gjëja e fundit që kalojmë me kokë në torbë, - i pëshpëriti Rroku, i shqetësuar nga lodhja dhe nervozizmi i saj, që shtohej çdo çast e më tepër.

- E di, - tha ajo me një ton të qetë, - po s'kam se ç'bëj, Rrok. Mbamë pak.

Ai iu fut pothuajse nën trup dhe e ngriti në shpatulla.

- Më shpejt! - thirri dikush me zë nervoz para tyre.

Rroku ngriti kokën dhe mati me sy dy shpatet e pjerrët që rrethonin ikanakët e qullur e të lodhur. Qe i lodhur edhe ai për vdekje; i duhej të punonte sa për dy veta. Nën rroba ndiente se avullonte. Tok me ujin, që tani po i vërsulej pjesëve të trupit të tij më pak të mbrojtura, ai e ndiente qëmtimin indiferent të djersës në rrëzë të veshëve. Mezi priste sa të mbaronte gjithë kjo arrati drejt një pike të zezë të natës; natyra po fitonte çdo çast e më tepër një pushtet gati absolut mbi të gjithë ata që ecnin me koka të ulura përtokë në kërkim të asaj që s'e dinin se ç'ishte. Këmbët e Rrokut, të përziera detyrimisht me këmbët e Zibelit, si dy trupa në një shpirt të vetëm, vazhdonin të kërkonin me kujdes shkallinat rrëshqitëse.

- O zot, - psherëtiu Zibeli gati e nënshtruar para lodhjes, - u këputa fare!

- Mbahu dhe pak, Zibel! - i dha zemër ai, pa harruar t'i jepte zemër edhe vetes.

Pa se si Basriu qëndroi një çast dhe i priti. Dihaste lodhshëm edhe ai.

Duket sikur po ngjitemi në purgator, - u pëshpëriti duke u zvarritur këmbadoras. Po këtë gjë bënë dhe Zibeli e Rroku.

- Në parajsë më mirë, - tha Zibeli tek fshinte duart e bëra me baltë. - Ne vijmë nga ferri dhe duhet të shkojmë patjetër në parajsë.

- Kështu, të ngarkuar me shi dhe vuajtje, jemi tamam për atje, - qeshi lehtas për herë të parë atë natë Rroku dhe shtoi: - Shën Pjetri s'do të ketë kundërshtim të na çojë në pjesën më të mirë të saj. E kemi merituar.

- Mos harroni se duhet të kaloni më parë purgatorin, - ia ktheu Basriu, - sepse kemi bërë shumë mëkate. Veçanërisht ti, Adam dhe ti, Evë.

Zibeli u mbështet me kurriz në trupin e Rrokut. Kishte filluar të ndiente frikë nga gjithë ai rrugëtim.

- Më duket se humbëm rrugën, - tha ajo, si t'i përgjigjej me këto fjalë dyshimeve që e brenin qysh kur ranë në atë humnerë.

- S'e besoj, - ia priti Rroku tek e shtynte ngadalë, për të ngjitur një të përpjetë rrëshqitëse. Ecnin pa u diktuar nëpër një terren që rrihej dendur nga patrullat e vigjiluesve. Mosdukja e tyre e mbushte me parandjenja të zymta, sepse i trembej një kurthi të fshehtë. Befas, nga një vrimë e largët e natës oshtinë disa krisma, që sikur e shkretuan gjithë atë dekor fantazmagorik të ngrirë e të lagur gurësh, uji dhe nate. Zibeli kërceu në gjoksin e tij, gati pa marrë frymë, e përpirë nga një alarm shpirtëror. Dikush para tyre u rrëzua e mori tatëpjetë malit, si t'i ishin prerë befas duart e këmbët. Ai u zhduk në honin shungullues.

- Ç'është? - pyeti ajo e llahtarisur.

Asgjë, ai rrëshqiti dhe ra, - tha Rroku për ta qetësuar, - kurse krismat vijnë nga ana tjetër e kufirit.

- Nga ana tjetër e kufirit? - pyeti ajo sepse e kuptoi se Rroku i kishte thënë gjithë ato fjalë të rreme vetëm për ta qetësuar.

- Po, - tha Basriu, i cili nuk e fshihte dot shqetësimin, - ecni më shpejt.

Zbrisnin në një të tatëpjetë më të butë. Kur mbërritën në fund të saj, prapë u dëgjuan krisma të tjera. Dy trupa të tjerë vagëlluan disa metra më tej. Ata morën rrezikshëm të zbrisnin rrokullimthi shtratin e zhveshur të një lumi të braktisur plot gurë të zinj. Binin njëri pas tjetrit, me kërcime si prej njerëzish që ishin në gjumë, derisa u zhdukën në thesin e thellë e të shqyer të natës së dyshimtë. Mbas pak u dëgjua mbytur rënia e

tyre e parakohshme mbi sipërfaqet e mprehta të gurëve të zinj.

- Po na qëllojnë, - thirri Zibeli e i kapi me ankth duart Rrokut.

- Më shpejt! - thirri dikush para tyre me një zë ku sundonte pikëllimi indiferent.

Dhe ata lëvizën shpejt, në kohën që i qëlluan prapë nga e majta dhe e djathta. Plumbat këtë radhë fluturuan gati mbi kokat e Rrokut aq sa Zibeli thirri me zërin e një gruaje që i është sosur dhe pjesa e fundit e durimit. Por plumbat tani ranë pas tyre. Tre-katër njerëz u shkëputën dhunshëm nga kolona e shthurur befas.

Nisën të vraponin gati pa iu bindur më britmave të kallauzëve. Në krye të tyre doli Basriu, që vraponte më lehtë në fundin e një lugine me pellgje, uji i të cilëve u kërcente në sy e në veshë, në kohën që s'e dinin se çfarë bënin të tjerët përreth tyre.

Rroku e kuptoi se ata duhej të qenë shitur qysh në nisje. Tradhtari mbase fshihej në radhët e tyre, ndoshta e kishin vrarë që të zhduknin dhe një provë të fajësisë. Kishte shumë prita, por Basriu nuk mori rrugën nga kalonin të gjithë se kjo mënyrë do t'u kishte kushtuar kokën të treve, por dredhoi në shpatin e një mali plot me gurë të mëdhenj.

- Këtej! - thirri Basriu e u hodh mbi një parapet të gurtë që ndante dy anët e një përroi me ujë të shkumëzuar në fund. Rroku e ngriti peshë Zibelin dhe u hodh me të në anën tjetër.

- U vrave? - mundi t'i thotë ai me ankthin dhe pasigurinë e një njeriu të humbur.

- Pak! -tha ajo dhe i kapi dorën si një fëmijë.

Përsëri disa krisma të forta, që bënin mbi kokat e tyre vizatime magjike dritash, si në vigjiljen e një feste të keqe. Tani ecnin me ngadalë nëpër morinë e gurëve të ashpër plot

thepa. Rrokun, që shpresonte të dilte më në fund në tokë neutrale, po e brente dyshimi se mos ata kishin hyrë gabimisht përsëri në territorin e Nagut. Sytë e tij, të mësuar tanimë me tonin dhe ngjyrat e zeza, dalluan atje tej, në grykën sipër tyre, gardhin e lartë të klonit.

- Sipër, Basri! - i tha ai dhe e përfshiu Zibelin nga supet.

U përplasën me disa ikanakë të tjerë, të shqetësuar dhe të dalë nga binarët edhe ata. I qëlluan nga një pikë dominuese përballë. Para Basriut u shtrinë menjëherë dy njerëz, që zunë të përpëliten të larë në gjak. Një tjetër u rrokullis në gropën poshtë, pasi lëshoi më parë britmën e llahtarshme. Si të nxiteshin nga kjo agoni therëse, plumbat zunë të bënin rikoshietë mbi gjithë kurrizin e plagosur të errësirës.

- Drejt klonit! - thirri Basriu.

Ata të tre kërcyen me një hap të vetëm në hapësirën e lirë midis telave të shqyera më parë nga të tjerë ikanakë.

Në kohën që pothuajse kaluan në tokën neutrale, i qëlluan sërish nga fortesa përballë. Plumbat fluturuan mbi kokat e tyre; vetëm njëri bëri një ulje të rrezikshme e goditi diçka para këmbëve të Rrokut. E kapi Zibelin nga supet, në kohën që atë po e mundonte diçka, gjë të cilën ai nuk po e kuptonte se ç'ishte, sepse nuk kishte kohë ta pyeste; rrokulliseshin gati pingulthi në tokën e liqenit Çud, të çliruar më në fund nga ajo llahtari.

- Më në fund shpëtuam! - tha Basriu.

- Jemi të vetmit që kemi shpëtuar, - tha Rroku si i lojtur vidhash, me sytë e mbushur me diçka të panjohur. Ai qe shtrirë përkrah Zibelit me këmbë të hapura dhe shihte si i pangopur hapësirën e kaltër atje poshtë, ku vizatohej butësisht bregu i liqenit Çud.

- Ishim të paktën njëqind vetë, - iu përgjigj shkarazi

Basriu, me sytë e ngjitur në trupin e rënë përmbys, në një pozë të pazakonshme të Zibelit, - ne jemi tre, nëntëdhjetë e shtatë të tjerë janë të humbur, të vrarë ose të kapur.

Ngrehu, Zibel! - thirri befas Rroku vrulltazi si të kujtohej për pjesën kryesore që kishte harruar deri atëherë, - e hodhëm lumin dhe këtë radhë.

- Është e lodhur për vdekje, - tha Basriu pa u besuar as vetë atyre që thoshte, sepse nuk po e kuptonte qëndrimin aq indiferent të Zibelit.

Edhe Rroku e kapi vetëtimthi merakun që rrëshqiti në sytë e transformuar të Basriut. Ktheu kokën nga ajo dhe, si njeri që për herë të parë kupton se ç'gjë e tmerrshme fshihej pas asaj poze jo të zakonshme, si prej njeriu të futur në narkozë, thirri sërish, por me një zë, tashmë tepër këlthitës:

- Zibel!

Ndoshta fle, - tha i pasigurt Basriu që u afrua te koka e saj gjithë shqetësim dhe i foli:

- Zibel!

Ai e ktheu përnjëherë me fytyrë nga ata. Por trupi i saj ende i ngrohtë mezi iu bind forcës së tij, sepse një pjesë mbeti ende në pozicionin e parë. Ajo nuk reagoi me asnjë shenjë të vetme kundër thirrjes së tij mbinjerëzore. Piklat e rralla e të imta të shiut i ranë në fytyrë.

- O zot, - tha ai rënë gati përmbys mbi trupin e saj, - ç'ka kjo, Basri? Deri pak më parë qe fare në rregull.

Basriu e pa në fytyrë dhe i ktheu me tmerr sytë mënjanë. Vështrimi i Rrokut qe zbrazur pothuajse nga çdo gjë e vetja. Ai u mbush në moment me lëndën e rëndë, të huaj, agresive të një trupi jotokësor.

Ia fërkoi tëmthat e hequra, faqet, hundën, flokët e shprishura nga kapuçi i rëndë. Nuk bindej ende që kishte

ngjarë diçka e pandreqshme. Me të gjitha forcat tentonte t'ia rrëmbente vdekjes atë gjë që ajo kishte marrë me vete krejt rastësisht, si nëntëdhjetë e shtatë të tjerët para saj. Mirëpo ai tërhiqte tani vetëm një trup. Zibeli nuk ishte më me të. Si zbrazja e një guaske nga margaritari i saj.

- Aaa! - ulëriu dhe u ngrit në këmbë si i shkurdisur. Basriu, që qe bërë akull përbrenda, nuk mund të kundërshtonte asgjë, veçse të ndiente se edhe ai ishte gati të ulërinte.

- O zot! - tha Rroku gati në ulërimën e fundit, - ka vdekur, Basri?

- Po, - pohoi si pa qenë në vete Basriu.

- O zot! - përsëriti prapë Rroku mekanikisht.

U përkul si para një kristali të brishtë dhe e puthi lehtë e shpesh në buzët e përthara tashmë edhe nga pikat më të vogla të shiut dhe të lëngut që u jep jeta krijesave prej lënde të ngrohtë.

- Po, - tha Basriu me pezm, - ata e vdiqën!

XXIX

Rroku e lëshoi me kujdes Zibelin në një pjesë toke gati të sheshtë. Nën kokën e lëshuar papërfillshëm, nën vete ai vuri xhakaventon, ende të lagur, por të kthyer nga pjesa e përbrendshme e astarit. Ishte më tepër i vdekur se i gjallë.

- Do fillojë prapë shiu, - tha me njëfarë shpengimi të sforcuar Basriu.

Rroku vështroi qiellin që kishte marrë goditjet e para të shpërbërjes së natës.

- Do ta varrosim? - tha Rroku me një fill zëri të humbur. Më në fund kishte thënë atë më të rëndësishmen, që pak më parë s'guxonte t'ia pohonte as vetes.

- Po, - pohoi Basriu. I qenë tharë tiparet si nga një avullim

i menjëhershëm i gjakut.

- Ku? - pyeti prapë Rroku.

Basriu u drodh lehtas nga ai vështrim gati si prej bishe. U mblodh gjunjazi mbi gur, si ta goditnin me fshikull në fytyrë. Ndihej fajtor për vdekjen e saj, sepse ai qe shkaktari i asaj nate plot krisma. Ndjenja e fajit e përvëlonte në të gjithë pjesët e trupit si me hithër.

- Atje lart, - tha Basriu prerë.

- Ku? - pyeti prapë, pa qenë në vete, Rroku.

- Në shpellë. Këtu bie shumë shi, Rrok, kurse shpella është një gjë e sigurt. Është sipër, në atë majën mbi ne.

Rroku u ul shtruar para trupit të saj të kruspullosur. Kishte mbaruar çdo gjë, ajo nuk mund të ishte më Zibeli. Natyra po i merrte çdo minutë e më tepër atë që ia kishte dhënë dikur me bujari. Përmes dhimbjes së pafundme që po e mbyste, iu kujtua se si atë natë, tek përgjumeshin në kotjen që të jep një dashuri e mbaruar me puthje, i tregoi historinë përrallore të një princeshe të copëtuar me shpatë nga njerka, të cilës i dashuri, duke sakrifikuar rininë dhe forcën, i solli, nga fundi i llahtarshëm i botës, ujin magjik, me të cilin ai ngjiti dhe ringjalli gjithçka kishte pasur ajo në kulmin e bukurisë së vet. Ishte gati ta besonte këtë mrekulli; do të sakrifikonte, për ta rrëmbyer këtë ujë, gjithçka që mund të jepej nga një burrë. "Një kalë dhe një shpatë, Zibel", - pëshpëriti ai. - Rruga për te kuçedra është e gjatë, e lodhshme, kalon nëpër shkretëtira dhe male të ashpra, megjithatë arrij më në fund te shpella e saj, Zibel. Dil, i them asaj, po vë në provë jetën time për një kupë ujë magjik".

Si të kujtohej se e gjithë kjo nuk mund të ishte veçse një halucinacion, ndjeu se si tek ajo po ftohej dalëngadalë gjaku i fundit në gjymtyrët dhe pjesët e zbuluara, që lageshin

dhimbshëm nga shiu. Ktheu kokën të mardhur, të humbëtisur në periferitë më të largëta të vetvetes, drejt Basriut.

Shkojmë! - tha Basriu. - Jemi ende në zonën neutrale, Rrok!

- Po, - pranoi ai.

Sheshi Pigal, që dukej nga ajo lartësi, si një shami i hapur keq në të katër anët mbytej në një shkreti asgjësuese. Dukej krejtësisht gri nga myku i madh që kishte mbirë mbi çatitë, pullazet, muret e shembur, gërmadhat e shumta, sheshet e qullur.

- E tmerrshme! - pohoi Rroku me një psherëtimë të rëndë.

Po, - mundi të belbëzojë Basriu, - ka dyzet ditë që bie shi paprerë dhe sot është mëngjesi i parë që koha kthjellohet disi. Kjo ka favorizuar sporet, mykun dhe kërpudhat. Me sa duket, tani qyteti i takon atyre përfundimisht.

- Sidoqoftë, për ta ribërë atë duhet ta rindërtosh nga e para, - tha Rroku dhe ktheu vështrimin pjerrtas mbi trupin e Zibelit, të rregulluar me kujdes mbi peliçe. Dukej sikur flinte dhe kjo i dha idenë se e gjithë ajo lojë që bënë pak më parë me vdekjen ishte vetëm një akt i shtyrë nga një parandjenjë krejt e rastësishme.

- Ishte një gjë që pritej, - ia ktheu Basriu, - ata e çuan me vetëdashje deri në këtë ditë.

- Më saktë, një lojë egoiste me botën.

- Tani atje kanë mbetur fare pak, - tha Basriu, - ndoshta shumica kanë ikur si ne, ose do të ikin këto ditë.

Basriu pa orën.

- E shikon? Akoma s'ka nisur asnjë lëvizje, megjithëse ora po vete shtatë.

Tani për tani qyteti është pushtuar nga kërpudhat dhe myku. Ndoshta dalja e diellit do ta prishë dhe këtë mbretëri

me spormofite.

- Ose ka filluar shtetrrethimi absolut. Kam dëgjuar se Pigali ka vendosur që në rrethana të jashtëzakonshme do të vendosë regjimin e një kampi mongol.

- Aty s'ka mbetur më asgjë për të bërë shtetrrethim të tillë, - foli Rroku me një zë më të gjallë se më parë. - Izolimi ka fshirë gjithçka që duhet të fshihej. Shtetrrethimi mund të shpëtojë vetëm vdekjen, sepse s'ka ç'të bëjë tjetër në një vend të rrënuar me gjithsejt.

- Kushedi, bota tani është bërë më e mençur dhe do të na kuptojë se nëpër ç'dhimbje e tersllëqe kemi kaluar, - tha Basriu. - Na mjafton vetërm të vëmë në jetë ato që ka parashtruar Kanad Dika.

- Vështirë, - përsëriti Rroku dhe u përkul e me një lëvizje të fuqishme mori Zibelin në krahë. - Tani le të ikim në shpellë Basri, te shpella e Zibelit.

Në majën e kodrës Basriu ktheu pak në të djathtë dhe u fut në brendësi të shpellës. Përnjëherë filloi të freskohet. Rrokun s'po e mbanin më këmbët e bëra plumb. Të keqen më të madhe e kishte te duart e plogështuara nga qëndrimi statik i Zibelit. Psherëtiu lehtë kur Basriu qëndroi në buzë të një pellgu të madh me ujë të kulluar. Lart, mbi kokat e tyre, hynte, nëpërmjet një oxhaku të gjatë vertikal shkëmbor, një pjesë e dritës, ndërsa pjesa tjetër vinte nga hyrja, që nga ai vend, nuk ishte më larg se dhjetë metra.

- Këtu, - tha Basriu, duke treguar një vend më të lartë, të rrethuar me stalaktite e stalagmite të holla në pjesën e sipërme.

Ai e uli me kujdes Zibelin mbi xhupin e shtruar pak më parë mbi tokë. Kontrolloi një herë me sy pozicionin ku kishte qëndruar. I pëlqeu, sepse ishte tepër i qetë dhe tepër i mënjanuar, si një vend që nuk i përkiste më njerëzve, por

përrallave të lashta të Nagut.

- Kam ardhur edhe dy herë të tjera këtu, - foli Basriu që matanë një kthese që s'dukej nga vendi ku priste Rroku, - është një shpellë e njohur speleologësh. Diku, këtu kam fshehur një lopatë.

Rroku papritmas u drodh. Kazma e lopata qenë pjesët e natyrshme të një varrimi. Ai ngashëreu ultas, si ta ndëshkonte veten për të fundit herë.

- Është vend ideal, - foli Basriu që u kthye dhe hodhi përtokë një kazmë e lopatë, - shpella nuk ka emër, por tani e tutje do ta quajmë Shpella e Zibelit.

Rroku u ngrit e kapi me vrull kazmën. Filloi të gërmojë përmes gulçimës që po ia shkundnin mizorisht shpirtin. Basriu, që pastronte dheun e gërmuar, e ndiqte me një vështrim plot kujdes. Gërmuan një copë herë të madhe, nëpërmjet korrentesh që ua pinin djersën pa mëshirë. Pastaj, Basriu e mbështolli me xhupin e madh trupin e ngrirë të saj. la mbërtheu komçat deri lart në fytyrë, që ajo të mos kishte asnjë kontakt me dheun e gërmuar.

- Prit, - ulëriu Rroku.

U ul dhe e puthi me gjithë shpirt në buzët e akullta.

Qëndruan për një copë herë të gjatë pa folur mbi varrin e rregulluar me kujdes. Basriu nxori me ngadalë nga xhepi pagurin me të cilën kishte pirë një natë më parë.

- Pi, - i tha ai, - edhe ajo pinte.

Gëzuar, Zibel! - tha Rroku dhe e ktheu pagurin si i marrë, - do të kthehemi përsëri, e dashur. Na prit.

- Gëzuar, Zibel! - tha Basriu.

Kur dolën jashtë kishte nisur prapë të binte shi. Prej aty Rroku pa për një moment se si feksi për të fundit herë qyteti Nag. Që aty kishte nisur të vdiste Zibeli.

Para syve të tij vetëtiu me ngjyra smeraldi liqeni Çud.

- I biem shkurt nga kjo anë, - tha Rroku dhe u nis nëpër ngushticën midis dy maleve, si të shpëtonte t'i vidhej Silës dhe Karibdës, te të cilat sapo kishte lënë më tepër se gjysmën e vetes.

1991

Poezi të zgjedhura nga librat “FENIKS” dhe “TORAKS”

I.
NGA LIBRI “FENIKS”



Atdheu

Shpesh bie në mendime dhe them se jeta, fati
të trishtë janë si vjeshta që skuqet në drithërimë
po kur kuptoj se jam një shkëmb nën emrin tënd
guxim fitoj të endem, të qesh si perëndi.
Kallaji yt i çmuar dhe deti valëthinjur,
agimi i mbuluar me velin e njeriut
dhe molot ku vaporët në pritje detesh flenë,
të gjitha janë copëra nga zemra jote tokë!
një rrap që një fëmijë e luan e s’e heq
dhe topi buçimplotë i mbushur me urrejtje,
besimi në mendimin e nesërm dhe më tutje
janë germa nga një emër i bukur: Shqipëri.

Veçan ajo nuk ka as arin as njeriun
si gjithë nocionet e tjera sinonime,
por ka një gjë që zemrën e huaj nuk e prek:
udha që qesh e shkon në vatrën atërore.
Copëtoma zemrën ti por mos më lër pa të!
Kam parë udhëtarë që vinin nga shtegtimet,
me kamje pasuri të madhe, por plot lot
përkuleshin ndaj shkrepit të vjetër, strall prej mali
dhe s'donin asgjë tjetër veç gurët atërorë.
Të gjitha mund t'i falnin por atdheun jo!
Moj dorë e padukshme e vjeshtës amtare
si eliksir na deh në shtratin mortor.
Princ qoftë fati ynë, ose lypsar i shkretë,
të lumtur venë në varr të gjyshërve të qetë.

Jam si Feniks

Jam si feniks,
me dy fytyra njerëzish,
me dy fuçi të mbushura me ndjenja,
dy zemra rrahin,
njëra për ju dhe kohën e sotme
dhe tjetra është dridhje
e pavdekësisë.
Për ju ndërtoj kritikë
dhe sekserë të poezisë
ndërtesa shkatarraqe
me dyer dhe dritare iluzore
në tokën e bekuar të së nesërmes
jam si feniks.
I shoh ato dhe qesh me veprën time
pa linja dhe arsye poetike.
Por vetëm me një lustër gënjeshtare
jam si feniks.

Kritikë dhe censorë të patrembur
barriera ngrini me servilizmin tuaj
për zemrën time të madhe dhe të bukur
që s'rreh për ju, po për njerëzimin
jam si feniks.
Ju merruni më mirë me lirikat
e mia mendjelehta poetike,

ato i pjell dhe s'ndiej habi dhe dhimbje
por vetëm një nevojë simbolike
jam si feniks.
Pastaj, si futem thellë nëpër botëra,
gërmoj mendimet, kohërat pushtet thella,
thërres dhe qesh dhe zemrën copa-copa
e kam shpërndarë në të gjitha trajtat
jam si feniks.

1974



Femër!

Femër!
emër që shfaqet në trajtat e drurit
emër që shfaqet në formën e gurit
emër që shkrifet në jetën e barit.

Femër!
emër që duket në këngën e zogut
emër që ngrohet në ditën e grurit
emër që dridhet në cipën e Iules.

Femër!
emër që shtrihet në ëndrat e tokës
emër që hapet në thirrjet e luftës
emër që shtohet në farën e paqes.

Femër!
emër që mbillet në cipën e vdekjes
emër që shkrihet në udhën e jetës
emër që mbillet dhe korret çdo vit.

Femër!
Emër që duket në trajtat e botës
emër që endet në botrat e qiellit
emër që shuhet dhe ngjallet trefish.

Femër!
emër që varet në presën e thikës
emër që fshihet në gjuhën e gjarprit
emër që shfaqet në pushin e majit.

Femër!
emër që s'ikën nga buzët e malit
emër që s'zhduket nga shpata e tundrës
emër që s'tretet nga luga e epshit.
Femër!
emër i paqes, emër i dritës
emër i jetës, emër i yllit
emër i Iules, emër i barit.

Dielli çam

O vajzë brune, vajzë çame
përse m'u shfaqe vallë përsëri
diku në udhën time eoljane
nën diellin e zymtë pa kufi?

Kam diell herë-herë natë
e fusha akuj bie sërish
por udha është kaq e gjatë
drejt lumturisë së dyfishtë.

Atdheu yt diku ka mbetur
nën shovinizmin gjyshëror
gjer pas Janinës kos e hekurt
përkuli fiset njerëzore.

Tani atje ka mbetur hiri
i botës që nuk kthehet më
dhe udha që drejt teje lindi
nën shenja ikjesh zbardh gjithnjë.

Ti natën qan ullinjt' e shkretë
s'ke ngushëllim si fisi çam
kujton Filatin moj e zbehtë
me shpirt të trishtë si duman.

E puthjet e fjalët që më bie
diçka si brengë kanë moj,
diçka të largët, ëndërr, hije
që shfaqet, shuhet, por s'mbaron

* * *

O udhë çame, o udhë përse larg
mi çoni ju tani mendimet trishte
gjer pas Prevezës ku Joni çmallet, lag
toka shqiptare të vjetra, ilirike?

Përse çdo natë nën yllin fin të jugut
si shëmbëllim të tokës që ka ikur
shikoj Nadiren me spektër ditësh blu
në çdo katund të lashtë, të braktisur?

Nga tokat, lulet që kurrë si ka parë
diçka ajo ka marrë dhe ka dhënë;
diçka si brengë, si mrekulli të artë
që nën dy sy të errët shfaqej mbrëmë.

Dhe nga trishtimi çam i pakufishëm
që si Ebrejtë ikën nëpër tokë
lulzon ajo si femër e magjishme
në katër stinë malli sjell një botë.

* * *

E ndjen shiun që bije Nado
natyra po zhvishet nga gjethet lozonjare
dhe qyteti tani mërdhin

nëpër parqe metalikë imazhet e taksive marrin hije
gurgullon në zemrën time era e vjeshtës lamtumirë;
verë e gjallë e qytetit zëra dashurishë në terr
hapa që kondensoni në muzg ritmin e një jete të re,
lamtumirë rrepe gjelbëroshe ku varen yjet dritëpakët
pluhur i njelmët gështenjash, tani shiu që ka nisur
i vodhi tinzisht imazhin e dasmës dhe taksinë
lamtumirë ikje sezonale detesh në plazhin turistik
kaloi dhe iku lokomotiva e fundit me nuse në bord
nëpër shinat metalike rrëshqiti muzgu i shirave si gjumë
lamtumirë qytet i xhveshur nga natyra provizorisht
edhe unë si ti pres pranverën, ndërsa ti hesht memec
unë zemrën dhe mendimet murosa nën çdo stol të bardhë
lamtumirë.

* * *

Mos qaj bukuroshe, nga vdekja mos qaj të lutem
indiferenca e varreve e tmershme lotët ha si pus
nëqoftëse ikën zëri i një njeriu, ky është ligj fatal
i përcjell ai njerëzit në agim deri në qytetin final…
ja jeta përsëri rrjedh tej xhameve
të mbuluara nga kthetrat e vdekjes
nëpër rrugën ku xhenazeja e lodhur u zhduk
vajzat tundin këllqet, fërshëllin treni i plazheve
dhe deti më i butë se toka thërret dashuritë
ç'ti bësh e dashur tani në sytë e butë si vesa
puthje të tjera do të bijen si fishekzjarre në muzg
mjerë ai që ikën, fati me të gjallët më i butë është
nëqoftëse dijmë të harrojmë kjo i përket vetëm jetës
ndryshe kush s'do të çmendej nga ankthi përditë?!

lëre dritaren hapur natën, që afshi i thirrjeve të buta
të lëvizë pluhurin e hijeve dhe lotët t'i fshijë me hënë;
dielli që hap sytë e të gjallëve mendimet e trishta largon
ja udha e vilave dhe vajzat që janë futur në ujë
njëqind duar po të kisha, të njëqindëta për to i kam
magjia e jetës dy buzë dhe këllqet e rënda nga toka
lëroj nëpër to farën e njerëzve, jam bujk i mirë
lëroj nëpër muzg për të parë më vonë diellin, një njeri.

* * *

Ja shpirti i Hamletit u ngrit mes dunave Daneze
dhe erdhi rish këtu tek kënd i varreve të qeta
ku zhurma kryeneçe e lumturisë mezi vjen
e krahët nderi lehtë përmes pasionesh dualiste.
As roje, as Horac nuk pa në botën e përgjumur
përveç kandilit tim që e lëkunda si fener…

1980

* * *

Kaloi Elka shpejt vargan i viteve të vjetër
Dhe s'di se çfarë fati e shkuli barin në Shkumbin!
Ah, janë disa ligje ku zemra mbetet moj e heshtur
E mbetet dashuria si belbëzimi pa kuptim.

Ky është shorti ynë gjersa jetojmë edhe vdesim
Dhe gjersa dimë moj se dashuria është trill
Që s'mund të mbetet gjatë se me trishtim e mbush mëngjesi
Dhe dritën kalimtare me muzgjet që i hedh në prill.

Tani atje në breg ku jeta jonë ndezi zjarret
Ka rënë gjum'i thellë si mbi një dunë pa njeri
Dhe s'di ku shkuan sonte gjithë premtimet eoljane,
ku shkuan faqet, sytë e universit pa kufi.

E s'di ku fluturoi gëzimi yt i mrekullueshëm
Që ma tronditi gjatë ëndrrimin tim adoloshent
Edhe më ngriti lart, poet gazmor përmes ullishtës
Me puthjet e çuditshme që qeshin moj si shpirti tënd.

Elka, më mirë kështu që ikën kohët dhe na lanë
Sepse kujtimi yt, i pastër mbeti në lirikë,
Sepse kështu pastaj mëngjezi i dlirtë lind matanë
Dhe në mesnatën tonë mendimi qesh plot me bilbilë...

Kali që vrapon

1.
Një kalë vrapon në fushën e pamatë
ku shkon ai revan mbi yje dhe mbi natë?

Kotësitë heq përtej, zemërohet, hingëllin
sikur prehje nuk gjen në Shqipërinë time.

Ah, jepmëni ju harpën dhe nëpër erë tutje
të iki prapa kalit, të iki i pashpresë.

Të vdes në dhé të largët dhe kali me furi
të bredhë sipër meje si hije e atdheut.

Patkonjtë të nxjerrin xixa dhe pastaj rrufe
të kthehet prapë me harpën e thyer e të vjetër.

Kur do të bjerë kali i vdekur nëpër brigje
të zgjohet nëpër tela si ëndërr dhimbja ime!

2.
Vrapon një at i bardhë, vrapon, në shalë kot
sozia im që ikën në viset e përbotshme.

Qimet të ngrira, janë të ngrira krifa, frerët
dhe shala ja, lëviz nën trupin e drobitur.

Po shkon ai diku, me copërat e kitarës
me vajin që e bren në kockat e përzishme.

Ah, hidhmani kitarën gëzimin tim të vetëm
ah, hidhmani atë dhe lërmëni të fle.

Këtu në tokën time, te dheu i Shqipërisë,
të mbeten prapa telat që dhimbja i fashiti.

3.

Se ç'bredh një at i vetëm me yzengji të artë
i trishtë, i vetmuar rreth zemrën e planetit.

Rënkon lehona plakë dhe jelet e florinjta
ia puth me buzët valë të pesë kontinenteve.

Ku shkon ai mes yjesh, mes botërash të largëta,
gëzim ku shkon ai, i trishtë, i vetmuar?

Atje ka galaktika me kthetra të përbindshme
atje ka yje xhuxhë me dhëmbë të përzishëm.

Dori i zi i zjarrtë se sheh ti udhën tënde
që humb e tretet larg, nën astrat magjikë?

Ja frerët ju këputën dhe qimet e argjendta
zeniti ia mbuloi me pluhur qytetërimesh.

Kitara e lodhur

1.
Kitarën time të përbotshme
e vodhi hëna nëpër fushë.

Mbi jele ylli i mëngjesit
mbi jele kali e përhumbi.

Kitara ime s'ka më tela
akord tragjik i ikjes sime.

2.
Kitara ime nëpër rrepe
e varur çadrash cigane.

E qeshur ishte, e gëzuar
me push ariu e mbuluar.

Kërcenin vajzat me të vallen
kërcenin pleqtë me të vdekjen.

3.
Moj ti kitarë, moj kitarë
me shpirt cigani tutje rend.

E me kuajt të shoh sërish
e me dasmorët të shoh atje.

Jehona jote një çadëre

Etyd dite

I pasur është planeti ynë,
të pasur tokat dhe rrafshinat
e pasur koha me çelik, me ar,
asbest dhe minerale
e pasur toka e shpërndarë
në pesë gjethet e Adamit
vetëm njerëzimi është i varfër
në mirëkuptimin e përditshëm!

Ripërtëritje

Po plakem, pende korbi më mbulojnë
e asnjeri s'ma var si në rini
e bota ripërtërihet në netët e martesës.

Mësova ç'është fati dhe ligji i njeriut
që lind, jeton dhe vdes në hall
e vajzat ripërtërihen në netët e martesës.

E përsëri enigmë mbetet jeta ime
e përsëri në të kërkoj diçka
ndërsa fëmijët shtohen në netët e martesës.

Biondja

Midis mërzisë dhe kotësisë sime
në horizont u duke ti
biondeshë ruse e përhime
si një berjozë në veri.

Nga stepat, sukat e Peçorës
pushkiniani shpirt u ngjall
tek ti dhe vera ruse botën
e solli slitash me kuaj.

E solli diellin e trishtë
të Siberisë gjer këtu;
nën flokët biondë agu i rinisë
me pishat derdhi shpirtin blu.

Në tokën time mesdhetare
shkëlqeu si ylber hënor ajo
edhe u tret me slitat shtegtare
prapë në të zbehtin verior.

Erdha si Esenini

Atje ku eshtrat e Firdusit prehen
dhe ku Sadiu çeli Gjylistanin
Shagane moj si Esenini erdha
duke braktisur strehën dhe Ballkanin.

Duke braktisur gjumin e mërzisë
dhe limontinë tonë të pafund
ëndërrova gjatë vajzat e Persisë
në Babilonin që ha kum.

Ëndërrova sytë tuaj bukuroshe
dhe emrin e pavdekshëm Shagane
në mbrëmje fine kur Azia çlodhet
kërkova yllin e shkretëtirave.

Shagane moj, Shagane
Esenini lirika persiane ty të thuri
tani Ballkani erdhi nga zefiri
në sytë dhe në shpirtin e një burri.

Në gjumin tim të gjatë dhe të shkretë
ti vjen dhe fluturon si belbëzim
e mbeten pas jehonat Shagane
të shpirtit të Azisë plot trishtim.

Sykaltër moj

Sykaltër moj, sykaltër moj
që ke reflekse vere nëpër sy
me diellin shqiptar të krahasoj
dhe me gjineshtrat që i sheh aty.

Të krahasoj me verën bukuroshe
që botën e rilindi skaj më skaj
dhe nuk mendon për ujin që po soset
në pellgje dhe në gjire paskëtaj.

Që nuk mendon se plepi i lulëzuar
do zhvishet nga tetori në Shkumbin
se do të mbetet vera e harruar
nën shirat e janarit si kujtim.

Se do të mbeten pendët e bilbilit
si gjethet në herbarin fluoreshent;
ja, për të gjitha tutje ngrihet prilli
pas katër stinësh, diell me argjend.

Vargu im

Vargu im le të jetë
si një rrugë
herë me rima dhe herë pa to,
le të jetë vargu im
pa kryqëzime normash dhe postëblloqesh.
le të jetë vargu im
si një kodër dhe si një fushë,
si një femër që rri shtrirë,
si një luan në Serenget.

Le të ketë ai oksitone dhe hiperbola
por edhe liri të mirë
dhe të pamatshme ai të ketë
që malli i zemrës në të të jetë shkrirë
ashtu siç është, jo si fragment i keq.

Vargu im le të jetë
si një rrugë herë me rima e herë pa to.
le të jetë ai si bota me male dhe fjorde të begatshme
me ujëra dhe stuhi, me kafshë dhe laponë
me dallgë gratacielesh
por dhe me bambu të mira
le të jetë ai si bota, por jo si rrafsh fizik.

Le të jetë në të
ç'të ndjej në natën time,
ç'të ndjej në ditën time,
të qep në të pëllumbin
të qep në të diellin
të qep në të luadhin
të qep në të fëmijën
të qep në të makinën
të qep në të qiellin
të qep në të Kolombin
të qep në të Shqipërinë
të qep në të të ardhmen.
Vargu im le të jetë
si një rrugë herë me rima e herë, pa to
le të jetë vargu im pa kryqëzim normash
e postëblloqesh
le të jetë vargu im si një kodër dhe si një fushë
si një femër që rri shtrirë.
e zhveshur,
me të shoqin pranë……

Khajam i pavdekshëm

1.
Kënaqem unë shpesh në birraritë e pazarit
e gotën kthej me fund porsi Khajami i pavdekshëm
në djall i them kollares edhe qëndrimit prej zyrtari,
në djall i them lirikës që po dremit në sup të vjeshtës.

Këndon Xhon kokërrelbi nëpër mejhanen shamatore
e gotat rrëkëllen fyti i turmës si gjyryk
si gjithë poetët unë që nga Persia madhështore
me mall këndoj gëzimin e papërmbajtshëm që më mbyt.

Këndoj me mall rininë që fluturoi tutje hënës
e nëpër suka la vizione hijesh që nuk vijnë
këndoj unë pasionin që mijëra shekuj i dha femrës
shikimin e sorkadhes me kthetrat e hienës shkrirë.

Këndoj unë hapësirën e plotpushtetshme, yjet,
natën shtëpisë i këndoj që e vetmuar dikë pret,
ndërsa mbi podium për brengat, hallet qan cigankën
tenori i mejhanes me kokën rrasur në parket.

2.
Në mbrëmjet e qershorit kur kumria lë selvitë
e vjen te portokalli i zbukuruar me neon
qytetit tim të famshëm në oksident për birraritë
i bije unë me pash edhe këngët buza s'm'i pushon.

I bie unë me pash i turbulluar nga alkooli
që gjyshërit ma lanë si provë burri dje në jetë
I lumtur jam kështu se në zenit më çon idoli
i tmerrshëm i Bakusit që gjithë brengat m'i kthen fletë.

M'i kthen ai në këngë mendimet, shpresat pa përgjigje
trishtimin tim gazmor që nuk m'u nda si mik bonjak
megjithëse thotë fjalë e sharje, unë nuk tërhiqem
por me hashash alkooli e zgjoj gëzimin pranverak.

E zgjoj unë hapësirën që digjet thellë nëpër inde
me mallin pa rrugëdalje dhe dashurinë që m'u tret
dhe si prelud magjik nga përrallat, portat, yjet, qipshtet
sërishmi Desdemona orientale diç më flet.

Lira

Vala, valën tutje ndjek
rrotull në anije
marinarë s'ka në të
vetëm tym e hije.

As emblema nuk dallon
mbi direk e varur
por anija detesh shkon
si truk magjistarësh.

Veç një lirë mbi të rri
e çuditshme duket
kur bërtet dhe s'gjen qetësi
kur këndon tajfunet.

Asnjë gjë në të s'iëviz
vetëm er' e botës
si magji mbi tela grish
shpirtra misterioze.

Sfinksi i vdekshëm

Kur ty të dashuroj më duket vetja i përjetshëm
si sfinks i madh shqiptar me rrënjët deri në thellësi
ndaj më habit mendimi kur ti më flet se jam i vdekshëm
kokrrizë lëngimtare me egoizmin si njeri.

Si gurët, si selvitë, si malet them se jam i ngjizur
të kundërshtoj këtu ty gjuhë helmi plot sheqer
megjithëse si cigankat ma sheh moj fatin herë-herë.

Unë jam i përforcuar me aq sa mundem, me rininë
dhe s'dua të mendoj se stalagmitet kam përbri
si prometeu zjarrin e dashurisë vjedh tek ti.

E di që ke të drejtë, por turbullimi im i tmerrshëm
nuk do ta shohë sot atë që është ligj fatal
tronditem, ofshaj, rënkoj nga postulatet dhe i etshëm
përkulem tek ti femër si rebelim që s'njeh moral.

Lejleku ylber

Ja iku dhe një ylber i bukur, lejleku shtegtar
ku do ta mbjellë vallë trishtimin e Shefkiut shqiptar?

Një mijë bebe

Ky është qyteti me një mijë bebe
Ky është qyteti me një mijë gojë
Ky është qyteti me një mijë shprehje.

E njoh këtë qytet të ngurtë nga betoni
e njoh këtë qytet të butë të dashurisë
e njoh këtë qytet të bardhë e të zi.

Para rrugës sime, një mijë rrugë të tjera
para dritares sime, një mijë dritare shoh
para mendimit tim, një mijë mendime të tjera.

Rri e sodis jetën që lind dhe mbaron frymën
rri e sodis dashurinë që lind një botë të re
rri e sodis vdekjen që lind nga dashuritë….

Nados

Fluturuan patat në Azi të lodhura
dhe mbi ne lëshuan klithma një natë
malli i tyre u gjymtua si terri në kodra
mbeti nëpër dritat e Tiranës si alarm i artë.

Mbeti ai nëpër dritaret e Nados sime
dritare njerëzore sigurisht janë ato
po antinjerëzorja jetë i mërgon mendimet
tok me patat në Azi pa i kthyer dot.

Po të fluturoje dhe ti si patat e shkreta
s'di çfarë dhimbje do të provoje në shpirt
megjithëse edhe ne mërgohemi nga jeta
siç mërgohen patat në një kontinent të ri.

Edhe ne mërgohemi ngadalë nga qyteti
nga sheshet madhështore hoteli vigan
po ky është asgjësimi më i pamëshirshëm i njerëzve
që tej marrëzisë na shtyn si patat në tufan.

Po ky është asgjësimi më i thellë Nado
që as unë as ti s'kemi të drejtë ta kthejmë
vetëm të pikëllohemi mundet nëpër lulishte
ndërsa patat drejt Azisë më të pikëlluara venë.

Jam

Jam harmonia e ngjyrave
dhe e dashurisë;
jam alfa e gëzimit dhe kaltërsia e verës,
jam një pjesë në fjalën e dashurisë,
një lule në tryezën e bukës…
një libër i hapur në moshën e rinisë.

Këngëtari i reve

Jam këngëtari i fundit i reve,
unë barin në vend kollares var
dhe në xhep kam çekun e hënës
të cilin asnjë bankë s'e thyen pastaj.

Unë jam më i pasur se Rokfeleri
me diell dhe gjethe gjer në mish
dhe në xhep kam çekun e hënës
të cilin asnjë bankë nuk e thith.

Pasurinë time mateni me vjeshtë
dhe trishtimin vareni si motor
dhe në xhep kam çekun e hënës
të cilin asnjë bankë s'e thyen, jo.

Më i pasur se të gjithë shtetet e botës
me gëzimin dhe lotët e natyrës jam
dhe në xhep kam çekun e hënës
të cilin asnjë bankë s'e kthen para…

Shekulli XX

Shekulli XX
po na i shtrydh mendimet
si rrobat lavatriçja
kullojnë mendimet lart e poshtë
e mbushen libra
rrugë
qytete
vargje
vrasje
krime
mendimet e larmishme
mendimet që varen në çdo X
që shiten blihen lirshëm…
mendimet Demokrite.

* * *

Mbetën dhe shumë ditë
për të thënë
fjalën time,
mbetën dhe shumë fjalë
me kyç në buzë,
mbetën dhe shumë netë
hënë e mbështjellë me re
me fletë
rrugë e pa rrugë me terr në sy

dritare me doreza të ulura
si shpatë
ëndrra me këmbë
të lidhura
më kot
mbetën dhe shumë ditë
për të thënë fundin
ose vdekjen
për të ç'lidhur kalin që kam në kokë
erën që kam në shpirt
për të thënë atë që e pashë
ose që s'kam parë
për të thënë e dashur, zemër
për të thënë goja u kyç
për të thënë s'kam më hall si Tantali
gjak si Prometeu
në gjoks
për të thënë ULTIMA RACIO!...

* * *

Erdha e dashur
i lodhur nga një ditë e gjatë
dhe ushqim i keq
dita me të vërtetë
qenka
e gjatë
urbanët mbartin mbrëmjen
me ankthin në kokë
në dritare shoh peizazhin e qytetit
të qullur me lot

vjeshta më ka stolisur me gjak
hemoglobine
në mall
vjeshta si ti hyn e lodhur
me makinat e rrushit
mbyll peizazhin
e vrarë
ajo si ti vjen në dhomë
me fundin e lagur me kërmëz
e tym
se ti pi kafenë
në kafenenë e shkretë
me fytyrën e bardhë si re pa lëng
me këmbët e qullura me shi koloidal
se ti më puth me dimër
dhe këpucët i vë në holl
si ti s'fle e zbehtë
me hënën mbi këmishën
e grisur në sup
dhe gërhet lehtë
për të riparë në ëndërr Eldoradon
për të riparë
ballot madhështore
qytete vigane…

* * *

Ra dhe qyteti në gjumë,
gjumë somnambulësh është ai
shpirti i tij i shumëfishtë
hesht

si kambanë bronzi
gjiganteske
që është gati
të tingëllojë
posa mëngjesi
të ndezë
qirinjtë.

II
NGA LIBRI “TORAKS”



Shefki, Shefki, lejlekët thirrën fort
Tek ikin nëpër tokat e Nadirit…

Shefki, Shefki, thirrën gjethet ar
Që ranë nëpër sukat e Shkumbinit…

Shefki, Shefki, rënkon një kumri
Që do të qëndrojë në atdhe...

* * *

Adile, Adile

1

Adile, Adile
Thërras nënën time muzikalisht
Dhe
Çdo herë zëri më kthehet
Lule, Lule…
Eh nëna ime që së fundmi
Kish nisur t'i bënte si me ngut
Ato punërat e përditshme të shtëpisë
A thua se e prisnin fshehtësisht
Përjashta n'oborr
Për tu nisur diku larg…
Eh larg për diku,
Për çudi
Sillej dukshëm si vajzë
Fare e re
Me atë mall, me atë mall

Siç dukej
Dëshironte te ikte
Pa u ndjerë
Dhe qetësisht
Siç ikën dita...

2

Apo ime më e natyrshmja
Që ligjëronte rrjedhshëm
E përkushtuar

Krijim oral
A thua se fjalët i zbrisnin
Nga Qielli
Si vargjet e librit të shenjtë

3

Mbillte Iule ajo
Dhe ta dini
Në mes ngjyrave dhe pafajsisë

Dhe frymës plot aromë te tyre
Shënjtërohesh lehtësisht
Sepse mbjell njëherësh
Paqe dhe mirësi

Eh ç' dialog me lulet
Eh ç'gjuhë perëndie
Por se mëson dot
Duhet të lindësh me të

4

Kështu Adileja
Nëna ime
Tek e ndiqja i heshtur
M'i përziente koklavitshëm
Mësimet e shkencës
Me ato të ndaluarat
Mësimet e fesë

Poetja e vyer plot hire
Si edhe luleve
Mes përkundjesh na rrëfente
Përralla të përndezura Ballkanike
Përherë me të papritura dhe befasi
Dhe mbyllje standarde
Moralizuese

Vëllezërit Grim
Kur iu lexova
Eh thashë i sigurt dhe i drejtë

S’e keni mbërritur dot
Në rrëfime
Nënën time
Adilenë

Në vargje të bardhë
Ligjëronte ajo
Në vargje të çlirët dhe të shpenguar
Epokës së poezisë i përkiste
Prozën s’e njihte

5

Dëgjomëni
Për çdo Iule
Dinte një gojëdhënë më vete
Lirike dhe prekëse
A thua se bëhej fjalë
Për fatin e një vajze
Ne të vegjëlve
Na këputej shpirti
Por edhe mbylljet e gojëdhënave
Të njëllojta ishin
Përkëdhelini lulet porosiste
Hatërmbetura
Varin kryet

Eh nëna ime poete
Adile
Sot tek buzëqesh gëzueshëm
Seriozisht shitësve të luleve
Do t’iu jepja një këshillë

Të dobishme
Nga ato tç tuat
Në vend të instruksioneve të thatë
Për mirërritjen e luleve
Në çdo saksi të vendosnin
Dashuri pafund

6

Lulebora ka shtatë ngjyra
Sepse shtatë duhet të jenë
Siç janë edhe shtatë Qiej
Gjer te lumturia dhe amshimi
Siç janë edhe ylberet
Shtatëngjyrësh
Siç është edhe java
Shtatëditëshe, shtatëngjyrëshe
Me të hënën
Gjer tek e diela prehëse
Siç janë shtatë
Edhe tingujt e papërsëritshëm
Që lëshojnë qeniet tona
Eh siç janë edhe të shtatat
E shpirtërimit t'atij që ikën

7

Borë e brustë
Kur merr qiellin
E brustë edhe lulebora
Borë rozë si perëndim
Rozë dhe lulebora
Si vetë bora

Borë ngjyrëvjollcë
Mu si ajo reja mbi ujëra
Ngjyrëvjollcë dhe lulebora
Borë e bardhë si mëngjesi
E bardhë lulebora
Kur duhet të jetë e bardhë

Adile Adile
Ku je….

Nadires

Në vendin tim të artë ku era luan me kajsitë
dhe vala e Shkumbinit përplas jehonën e planetit
ti solle erën çame o bukuroshe e magjishme
gëzimet misterioze të një atdheu të braktisur…
Në halle edhe luftra kaloi jeta e babait.
për tokën, ujin, gruan dhe irritimet e vendlindjes
gjithnjë me pushkë pas, gjithnjë në shtegëtime
mes netëve nomade dhe lebetive të armikut
diku atje në jug në Paramthinë e lirishme
ku toka zbret në det me valë bari magjiplotë
të vrara anekënd përgjumen eshtra gjyshërore
me plumbat ende thellë si hajmalira egërsije.
Në agun e qershorit kur kumuria luan fikun,
nën qiellin shqiptar të zbukuruar me plejada
ti frymën tënde zjarr më hedh në zemër si kometë
e fjalët si jehonë ndër dete malli përpëliten;
ç'të bëj ty bukuroshe, me çfarë dielli ta heq
trishtimin tënd të kotë që më tundon si verë jete.

Se këngët çamërishte po zhduken, ikin dalëngadalë
e veç në rite vdekje ripërsëriten vit pas viti,
se mbeti larg vendlindja nëpër vërshimet e kolonëve
e emrat e stërlashtë një fis i huaj i përbuz,
e plugu prish varreza, kasolle, stane gjithë gëzim
nën etjen pushtetplotë të marrëzive njërëzore.

Por plagët thahen shpejt se kohët ikin me vërtik
e mbyll trishtimet, hallet e çdo njeriu me durim
po treten blesfamitë e ekspeditave të Zervës
e gjakun mercenar një shi mendimesh sot e zbut.

Ti rro në vendin tim nomede motër e një fisi
që koha e stërlashtë dikur i ndau me kufij
nën netët e qershorit kur quku luan dhe brengoset
ti qesh e qan gjithnjë në supin tim si frymë vere.

Shtojzavallet e Shkumbinit

Dorian, shpirt

Dorian shpirt,
sa i vogël je biri im
botë delikate tingujsh qelizash;
duar transparente indesh,
gojë pa fjalë, sy pa natë
sa i vogël je biri im!
dielli që vjen
qepallat përpëlit ne shtratin tënd
dhe hëna që shkon
ngadalë perdet tund
dallëndyshja udhëtare
mendon për ty kur ikën në Afrikë.

ALBANËS

I njejti ajër, i njejti det bukuroshja ime,
Të njejtat re sjellin shi në Breshia dhe Tiranë,
I njejti postier me të njejtën veshje
Sy, këmbë, qillota
Parakalon ngutshëm shtëpi
Po të njejta
Dhe po të njejtën zemër mbush përkohësisht me mall…

Megjithatë bija ime
Edhe pse në të njetën botë,
Edhe pse deti, ajri, drurët, zogjtë
Kanë të njejtit at
Po të kisha krahë të fluturja gjer tek ti
S'do të më ndalnin portet, avionët, ambasadat, pabesitë
Dhe do t'ju thoja bija ime
Se vij nga një dhé alienësh krahëzjarrtë
Dhe nga një det sterrë
Ku notojnë përbindësha ballkanikë gri
Nga një qytet me shtëpi termitesh..
Dhe do të më kthenin pas si katapultë
Duke më thënë se deti s'është njësoj
Dashuritë, sytë, pendët, fluturimi qiellor.

Ah bija ime,
Rrëzëllim i një çasti magjik,

Mallin tani e kam veshur me po ato drurë
Që më tregon çdo ditë ti
Po me ato zogj savoje përrallorë
Po me atë stil drurësh paviezë të kuq
Po me ato uniforma romake gri
Po me ato mjellma të verdha të lumit
Po
Për të parakaluar lirisht
Gjithë ato kurthe urrejtjesh
Marrëzish pa fund
Për të parakaluar të njejtin ajër
Që thith ti….

Në revistën “Ylli’

Dritë dhe hije që zgjaten
Jashtë redaksisë “Ylli”
Por vallë ku është Ajo
Ashtu me flokët e mbledhur
Dhe dekolte të lëshuar?!
Në plazhet farfuritës
Apo te kopshtet e vendlindjes
Ah do të dal të freskohem.



Rruga e Revistës “Ylli”

* * *

Ar vjeshte derdhet flu
Tej dritares sime
Ah do të dal në rrugë
Të kap një makinë çfarëdo
Që të mbërrij në vendlindje
Atje, atje te shtëpi' e fëmijërisë
Do të shoh lejlekët në ikje.

* * *

Degë gri si kriptograme
Në sfond të reve
Pas dritares sime
Vjershat që ua lexova shokëve
Më mallëngjyen dridhshëm
Te kafeneja letrare do të hidhem
Të rrekëllej një fërnet
Dhe do ta mbys trishtimin.

* * *

Ç'shend e ç'diell
Tej dritares së redaksisë
Ah s'rri dot brenda
Ndaj jashtë do të lëshohem
Drejt kafenesë letrare
Atje te tryezat mbi bar
Për dashurinë do të flasim
Dhe për pranverën...

* * *

Nata se ç'më zuri midis fushës
Unë rashë në gjumë nën mullar
Në agim më zgjoi vrap i shkurtës
Në nxitim të largët shtegëtar.

Oh u zgjova, Viset para meje
Si nga ëndrrat dilnin një nga një
Unë ndjeva duke fjetur
Ti sikur më puthe mëmëdhe.

Kumri e Elbasanit



* * *

Si ti kumri jam një pjesë e botës,
si ti fluturoj dhe vuaj si ti,
mbi shpirtrat tanë evolucioni i bizonëve.

Unë nuk këndoj mëngjesesh të trishtuar
por këngës së fatit të ngrysur ia them
midis këngëve tona Demodoku si ti u zgjua.

Ndonjë natë si ti do të prehem midis reve
tymnajë e një shorti pa mundur të bëj gjësend
pas natës së zogjve Hekata prish fatet e njerëzve.

Çdo të mbetet pas nesh, ndonjë degë kumbulle
ditët do t'i thërrasë si jehonë e një shpirti efemer
pas mendimesh trishtare kobi i kumrive dyndet.

S'qenka gjë, as njeri, as zog në këtë jetë
përsëri diçka e përbashkët na thërret diku
bizonët në qoftë se vdesin pupla kumrish kanë mbi
brirë.

* * *

Shkumbini është për mua Zambezi, Sena, Misisipi
për mua ai është Amazona plot ullij në shpirt
për mua ai vlen sa zemra e etur
sa endrra e brishtë;
për mua ai vlen sa rrokaqiejt q'u ngritën mbi xhungël
ai zëvendëson pasuritë, arin, diamantet
ai zëvendëson aeroportet plot shira manjetikë
për mua ai vlen sa era që flë ndër dritare
dhe hëna që pyllit qesh…
ai për mua është emri i parë dhe emri i fundit
që do të mbetet si far,
far arkaik….

Paqe

Ra dhe paqja e kësaj mbrëmjeje tokësore
paqja e shtëpive dhe e dashurisë së thjeshtë.

Mbi qytet u ngrit hëna flori si reklamë
apo si emblemë e gjumit qiellor.

Rrugët janë mbyllur nga ndriçimi i qetë
në lokale veç pijetarët krikllat i zbrazin tmerr.

Janë të gëzuar ushtarët e bindur të paqes
gjaku i mushtit u kthehet në dolli…

Po të isha dhe unë në tavernën e tyre
Kajamin do ta quaja poetin më paqësor.

Taksitë që gjithë ditën lëvizën dashuritë
natën mendojnë fatin e çifteve të dehur.

Shoferët, robërit e rrugëve të kaltra
tani në shtretër rrugët e jetës vazhdojnë….

Nëpunësit, më të urtit qepallat kanë fikur
mbylli dhe ti qytet, paqe, natën e mirë.

* * *

Larg atje në Tanganikë
një kallam shqiptar ka mbirë.

Pushi afrikan ia djeg
mishin thekët e brengosur.

Në savanë i vetëm tundet
bir e bija s'mund të japë.

Një kallame femër s'ka
anekënd për të Afrika.

Ku je dhé i vjetër dertesh
psherëtim Shkumbini larg.

* * *

Dua të them
një fjalë për vendlindjen time;
dua të them si Neruda: të dua Shkumbin!
dua të them se rruga e shtëpisë
kalon më parë në zemër dhe në sy;
dua të them se treni që kapton kodrat e Paprit
kalon më parë në zemër dhe dëshirë;
dua të them se shtëpia ku kam lindur fatsjellës
kalon më parë në dhimbje dhe mërzi;
dua të them se kalëron një udhë plakë si Pindari
për të mbledhur gurët kockëfortë të amësisë
dhe se një kupë helmi në të

më e vyer mbetet se një pjatë mjalti në Floridë
dhe se karafilët e bruztë
më trumbullues janë se manjolat në Afrikë
se gjuha e njerëzve
buron nga fëminia dhe vete në varr
se më parë se të them fjalën BOTË
them më parë fjalën ATDHE
dhe më parë se të them fjalën ATDHE
them më parë fjalën SHTËPI
dhe më parë se të them fjalën SHTËPI
emrin NËNË
belbëzoj…..

* * *

Këndo vajzë e huaj këngët e Elbasanit tim të bukur,
zëri yt i mbuluar me diell shkretëtirash zbret pastaj
kuaj të shpejtë ngrenë vrundullimin e Asirisë në krah
dhe hijen e një qiparisi lindor koka ime mbi qiell
bën hije gjersa të shuhen horizontet nga era.

Këndo këngëtare diellin e trishtë të shpirtit të vjetër
që s'di se ç'kërkon dhe kë qan më tepër si truk
i trubullt malli pështjell herë një vajzë, herë një hënë
gjersa vjen në formën e një risku misterioz tek unë
zëra misteriozë qajnë e qeshin si ullijtë vazhdimisht.

* * *

U shemb shtëpia ime
në agun e një vjeshte.

Mbi gjerdhe fluturuan
lejlekët si një brengë.
Shtëpia e poetit
me njëqindmijë dritare.

Shtëpia e lindjes

* * *

Sa të dua nënë, tokë e butë fjalësh
sa të dua nënë
zemër zogu
që nuk kthehesh më,
përpëlitje hëne në gjumë
këngë mjelme e brishtë,
emër i butë njerëzish
krah fluturak bengu

zë vjeshte në kopështin me fiq
erë zymbylësh me mengjesin e qytetit hipokrit
re dimri për borë….

* * *

Venitet vera, kupa soset shpejt
e mbetet para vera që do pijmë.

Mbi flokë bora ra dhe zbardhi kohët
për të shkurtuar rrugët, ikën patat.

E mbetën pas kallamet e atdheut
relike simbolike të së ardhmes.

Katarti im valo valo dhe pak
e ëmbël vera, kupa s'rri e zbrasur.

Por fati verbërisht më shtyn diku
i akullt, ligjet zemrës nuk ja do.

* * *

Atdheu-kompleks i botës foshnjarake
i femrave që dua në netët e vendlindjes
bisedat, zërat, fjalët mbi njerëzit edhe botrat
i luleve të thjeshta mbi varret ordinere
të gjithë, ah të gjithë nën trajta lumturije
shtëpia atërore e veshur krejt me kulpër
dhe udhëzat e kopështit nën tisin e lirisë
realja, irealja, fantazmat, vdekjet, makthet
dhe ditët madhështore të festave magjike
ajo që ne fshehim mes netësh, dridhjet ëndrrat

qëllimi poetik i veprave humane
dhe lotët nënoçkës në festat luftarake
kur dhimbja s'mund ta zbehë gëzimin e atdheut
O zog në këmbë rri në telat uturonjëse
me pupla si tantellë dhe pret të vijë dimri
për të vrapuar tutje në toka diellore
por jo nëpër hapsirë në vendin tim të dashur
Çivit dhe ngrihet lart mbi udhët qytetare
këndon instikti, s'mund ta mposhtë brengën jo
sepse ti centaur dy herë pikëllohesh,
një palmë dhe ulli emblemë ke mbi fletë;
Jo s'dua që ta ndaj më dysh përmalljen time
nën netët e qershorit kur hëna shqiptare
nga gruri del të zbehë gëzimet e diellit;
vjen era baltë dhe një tym amtar vertitet
mbi fatet e qytetit, pjejadat qiellore
i lumtur jam kur shkoj mes zallit të darkohem
mes shelgjesh, Belebesë, me yjet në retinë
të flë por jo të jem një buf pa shpirt dhe ëndrra
me gjakun zjarr të nxehtë të gjitha t'i pushtoj
nën tymin e shtëpisë-tabu i vjetër dhimbjesh.

* * *

Lejlekët, ja po vijnë nga dunat, palmat e Sirisë
si shpirti im i shkretë që s'gjen as prehje as qetësi
me diellin në buzë gjineshtra qeshi pas shtëpisë

E nga Qabe e nxehtë lejlekët erdhën nëpër plepa
mbi lumin tim të madh nëpër shelgjishte në Shkumbin
jehona e tyre tej rininë solli si nga ëndrrat.

IV

KRITIKA LETRARE PËR VEPRËN E SHEFKI KARADAKUT

LIRIKA POLISEMANTIKE E SHEFKI KARADAKUT

Moikom Zeqo, *Shkrimtar & studiues*

Libri "Feniks" përmbledh ditarët e tij intimë poetikë (vitet 1972-1985).

Poeti Shefki Karadaku, i njohur në vitet '60 si një talent i vërtetë lirik, të kujtonte një Esenin shqiptar të ndrojtur, tepër modest, me trillet origjinale të imazheve të vendlindjes së tij. Lirika e tij imazhiniste qe e ngrohtë, plot ndjesi fusharake, me një romantikë të pranueshme, po me arketipë figurash popullore. Më pas, emri i poetit sikur u vyshk. Tepër rrallë duket në shtyp, s'përmendet gati fare nga kritikët, të cilët si dje ashtu edhe sot s'e kanë kuptuar kurrë atë. Duke botuar librin "Feniks", Shefki Karadaku na paraqet sfidën dhe emblemën e vet krijuese. Ky libër është pothuaj tërë poezia e tij e veçantë dhe vetjake. Ky libër nuk ka rëndësi për vetë krijuesin por edhe për poezinë e sotme shqipe. Shefkiu është një poet nga të spikaturit në lirikën shqiptare. Kjo gjë është e thjeshtë për t'u deklaruar, por, para së gjithash, duhet kuptuar në thelb, në gjenezë, në modusin krijues.

Libri i tij është një libër interesant si tërë librat e vërtetë, larg bujës propagandistike dhe reklamave recensuese. Por ky

libër i shpëton anonimatit dhe mediokritetit krijues me një siguri të madhe, që çembrionizohet nga arti dhe fuqia e fjalës poetike. Me vargje të sforcuara, po edhe të lira, Karadaku shtjellon ide të ankthit ekzistencial, të ndjenjave primordiale të njeriut adresuar në koordinata të vendlindjes dhe njëkohësisht të krejt universit.

Identiteti i poetit është ai i një njeriu duplex, që jeton dy jetë, po jo dy fytyra, që nuk e pranon realitetin e jashtëm për të afirmuar realitetin e brendshëm, që kërkon dimensionin e katërt të shpirtrave poetike, ngaqë tre dimensionet e tjera e gurëzojnë. Kështu, poeti thotë se "ndërtoj në erë planetin tim pa emërtim" se "kalin e shpresës e lashë te Karonti" se "sytë vjedhin kohën dhe vdekjen për të ushqyer eliksirin". Të gjitha fantazitë e tij onirike janë të personalizuara me simbolin etern të Elbasanit "qytetit provincial me shegë". I habitshëm është ndikimi i Uitmanit tek enumeracioni poetik i Shefkiut, për të inventarizuar imazhet e zemrës që s'vdes, për të bërë një sistem të përqasjes dhe mimesit botëror, të jetës dhe të vdekjes, të sendeve dhe të njeriut. Kështu, ad hoc, Karadaku universalizon kontrastet e dashurisë me urrejtjen, të besimit zarathustrian të luftës të së mirës kundër të keqes, të ngritur mbi fatalizmin dhe plogështinë konformiste. Ai pyet:

Ku fillon njeriu i shekullit XX dhe ku bisha e terciarit të madh?

Në këto dy vargje vërtiten dilemat, kërkimet shpirtërore, anatemat ndaj poshtërsisë, dobësitë njerëzore, vektorët e Bukurisë së gjithëpranishme, që nga krijimi i botës dhe alternuar deri në ditët e sotme nga tjetërsimet antinjerëzore të koncepteve totalitare politike, të kodeve stilistikorë e programeve të gatshme të artit. Një vizualizëm i shqetësuar, një trishtim i ndritshëm dhe rebel, një ndjesi pikëlluese po

jo si pozë imituese, një dashuri e idealizuar parnasiane e lasgushjane, por, me përbërës vetjakë. Sinkopizmi i gjuhës dhe eliptizmi i lokucioneve poetike e bëjnë poezinë e Karadakut një krijim krejt të lirë dhe të komunikueshëm, plot jehona të brendshme. Për të formulimi boracian "ut pictura poesis" gjen një sendërtim të strukturave të mendimit dhe të ndjenjës. Një panteizëm i vetëkuptueshëm e çon në impresionizëm figurativ të një "spiritus mundi", me fonema poetike të gjalla, për të metaforizuar vetveten në vargun e gjithëkuptimshëm "jam sahat i vjetër i mendimit". Tej komplikimeve të panevojshme, Karadaku nuk parapëlqen moskuptimin ekzoterik, por kuptimin e thellë dhe indepërhapës. Ritmi melodik i vargjeve është një kontrapunkt logjik dhe spontan i shqetësimit, një veçori lirike. Poeti e zotëron mjeshërinë pa qenë një ortodoks figurativ, po lirshëm dhe gjithmonë krejt intim bën ritmin e magjistarit që nuk trukon imazhet e rrema. Duke qenë një shok e mik i vjetër i Shefkiut e kam njohur përherë në vite krijimtarinë e tij të pabotuar. Kam besuar dhe e kam pritur librin e tij të jetës. Tashmë ky libër është botuar dhe do të gjykohet.

Duke shkruar këto rreshta, s'di pse më kujtohet poezia doktrinare "Bizanti" e poetit gjenial anglez Jets. Figura e Jetsit, sa larg njëra-tjetrës, kanë çuditërisht një rend të përbashkët të njëjtë. Kështu edhe lirikat e Shefki Karadakut bëjnë një tërësi, duke ruajtur një autonomi të dukshme të çdo fragmenti, ose njësie të veçantë. Ka në librin "Feniks" diçka nga simbolet e Bizantit dhe të sagave ballkanike në impaktin e tyre me kulturën perëndimore. Rravgimet drejt një të ardhmeje të ëndërruar janë jo vetëm simbole mendore, po edhe përjetime të pashmangshme, plot shpresë jetike.

Gazeta "Drita", 30 janar 1994

IDENTITETI SI KATARZË

Dr. Lutfi Turkeshi *Gazetar, studiues*



Pas shumë shekujsh, kur rebeli pasardhës do të tundë prapë selvinë, që e preku (vite më parë) me diç të "hekurt". Si me turp do ta shoh se rreth saj do të mbijnë bota, sisteme, grushte shteti, piramida... Martesa njerëzish dhe qivure. Është ky mesazhi poetik i Khajamit të ditëve tona, poetit Shefki Karadaku, i cili me mëse 20 vepra në prozë dhe poezi amësoi në hapësirat e demokracisë letrare... Në romanet "Puthja e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panagjerikus" e të tjerë dhe vëllimet poetike "Kënga e korrave të drithit", "Melodi të Shkumbinit", "Ylberi". "Lumi me njëqind zemra" dhe "Feniks", poeti e shkrimtari Shefki Karadaku asnjëherë nuk do t'i nënshtrohet jetës edhe pse e vuan atë... Dhe, duke mos aluduar në përmbysje biblike, synon t'i ndriçojë të errëtat e një sistemi jo perms kthesave shpirtërore, por përmes konstatimit "pesimist" se të gjithë elementet janë më të rremë se ëndrra dhe thekson se vdekja është mbi të gjitha e nuk pyet

hierarki ose ndonjë formë "makijazhi", ndaj neveria, njeriut ia ul moralin nga përsosmëria, kur bëhet fjalë për vdekjen nga e cila edhe thelbi i jetës bashkëkohore dridhet... kur midis hidhërimit dhe gëzimit hija është ekuivoke, prandaj poeti e di se qerrja që na tërheq dhe fjalët pa testament në largësitë e zymta të përditshmërisë, ikin tej dhimbjes njerëzore. Këto mirazhe shpirti, që ikin me ëndrrat si një gënjeshtër tej, mes pikëllimit të paanë – janë sofrat njerëzore me kanune dhe karrare: "Bukë, kripë e zemër"! Larg tryezave dionisiane me "mish, verë e raki dhe net gri të orgjive...". Janë çaste të fateve të grisura jo me gjumë somnabulash të poetit, por me një misticizëm të shprehur që ngjall emocione të një përkushtimi të vulosur, aludon në bindjen se çdo gjë përsëritet. Mbase edhe poezia e tij do ta ndiejë këtë rrezatim ndjesor... Feniksi është, pra fryt i imagjinatës së poetit që sugjeron ndjenjë të një thellësie ekzistencialiste të paqartë, por të tejdukshme në jetë, që në amplitudën figurative nuk është feniksi që zgjohet nga hiri i detyruar si shpirt i freskët i një loje të gëzuar kozmike, as ndonjë stuhi kohore që kërkon t'i hedhë tutje nga pellgu i qetë mendimet flijetare dhe t'i kthejë sërish në një ind përimtimi artistik, por një dridhje që "hap plagët e kohës", të shprehura në çast, stinë, vite dhe dekada, të tradhëtuara nga forca e vet.

Kështu nis kalvarin e mundimshëm të shprehur në linjat plot tension me motive dhe dritë, bardi nazik i fjalës së shkruar-poetike, esteti i shprehjeve kuptimore Shefki Karadaku. Ai shpesh nuk ndalet në fusha as edhe në lugina për admirime idilike. Mbase ato janë si rrjedhojë e barrës "së mëkateve" të servijuara nga syri poetik "sepse" ai e shikon edhe kohën përmes katarsisit ose lavazhit shpirtëror që s'e arrijnë kohën e vet. Megjithatë ca rreze optimiste amësojnë në botën dhe vizionin e mjeshtrit artistik, i cili në "errësirë" ndez qirinjtë e

shpresës.

Leximi i veprës letrare artistike është një fenomen që manifestohet në mënyrë të ndryshme te secili individ, madje në mënyrë të ndryshme edhe tek i njëjti person me rastin e rileximit të së njëjtës vepër në intervale të ndryshme kohore, veçanërisht kur kjo vepër është poezi refleksive me plot rava asociative që e lëvizin çdo hije simbolike të filozofimit dhe tjetërsimit shpirtëror. E tillë është edhe përmbledhja filozofike "Feniks" e Shefki Karadakut. Gjatë çdo rileximi nxjerr diç të re...

E enjte, 8 mars 2001 — Kulturë — FAKTI 15

VËSHTRIM

Identiteti si katarzë

(Libri lirik "Feniks" i Shefki Karadakut-botoi "Globi"-Tiranë)

Pas shumë shekujsh, kur rebelë pasardhës do të tundë prapa selvinë, që e preku (vite më parë) me diç të "bekuri", si me tym do ta shohë se treti saj do të mbijnë botëra, sisteme, grushte shteti, piramida...Martesa njerzish dhe qivane. Është ky nasualthi poetik i Khajamit të dhëtve tona, poeti Sherki Karadaku, i till me mbse 20 vepra në prozë dhe poezi amëson në hapësirat e demokracisë letrare...Në romanet "Pulha e ngrirë", "Njëmijë vjet dashuri", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panagjerikua" e të tjerë dhe vëllimet poetike "Kënga e korrave të drithit", "Melodi të Shkumbinit", "Yllteri", "Lumi me njëqind zemra" dhe "Feniks" poeti e shkrirntari Shefki Karadaku aanjiheret nuk do t'i mbushtroher ietës edhe pse e vuan ate...Dhe duke mos aludtar në përmbysje bibilike synon t'i ndricojë të errëtat e njit sistemi jo përmes kthesave shpirtërore, por përmes konstatimit "pesimist" se të gjithë elementet janë më të mirnë se ëndërra dhe thekson se vdekja është mbi të gjitha e mak pyet hierarki ose ndonjë formë "makiatvi", ndaj neveria, njeriut ta ul moralin nga përsosmëria, kur bëhet fjalë për vdekjen nga e ella edhe thelbi I ietës bashkëkohore drithet...Kur mëdis hidhërimit dhe gëzimit hija është ekuivoke, prandaj poeti e di se gerrja që na mbrlhoj dhe fjalët pa testament në largësitë e zymta të përditshmërisë, ikin tej dhimbjes njerizore. Këto mirazhe shpirti, që ikin me ëndërrat si një gënjeshtër tej, mes pikëllimit të pa anëjanë sofrat njeriizore me kanune dhe karrare: "Bukë, kripë e zemër"! Larg tryezave dionisiane me "mish, verë e raki dhe nuné gri të orgjive...". Janë çaste të fateve të grisura jo me gjumë somnabulizëm të poetit, por me një mistic.idem të shprehur që sado që ngjall emocion të një përkushtimi të vulosur, aludon më bindjen se çdo gjë përsëritet. Mbase edhe poezia e tij do ta ndjejë këtë rrezatim ndjesor...Feniksi është pra fr. t i imagjinatës së poetit që sugjeron ndjenjë të një thu..dsie egzistencialiste të pagarë, por të tejdukshme në jetë, që në amplitudën figurative nuk është feniksi që zgjohet nga hiri i detyruar si shpiri i freskët i një loje të gëtuar kosmike, as ndonjë shahi kohore që kërkon fi t hedhë tutje pa pell gi i qetë mendimet fljejrare dhe fi t kthejë sërish në një ind përtrimtimi artistik, por një drithje që "nap plagët e kohës", të shprehura në çast, stinë, vite dhe dekada, të tradhtiuara nga forca e vet.

Kështu nis kalvarin e mundimshem të shprehur në linjat plot tensionë me motive dhe dëriti, bardi nazik i fjalës së shkruar-poetike, esteti i shpritëreve kuptimore Shefki Karadaku. Ai shpesh muk ndalet në fusha as edhe në lugina për admirime sdilike, mbase ato janë si rrjedhojë e barrës "së mëkatëve" të servijuara nga syri poetik "serpar" si e shkon edhe kohën përmes katarsisit ose lavazhit shpirtëror që se arrijnë kohën e vet, megjithatë ca mreze optimiste amësojnë në botën dhe vizionin e njeniitori artistik, i cili në "ereksjet" saja çirrojnë e shpresës.

Leximi i veprës letrare artistike është një fenomen që manifestohet në mënyrë të ndryshme te secili individ, madje në mënyrë të ndryshme edhe te i njëjti person me rastin e rileximit të së njëjtës vepër në intervale të ndryshme kohore, veçanërisht kur kjo vepër është poezi refleksive me plot rava asociative që e lëvizin çdo hije simbolike të filozofimit dhe tjetërsimit shpirtëror. E tillë është edhe përmbledhja filozofike "Feniks" e Shefki Karadakut. Gjatë çdo rileximi xujerr diç të re…

Shumë poetë kanë shkruar për sistemin monist, disa u afirmuan, të tjerët e mohuan dhe u shpallën disident,

Shefki Karadaku, që e përjetoi këtë periudhë këtë e kkofiguron përmes një përintimi të heshtur. Similitudi poetike e Shefki Karadakut ka lindur nga vizioni i tij përjetimi plot 13-vjet. Sodrtur dhe shprehur në varg dukte shtruar argumente historike të këtaj kohe dhe pasqyrtar përmes krahasimeve të ndrituara… Pra, Shefki Karadaku ky "skllav" i linkës figurative është një poet, si me g madh i shtrirë në mediim mëpër strukturin qiellsbegzë. Inventiv me plot ide të qëlluara, thellohet në të gjitha kodet jetësore ndaj periudha që e portretizon në poemën lirike "Feniks" është një "tatuazh" kohe, që ka komplesitet dhe zhvillim të përhershëm me mesazhe plot peshë. Veku poetik i njerëzs jetësore është varga transcendent që njëherit e shpreh vizionin e poetit për një botë të re, sepse botës plakë (e ka fjalën për sistemin të cilit e portretizon) i kalon koha dhe se paqa me këmbët në boshllëk nuk ka perspektivë dhe është një paqë fiktive plot luftë fronesh dhe mjegull politike në ekzistencë e shteiit. Ndaj për këtë poeti prononcohet: "Isha i detyrar ta bëja këtë jetë poetike të dy-fishtë…Kishtu bu-sha meje lindi një njeri tjetër, i cili mundi të krijojë gradualisht imazitin e pastër të një bote gati irreale të mrfluar nga një atmosferë e trashë heshtieje dhe indiference pas së cilës modelonte e gjallë dicka stratosferike e pa vëzhguar nga askush dhe e pa ngacmuar nga asgjë i vlgjare që mundi të sjellë izolimi i një shteti…". Dh=ne këtë izolim ndjen përjetojnë poetët autori shton: "Unë mbase jam ai që sdi çfarë është, çfarë ndërtoj e kokën tjm e kam nga bluetërnësë pa kuptim, por që i tërabit ajsë nga ironia pa vullnet që s'mundi të ndërtojë asgjë nga ëndërrat shtratsike, dhe pa forcë, pa psuhtet u mbyllis në vetmi nga ankthi, një cergë enda forë për të tronditur qeveritë e për të shkundur popujt nga letargjia si dermon…". Por, thekson më tej poeti me pesimizëm hezitues: "Mbeti kot dëshira ime…vec jehonë, e meqë s'mund asgjë të bëj me fjalë altruiste, me dhimbje gryxej fortë ndërgjegjen time deri në fund e bëhem vetë makth sikur zemërimi të më mbysë nga jeta pa kuptim edhe qëllimi pa një cak…". E konstaton këtë poeti figurshëm me ekzagjerime asociative për epokën që ne ngadalë, që çdo ditë të duket e gjatë sa muaji vlet e nuk ikin shpejt dhe ne durojmë nën strehet e mplakuna… Dhe poeti në kërkim të bjshtit të këtaj kohe të ndrzigjatur kërkon magjinë e madhe për të krijuar harqet e fatit për të nuajtar gamën njeriizore që të zbulakë zyrtetisnë e terrorit duntesk dhe "atje" ku vegjëtojnë meridianët e përhotshme, ku "e bukura dita lind, por e zymtuar perëndon", dhë me shqetësime dhe mundije ka frika absolute shkakton heshtje akujsh. S'ka liri. Ei vëren poeti se njeriizri që qëndrojnë në psuhtet e mbjellin këtë heshtje, me ta, prá me emrin e tyre lidhet nxitja e luftës, ndaj në një kohe të caktuar ata nuk bëjnë gjë tjetër vepse gjallërimin e këtyre institiceve sa transmetojnë edhe të tjeretve…Dhe poeti e di se njeriizri futkejshtët, me shumicën dërmuese e ndjejnë nevojën t'i nënshtrohen një pushteti, nga i cili entuziazmohen edhe kur ai sillet keq me ta, që këta njerëz mos demoralizohen, por të bëjnë përpjekje që ta tjuhin më mirë veten dhe brenda vetes të dallojnë të keqen (Frojdi)… Kjo vetëdije e pranisë së botës apo më saktë kjo vetëdije e afirmit të saj përmes krahasimit shoqërohet me një farë devocioni ndaj gjeniereatës së re. Duke mos kontestuar mesazhin për ndërrime sistemesh, téré këto i jep me përforcieme sfondesh që në poezinë i izvejnë funksionet metaforike-figuracion,

që në fakt është alz vetëdije lidhur ngushtë përmes përceptimeve ndiesore dhe shprehja e këtyre ndiesive bëhet njëlloj si shprehje e një pikture ose muzike…Lirika e Shefki Karadakut është një e ndjeshmërisë individuale poetike dhe admirimi përintures vjen nga thellësia nga fundi i ndërgjegjes si një ndrijim i padukshëm. Emocionet nuk janë hapërim në vend, por një kohë në ecje pa pushim…Gjithnjë të varura nga mendimi njerëzor, sepse jeta ku vertifikohen këto mendime është e mbështjellë me plot ngjarje… Endëreon poeti një vend ndryshe nga ai që e jeton, kërkon një vend: "…me gjithë mjalti dhe harreje pa ligje-despotike dhe kushtetuta plot dyshim…". "Dëshiroj një Eldorado ku ju të gjithë të rrini zemër qetë…". Është vizioni i poetit dhe optimizmit të tij se: "Do vijë çasti që nga kartiga bukurosht të shoh të kaltërt botën pa dimër stinesh pa mërzi?…". Kështu këtegëtron me optimizmin e stinës së intuits poeti, stinën që asksuh se sheh, por stinë që flet nga një botë e brendshme nga disponimi i zbetur dhe i mërzitur dhe si lunatik me shpresë dëgjon se tufanet dhe erbeshet do të pushojnë…

Kritika letrare e ndjek hap pas hapi letërsinë…Po që se shlkohet lirika e përmbledhjes "Feniks" letrë vërehet se vëllimi ka një frymë të re poetike. Estët një poezi me qeles që zhvillohet me një përjetezë poetike alternative. Ajo ndryshon jo vetëm nga format stereotipe të poezisë shqipe, por edhe kundrej poezisë që ka marrë përsipër të jetë avangarde e këtaj poezie… E veçanta e këtij vëllimi është se përkon me koordinata të përafërta të obcionit poetik filozofik të Khajamit. Poeti si edhe Khajami marrëdhënet me botën, pjesa materiale e të cilës i përgjigjet frymës poetike filozofike të poezit përmbet përmes asociacionve-kjo veçantësit vërehet të përsëritjen e dendur të metaforës së vetmisë…Aj, pra Sherki Karadaku, nuk shpall betejë për mëkatet duke shprehur përsosmërisë morale, por përkundrazi përmes "pasqyrës reflektive" që shikon botën i thekson krahasimet e jetës të mundimshme dhe të lodhshme shqiptare…Si qiriri i Naimit që digjet në zgrip e honi: të romantizmit evropian edhe Shefki Karadaku digjet në përintim në "honet" e errësirës…së regjimit monist. Por, poeti thotë se poezia e tij futet thellë në/pë botra, gërmon mendimet, kohërat, thërret dhe qesh me zemrën copa-copa dhe shpëndahet në të gjitha trajtat… Si, feniks shkëfiqen me ide kuarci duke ndërtuar "ullnë betoni"… I tillë është poeti Shefki Karadaku, tërë vargjet e poemës "Feniks" janë të harmonizuara estetikisht në gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit original dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm…Ka poeti edhe idilën e vet të vendlindjes që është "…me çuka, rrepe-qiparisa dhe subtrejsia mund t'i flasë gerishtë, por jo stërberge…". Por, ka poeti edhe dashurinë e shprehur ai Naimi e Çajupi. "Të kërsdej ty bukurosha si alkca, unë s'jam poet i vjetër mellk, po zemru pu aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik…", që pasaj të vijojë: "Po zemra e kërkon nuón e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun fiorde të përpëlnë…".

Si të përfundojmë?! Shkurt, poezi e vecantë, e jashtzakonshme, e bukur… Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku… Është shumë refleksive, sa me shpesh ta levosh dhe rilexush gjithnjë do të mjerisih ndonjë ndrigim nga qiellë me plot yje të poezisë së poetit madh. Pra kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë.

Lutfi TURKESHI

Shumë poetë kanë shkruar për sistemin monist, disa u afirmuan, të tjerët e mohuan dhe u shpallën disident, Shefki Karadaku, që e përjetoi këtë periudhë këtë e konfiguron

përmes një përimtimi të heshtur. Similituda poetike e Shefki Karadakut ka lindur nga vizioni i një përjetimi plot 13 vjet. Soditur dhe shprehur në varg duke shtruar argumente historike të kësaj kohe dhe pasqyruar përmes krahasimeve të ndritura... Pra, Shefki Karadaku, ky "skllav" i lirikës figurative është një poet si mag i madh i shtrirë në meditim nëpër zinxhirin qiellshpues. Inventiv me plot ide të qëlluara, thellohet në të gjitha kodet jetësore ndaj periudha që e portretizon në poemën lirike "Feniks" është një "tatuazh" kohe, që ka kontinuitet dhe zhvillim të përhershëm me mesazhe plot peshë. Veku poetik i rrjetës jetësore është vargu transcendent që njëherësh e shpreh vizionin e poetit për një botë të re, sepse botës plakë (e ka fjalën për sistemin të cilin e portretizon) i kalon koha dhe se paqja me këmbët në boshllëk nuk ka perspektivë dhe është një paqe false plot luftë fronesh dhe mjegull politike në eklipset e shtetit. Ndaj për këtë poeti prononcohet: "Isha i detyruar ta bëja këtë jetë poetike të dyfishtë... Kështu, brenda meje lindi një njeri tjetër, i cili mundi të krijojë gradualisht imazhin e pastër të një bote gati ireale, rrethuar nga një atmosferë e trashë heshtjeje dhe indiference pas së cilës modelonte e gjallë diçka stratosferike e pavëzhguar nga askush dhe e pangacmuar nga asgjë vulgare që mundi të sjellë izolimi i një shteti...". Dhe në këtë izolim ndjen përplasjet poetike autori shton: "Unë mbase jam ai që s'di ç'të bëjë, ç'të ndërtojë e kokën time e kam nga blasfemitë pa kuptim, por që i trishtë qesh nga ironia pa vullnet që s'mundi të ndërtojë asgjë nga ëndrrat shtatanike dhe, pa forcë, pa pushtet u mbylla në vetmi nga ankthi, një cergë enda fort për të tronditur qeveritë e për të shkundur popujt nga letargjia si demon...". Por, thekson më tej poeti me pesimizëm hezitues: "Mbeti kot dëshira ime... veç jehonë, e meqë s'mund asgjë të bëj me fjalë altruiste, me

dhimbje gërryej fort ndërgjegjen time deri në fund e bëhem vetë makth sikur zemërimi të më mbysë nga jeta pa kuptim edhe qëllimi pa një cak...". E konstaton këtë poeti figurshëm me ekzagjerime asociative për epokën që ec ngadalë, që çdo ditë të duket e gjatë sa muajt, vitet e nuk ikin shpejt dhe ne durojmë nën strehët e mplakura... Dhe poeti në kërkim të bishtit të kësaj kohe të stërzgjatur kërkon magjinë e madhe për të krijuar harqet e fatit për të ruajtur gamën njerëzore që të zhdukë zymtësinë e terrorit dantesk dhe "atje" ku vegjetojnë meridianët e përbotshëm, ku "e bukur dita lind, por e zymtuar perëndon", ditë me shqetësime dhe tronditje ku frika absolute shkakton heshtje akujsh. S'ka liri. Dhe vëren poeti se njerëzit që qëndrojnë në pushtet e mbjellin këtë heshtje, me ta, pra me emrin e tyre lidhet nxitja e luftës, ndaj në një kohë të caktuar ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse gjallërimin e këtyre instikteve ua transmetojnë edhe të tjerëve... Dhe poeti e di se njerëzit fatkeqësisht, në shumicën dërrmuese e ndiejnë nevojën t'i nënshtrohen një pushteti, nga i cili entuziazmohen edhe kur ai sillet keq me ta, që këta njerëz mos demoralizohen, por të bëjnë përpjekje që ta njohin më mirë veten dhe brenda vetes të dallojnë të keqen (Frojdi)... Kjo vetëdije e pranisë së botës apo më saktë kjo vetëdije e afrimit të saj përmes krahasimit shoqërohet me njëfarë devocioni ndaj gjeneratës së re. Duke mos kontestuar mesazhin për ndërrime sistemesh, tërë këto i jep me përforcime sfondesh që në poemë i kryejnë funksionet metaforike-figuracion që në fakt është akt vetëdijeje lidhur ngushtë përmes perceptimeve ndjesore dhe shprehja e këtyre ndjesive bëhet njëlloj si shprehja e një pikture ose muzike... Lirika e Shefki Karadakut është një akt i ndërgjegjes individuale poetike dhe admirimi përimtues vjen nga thellësia nga fundi i ndërgjegjes si një ndriçim i padukshëm. Emocionet nuk janë

hapërim në vend, por një kohë në ecje pa pushim... Gjithnjë të varura nga mendimi njerëzor, sepse jeta ku verifikohen këto mendime është e mbështjellë me plot ngjarje... Ëndërron poeti një vend ndryshe nga ai që e jeton, kërkon një vend: "... me gjuhë mjalti dhe hareje pa ligje-despotike dhe kushtetuta plot dyshim...". "Dëshiroj një Eldorado ku ju të gjithë të rrini zemërqetë...". Është vizioni i poetit dhe optimizmit të tij se: "Do vijë çasti që nga karrigia bukuroshe të shoh të kaltër botën pa dimër stinash pa mërzi.?..". Kështu këngëton me optimizmin e stinës së intuitës poeti, stinën që askush s'e sheh, por stinë që flet nga një botë e brendshme nga disponimi i zbehur dhe i mërzitur dhe, si lunatik, me shpresë dëgjon se tufanet dhe rrebeshet do të pushojnë...

Kritika letrare e ndjek hap pas hapi letërsinë... Po qe se shikohet lirika e përmbledhjes "Feniks" lehtë vërehet se vëllimi ka një frymë të re poetike. Është një poemë me çelës që zhvillohet me një përpjetë z poetike alternative. Ajo ndryshon jo vetëm nga format stereotipe të poezisë shqipe, por edhe kundrejt poezisë që ka marrë përsipër të jetë avangardë e kësaj poezie... E veçanta e këtij vëllimi është se përkon me koordinata të përafërta të opsionit poetik filozofik të Khajamit. Poeti si edhe Khajami, marrëdhëniet me botën, pjesa materiale e së cilës i përgjigjet frymës poetike filozofike të poetit, shtrohet përmes asociacioneve – kjo veçanërisht vërehet në përsëritjen e dendur të metaforës së vetmisë... Ai pra, Shefki Karadaku, nuk shpall betejë për mëkatet duke shprehur përsosmërinë morale, por, përkundrazi, përmes "pasqyrës refleksive" që shikon botën i thekson krahasimet e jetës të mundimshme dhe të lodhshme shqiptare... Si qiriri i Naimit që digjet në zgripin e honit të romantizmit evropian edhe Shefki Karadaku digjet në përimtim në "honet" e errësirës... së regjimit monist. Por,

poeti thotë se poezia e tij futet thellë nëpër botra, gërmon mendimet, kohërat, thërret dhe qesh me zemrën copa-copa dhe shpërndahet në të gjitha trajtat... Si feniks, shkëlqen me ide kuarci duke ndërtuar "udhë betoni"... I tillë është poeti Shefki Karadaku. Tërë vargjet e poemës "Feniks" janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm... Ka poeti edhe idilin e vet të vendlindjes që është "... me çuka, rrape-qiparisa dhe subtropiku mund t'i flasë qershisë, por jo ajsbergë...". Por, ka poeti edhe dashurinë e shprehur si Naimi e Çajupi: "Të këndoj ty bukuroshe si alku, unë s'jam poet i vjetër melik, po zemra po aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik...", që pastaj të vijojë: "Po zemra e kërkon nudon e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun floride të përqeshë...".

Si të përfundojmë?! Shkurt, poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa më shpesh ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh.

Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë.

Gazeta "Fakti", 8 mars 2001, Shkup

"SAGË MBRETËRORE", NJË DOKUMENT HISTORIK PËR TOKËN E LASHTË – PERLË E NATYRËS

(Duke shfletuar romanin epope të shkrimtarit Shefki Karadaku)

Bardhyl Ajazi, *Shkrimtar & studiues*

Këto ditë të nëntorit të njëqindtë të Pavarësisë te secili është rritur dëshira dhe interesimi për të njësuar e për të ditur më shumë rreth ngjarjeve të rëndësishme që ka përjetuar Shqipëria.

Populli ynë e ka pasur gjithmonë të shenjtë njëqindvjetorin. Në çdo lindje apo ditëlindje urimi i parë është: "U bëfsh njëqind vjeç", "u bëftë njëqind vjeçe vajza", "u bëftë njëqind vjeç djali".

Kështu edhe shtetit të parë shqiptar iu bë ky urim dhe popullit që e ngjizi: "U bëftë njëqind vjeç!". Sepse një shtet, një popull në njëqind vjet ka ç'të thotë, ka ç'të bëjë. Bën historinë e tij. Dhe Shqipëria e ka bërë historinë e saj në këto njëqind vite me ngjarje të mëdha e tepër të rëndësishme. Populli e ka bërë historinë e tij si protagonisti kryesor në këto ngjarje. Një ndihmesë dhe një shërbim të madh në pasqyrimin me vërtetësi

të historisë japin objektet e trashëguara, gojëdhënat, rapsoditë, dëshmitë, dokumentet, historianët e mirëfilltë si dhe njerëzit e letrave: shkrimtarët, poetët dhe letrarët në përgjithësi. Dhe, ç'është e vërteta, ngjarjet më të rëndësishme në këto njëqind vite, apo dhe në tërë jetën e këtij populli të lashtë e vital, janë pasqyruar në këngët e tij, në vjersha e në poema, në valle, në pikturë e në skulpturë, në pjesët skenike e në kinematografi, në tregime e në romane të shkruara. Janë të shumta veprat, që kanë dalë e dalin në dritë e që i kushtohen njëqindvjetorit të pavarësisë. Një vepër e tillë është edhe romani: "Sagë mbretërore" i shkrimtarit Shefki Karadaku. Në këtë roman epope shtjellohen ngjarje të rëndësishme fill pas shpalljes së pavarësisë e në vazhdim. Aty shpërndahet tisi i kohës dhe qartësohen shkaqet dhe rrethanat në të cilat erdhi dhe më pas iku Princ Vidi, dhe më tej si rrodhën ujërat e turbullta nëpër këtë tokë të lashtë, perlë të natyrës.

Romani është i ndarë në tri pjesë domethënëse: "Rebelimi" – "Prag lufte" – "Eklips".

Duke shfletuar librin, përpara syve kalojnë në mënyrë kronologjike ngjarje të mëdha me ardhje dhe ikje monarkësh, me ardhje plot pompozitet dhe ikje me turp, me ardhje dhe ikje diplomatësh dinakë, me ardhje dhe ikje gjeneralësh mburravecë, me ardhje dhe ikje perandorësh e perandorish, që, në mënyrë të fshehtë apo të hapët, në rrugë diplomatike djallëzore, apo ushtarake të pamëshirshme, donin të rrëmbenin dikur copën më të madhe të kësaj toke të bekuar nga Zoti.



Por të gjithë këta ardhacakë mizorë të paftuar a të padëshiruar, gjetën

këtu një truall të nxehtë, që i dogji këmbët si dhe një popull liridashës, që u dogji të gjitha planet skllavëruese e asimiluese të tyre. Një popull, që lirinë e ka të shtrenjtë sa ka jetën.

Duke shfletuar librin, vetvetiu lexuesi bëhet pjesë e atyre ngjarjeve falë bagazhit të pasur njohës dhe punës së përkushtuar shumëvjeçare të Shefki Karadakut. Si shkrimtar i talentuar dhe me përvojë të gjatë dhe të suksesshme në fushën e letrave, ka ditur të ndërthurë me mjeshtëri të vërtetat e dokumentuara dhe historike me ngjyra artistike e nerv poetik komponent të rëndësishëm për një vepër të madhe letrare kaq të mirëfilltë. Në roman, ashtu si ngjarjet, një vend të veçantë zënë aktorët, që luajnë këtë dramë shekullore, figura të njohura e pak të njohura, figura të rëndësishme e tepër të rëndësishëm, vendas apo muhaxhirë, të fuqishëm dhe tepër të ndërlikuar, por autori, me eksperiencën dhe stilin e tij të veçantë, duke përdorur me mjeshtëri dialogun, bën që këta personazhe të shumtë e të papërcaktuar, të qartësojnë me gojën e tyre pozicionin, qëllimin dhe karakterin e tyre. Dhe kjo e bën romanin tërheqës, komunikues dhe lehtësisht të kuptueshëm nga lexuesi.

Më poshtë, po shkëpus disa pasazhe të vogla për të ilustruar paksa përmbajtjen e romanit. Ja një pjesë e bisedës midis princ Vidit dhe baronit napolitan, Alioti:

- Shikoni baron dhe habituni po deshët. Është koka e Artemisit të Dyrrahut. Ndryshe nga Artemisi grek. E shikoni? Më kanë thënë se gjithë ky qytet është plot sende arkeologjike. Në përgjithësi, sendet arkeologjike gjenden në ato vende që kanë një kulturë të lashtë. Mua më habit gjithmonë fakti i thjeshtë se si njerëzit me paraardhës artistë, të jenë zhytur në varfëri, injorancë dhe konflikte kaq absurde.

- Arkeologët tanë më të mirë thonë se kjo është një kulturë

e imponuar nga Koloseu, - u përgjigj Alioti. Por princi tundi kokën me dyshim.

-Nuk jam dakord me ju. Gjëra të tilla janë gjetur edhe në thellësi të vendit.

Në kapitullin e shtatë do të lexojmë: "Rebelimi filloi në mënyrë fare spontane. Muhaxhirët e bukës që vinin në Ndroq, Brakull, Picallë duarbosh sollën bashkë me ligatën e asaj kohe të paqëndrueshme urinë dhe urrejtjen. Tokat e vogla dhe të këqija, që u kishin lënë fshatarëve, bejlerët dhe agallarët, nuk mund të ushqenin nëntë muaj me radhë një familje edhe me kërkesat më minimale. Në fillim, ky rebelim nisi me veprime të vetmuara. Aty-këtu doli tym nga grazhdarët e bejlerëve shijakas. U përzunë disa xhandarë të princit, që vilnin të dhjetat në kazanë e Pezës. Toka e zezë villte këlkaza të hidhura, të cilat njerëzit i bashkonin me lotët e tyre për të mbajtur gjallë veten dhe fëmijët..."

Por vjen një çast dhe princ Vidi detyrohet të lërë fronin, aq të dëshiruar nga vetë ai dhe kancelaritë që e ngjitën me pompozitet.

"...Për një minutë oborri u rreshtua për ceremoninë e lamtumirës. Princi, i vetëpërmbajtur në kulm, princesha e zbehtë e zemëruar, maxhordomët, oficerët e shërbimit, toga e ceremonive me dragonj hungarezë, të hipur në kuaj të bardhë... Fanfara e kuvertës, që e kishte mësuar himnin shqiptar dy orë më parë, u ra veglave gjithë tringëllima magjepsëse.

Dukej se po ia shkundte nga supet e sytë e ngazëllyer atë pezm të hidhur disfate, që qarkohej ngado në atë turmë heterogjene politikanësh, ushtarakësh, shërbyesish dhe grash qejfi. Papritur u bë një zhurmë tej nga mesi i himnit. "Është rrëzuar pa ndjenja madam Gertruda", – tha dikush. Panë se si erdhën dy mjekë të vjetër ushtarakë që i vunë në hundën e

vogël një flakon të lagur me alkool".

Dhe ja si përshkruhet në librin epope: "Sagë mbretërore" një tjetër ikje. Këtë radhë e mbretit, pas njëfarë shkëlqimi personal.

"...Kryeshambellani hapi derën e bardhë para tij me servilizëm:

- Darka është gati, Madhëri...

- Kjo është nata e fundit. S'dihet se kur ulemi në një sofër mbretërore.

- E përse merakoseni, madhëri? Ju keni pará dhe paraja ngul gjithmonë rrënjë në botë.

Mbretëria është plot telashe, kurse ato janë një mbretëri pa asnjë telash.

U detyruan të ikin pak më vonë nëpër xhadenë që përmbytej herë nga era, herë nga shiu. Xhamat e shoferëve u mbuluan me një perde nate. Projektorët e tyre mezi hapnin disa korridore drite nëpër humbëtirën e kodrave e të kthesave. Karvani ecte me një rregull të vjetër, të mistershëm dhe drejtohej gjithmonë nga lindja ose nga juglindja. Herë-herë, buzë honeve dhe fshatrave hungërinin qentë, aq sa trupi i brishtë i mbretëreshës dridhej nga frika...". (Faqe 350-351).

Por fill pas ikjes së mbretit ia behu pushtimi fashist.

"Ajo që nisi para disa vitesh në letrat protokollare dhe në firmat e huave, - vazhdon autori, - zuri të marrë forma të trasha hekuri dhe zjarri... ...

Kjo ishte ushtria më e madhe, që kishte mësyrë ndonjëherë bregun shqiptar.

Ishte ndarë në katër kolona sulmi. Njëra do të nisej drejt Sarandës dhe Vlorës dhe tjetra në veri, drejt Shëngjinit, dhe ajo, më e madhja, do të mësynte portin e Durrësit. Në radhët e saj numëroheshin mbi dyqind mijë ushtarë dhe oficerë, që

përbënin thuajse dhjetë divizione të motorizuara. Një peshë të veçantë në fillim të pushtimit kolonial do të lozte grupimi i madh ajror i gjeneral Prikolos...". (Faqe 353).

Dhe më poshtë vazhdon:

-Poshtë fashizmi!...

- Vdekje fashizmit! Liri popullit!

Dhe në atë çast diçka e tmerrshme tronditi sallën. Njerëzit që qenë lart, vrapuan poshtë dhe dolën nga kinemaja në mënyrë demonstrative, duke lënë pas hijen e një ulërime të madhe... ...

T'i zhdukim më mirë, – tha një tjetër. -Më e mira qe që t'i zhdukim nga faqja e dheut, po kush do të na i punojë tokat dhe të na mbushë xhepat?

-E si mund të zhduken? – pyeti me kureshtje një nëpunës, që shkonte pas ministrit me një dosje të zezë në sqetull.

- Duke i vrarë ose syrgjynosur.

-E tmerrshme!

- Këtu nuk ka tmerr. Në qoftë se nuk do t'i zhdukim ne, do të na zhdukin ata pak më vonë.

Sepse kërkojnë me insistim pushtetin.

- O Zot!

- Mirë e ka Duçja që i vë nën kërbaç, ditë e natë kërbaç...". (Faqe 428). Në kapitullin e njëzet e nëntë të romanit epope: "Sagë mbretërore" autori shkruan: "Mbrëmë ata na shkatërruan batalionin e dymbëdhjetë – tha Renco Dalmacio.

– Me sa duket, manovra e tyre e re përputhet me strategjinë e një lufte misterioze. -Ç'mbeti nga batalioni, Renco? – pyeti me inat zëvendësperandori, Francesko Jakomoni.

- Pak gjëra...

- Po nga avionët?

-Edhe ata pësuan dëme, shkëlqesi...". (Faqe 482). Dhe

sërish përsëritet historia. Fundi i librit na jep edhe fundin e pashmangshëm të pushtuesve, fundin pa lavdi dhe ikjen me turp nëpër terr...

Autori thotë:

"...Pas disa minutash kaluan nëpër qendrën e kryeqytetit të përgjumur. Ajo dukej si një qendër hënore për shkak të topave kundërajrorë që rrinin mbi platformat e hekurta. Grykat e tyre të zbrazura vështronin si sy pa jetë qiellin e ujshëm... ...

Atij, nga kjo mungesë qetësie, i dhembte shpirti... Ai po ikte siç erdhi. U ngjit si ambasador në fronin e një mbreti dhe po zbriste si mbret në fronin e një ambasadori shëtitës, pa mbretëri... Katër vjet mjaftuan ta rrënojnë një gjysmëmbret, kurse për mbretin vendas u deshën njëmbëdhjetë... Po gdhinte kur sosi në aerodromin e Picallit. Shiu, që pushoi aty më parë, nisi përsëri të bjerë. Ai u ngjit nëpër shkallët rrëmbimthi duke u mbrojtur nga uji me dorën e ngritur si strehë... ai hyri në avionin ushtarak i mërzitur e i lagur. Sapo u ul në njërin nga kolltukët pranë dritareve ovale, gjëmuan motorët. Mëkëmbësi dridhej ngadalë, nën ritmin e dridhjes së avionit. Vetëm kur u shkëput, ai përkuli kokën në dritaren e ngushtë dhe pa për herë të fundit, me keqardhje peizazhin, që linte prapa vetes. Nuk dalloi asgjë konkrete. Masa e zezë e tokës qe po aq indiferente sa kur ai sundonte mbi të". (Faqe 513-514).

Gazeta "Republika", 25 nëntor 2012

"KOHA E AKULLT" DHE "PUTHJA E NGRIRË"

Petraq Risto, *Shkrimtar*

Kur redaktoja romanin "Puthja e ngrirë" të shkrimtarit Shefki Karadaku, menjëherë m'u krijua atmosfera e romanit "1984" të Oruellit, botim i Prishtinës të cilin dikur e lexonim të ethshëm në një nga sallat e Bibliotekës Kombëtare. Megjithëse autori, herë pas here, me natyrën e tij romantike, bënte krahasime me brezin e humbur në romanin "Tre shokët" të Remarkut, mua përsëri më vijëzoheshin fantazmat e "1984". Qyteti Nag, njerëzit e këtij qyteti, natyrisht janë krijesa prej mishi dhe gjaku, por që rrezikohen të akullohen nga diktatura e egër komuniste. Pas vëllimit me poezi lirike, të shkruara në kohën kur truri i poetit përpiqej të mos deformohej nga autocensura, ky roman i shkurtër e tepër i ngjeshur, përbën një sukses dhe rinim të veprës së Karadakut. Me vëllimin e tij të parë poetik "Kënga e karrove të drithit" ai u cilësua si një shpresë, por, si shumë krijues që nuk dinin të angazhoheshin, u mënjanua padrejtësisht nga "loja e hierarkisë së përkohshme".

Lirizmi, heshtja, frika, rebelimi, ankthi, jeta, dashuria, vdekja ndërthuren në roman plot dritë dhe hije, si një afresk bardhë e zi. Autori është konkret, është dhe tepër simbolik, megjithatë personazhe të tillë si Rrok Dalia, Zibeli, Kanad Dika, Pigali, Mek Doda e të tjerë, janë një pasurim i personazheve jetësore të një letërsie realiste. Autori shkruan me dhimbje, dhimbjen e të gjithëve. Bushtrima ku ishte izoluar një njeri me shpirt titani, Kanadi, flet shumë me tragjizmin e saj. "Ende nën pushtetin e dramës së Kanad Dikës dhe ende pa arritur ta vuajë atë deri në fund, kur i thanë se Basri Memën e kishin çuar mbrëmë në humbëtirat e Bugut".

Rroku, piktor, intelektual krijues, fillon dhe vuan. Tashmë i kishin izoluar një shok tjetër, Basriun. Frika, si një merimangë helmuese, ngjitet jo në trup, por në thellësi të damarëve. Futemi sërish në botën e Rrokut: "O Zot, tha prapë dhe u afrua pranë xhamit, si për të qetësuar në të shpirtin e errët. Pas xhamit pa se si dikush në trotuarin përballë, bisedonte me një femër. Ndoshta donte të flinte me të. Ndoshta e puthte ndukshëm, paturpësisht, pa vënë re se dy përgjues po e vështronin rreptë nga qoshja, në kohën që ata të dy mbanin mbi këtë mizerje dimërore një çadër të vogël, e cila tundej sa herë shtrëngoheshin dhunshëm për të shkëmbyer puthje të reja.

Rroku qeshi për herë të parë, ashtu siç mund të qeshet me një shaka në mes të varrimit. Pastaj përgjuesit i ranë bilbilit. Çifti u nda, por nuk shkuan të dy në të njëjtin drejtim...". Vini re ritmin, sarkazmin, realizmin, artin. Vetëm në 130 faqe roman dhe kaq shumë lëvizje, skena e skenëza, prapaskena e prapaskenëza. Turpi dhe paturpësia zhvishen lakuriq dhe ti, në të gjitha këndvështrimet, ndjen keqardhje, gjakos shpirtin e leckosur të bashkëkohësit.

Po ata lart? Lart ka ëndrra, ka pasuri, vila, intriga, vrasje. Pigali, por dhe të tjerët në qytetin Nag jetonin në luks, inskenonin konflikte, vetëm e vetëm që të shtrëngonin rripat e mirëqenies së vobektë njerëzore. "Ndiente si i hipte dëshira që t'i pohonte vetes se kishte krijuar diçka jo të zakonshme, si Kaligula". Lufta për pushtet, frika e marrjes së fronit nga të tjerë, snobizmi, përdhunimi i shpirtrave, frika nga rebelimi telashhapës, makina e re (Çuditërisht "Kadillak") si te "Tre shokët", herezia fodullëku, gjithçka, kthehen në dhëmbëminjbrejtës... Dhe, mes gjithë kësaj katrahure e pisllëku, ngrihet përmendorja e dashurisë, e huazuar nga një botë mjellme, nga ku vjen mbase kënga e paravdekjes së Zibelit, e kthyer tashmë në një legjende, ose në një utopi, ose në një magje urrejtjeje. Liqeni Çud, (Perëndimi është një çudi, një marramendje, një avion letre që digjet në një qiell dëshirash) me ngjyrën e tij të smeraldtë, pret të arratisurit nga ferri, të cilët shtrëngojnë në grushtet e zemrave anatemën për diktaturën e egër.

"Puthja e ngrirë", e shkruar më 1989 - 1991, është një roman lirik me nota të thella tragjike. Shefki Karadaku gërsheton me sens mase prozatorin, poetin, sociologun, filozofin.

Romani i ri "Puthja e ngrirë", e ka gjallëruar shkrimtarin pesëdhjetë vjeçar Shefki Karadaku, i cili së shpejti do të nxjerrë në qarkullim edhe vëllimin me tregime "Arkadia e largët", si dhe romanin e shkurtër "Njëmijë vjet dashuri". Autori i "Kënga e karrove të drithit", këtu e tridhjetë vjet të shkuara, tashmë hyn në rrugët e letërsisë me artilerinë e rëndë, i gatshëm të "na vrasë" me joshjen e mënyrës së rrëfimit, artin, subjektin, personazhet: të "na vrasë" me sinqeritetin e tij, me "naivitetin bulëzues" që e dëshiron çdokush, por edhe me pjekurinë e

frazës, zhdërvjelltësinë e dialogut, lirizmin e përshkrimit. Hoqa një paralele mes "Puthja e ngrirë" dhe "1984", ngaqë doja që në këto shina të rendte treni, domethënë, diktaturat ngjasin, por edhe shkrimtarët ngjajnë, mbase sepse shpirtrat e tyre janë pasqyra të thyera.

Gazeta "Rilindja Demokratike", 21 shtator 1994

VETËM "1000 VJET DASHURI..."

Faruk Myrtaj, *Shkrimtar*



Gabriel Garcia Markez e ka titulluar njërin nga romanet e mëdhenj të tij "Njëqind vjet vetmi". Shefki Karadaku e ka parë të udhës që ta paraqesë romanin e tij të fundit nën titullin "Njëmijë vjet dashuri". Autori i romanit të fundit, me një përllogaritje të thjeshtë ndjesore, jo matematikore, arrin në përfundimin se në historinë e tij (dramatike) mijëravjeçare njerëzimi i ka kushtuar dashurisë vetëm e vetëm këta 100 vjet... Pjesën tjetër, ah, pjesën tjetër...

Ja nomenklatura e romanit të Shefki Karadakut: (Gjithnjë sipas terminologjisë së kritikës së deritanishme) heroi kryesor mban emrin Faust. E dëshiruara e tij (dhe jo vetëm e tij) quhet Margaritë, shkurt Margot. "Të tjerë personazhe pozitive" në roman janë banorë gati provizorë të fshatit (apo kampit të internimit) që thirret Shën Mëhill. Të gjithë këta, mezi përballen me jetën që u ka rënë për hise. Një jetë që përpiqet të mbahet gjallë, qoftë edhe në një klub me shishe që zbrazen për të mbushur sadoqoftë jetën e tyre.

Klubin "e vizitojnë" herë pas here "Gaz-i" i Degës së Punëve të Brendshme, një sekretar partie, operativi dhe atykëtu njerëz që ndëshkojnë pa e ditur as vetë pse e si, njerëz të tjerë që përpiqen të mbajnë gjallë dashurinë.

Por janë edhe dy "personazhe" të tjerë që lëvizin përqark skenës së romanit njerëzor; dy "heronj" që nuk i përkasin racës njerëzore, por që përcaktojnë prej mijëra vjetësh "fatin" e kësaj race: dy ujq që krejt qëllimisht, autori i ka civilizuar me emrat historikë: Remi dhe Romuli. Është një gjetje e mrekullueshme, gjendje origjinale, që arrin të mbajë ndezur kureshtjen e lexuesit deri në faqet e fundit të tij.

Klarinetisti Gurali Zeka, hyri atë ditë në klub i sapokthyer nga një dashuri e vjedhur. "O Zot, ky sikur ka dalë nga një banjë me argjend", aq i bukur dukej. "Ka qenë tek ajo, thonë për të banorët e klubit. Dhe pikërisht në këto çaste, kur dikush prej racës njerëzore ka hedhur një hap drejt dashurisë, pikërisht atëherë, ndihet ardhja e ... Remit dhe Romulit. Dy ujqit, sinonim të egërsisë, sinonim të rezistencës ndaj zbutjes së njerëzimit, "heronj" të heshtur të barbarisë mijëravjeçare, shfaqen dhe të sjellin ndër mend Romën e lashtë. Fatin e saj Gurali Zeka vritet me dy plumba dhe... kaq më.

Por këtë fat mund ta kishte gjithkush. Edhe vetë Fausti i romanit "1000 vjet dashuri". Këtë mund ta ketë gjithkush, përderisa në mijëra vjet jetë, njerëzimi i ka bërë apo nuk i ka bërë dot njëqind vjet dashuri. Fshati Shën Mëhill në të vërtetë është një vendbanim botëror, shumë më i gjerë se Shqipëria. Por Shqipëria është së paku aty. Deri në këtë skaj vijnë ato që thuhet se po ndodhin me studentët në Tiranë. Pamundësia e dashurisë vjen që andej, që nga Tirana, që nga Lindja komuniste, madje shumë më larg akoma. Atë e sjell prania ende e figurave fantazmagorike të Remit dhe Romulit...

Sa herë që dashuria ndëshkohet te njerëzit e Shën Mëhillit, është e sigurt se janë afruar aty përqark kodrave dhe maleve ata të dy: Remi dhe Romuli. Barbaria. Megjithatë, njerëzit vazhdojnë të synojnë pikërisht atë që ndalohet: Dashurinë. Me çdo çmim atë: Dashurinë. Qoftë edhe prej grimcash, qoftë të paguar me jetë. Diktatura e bën sakrificën për dashurinë edhe më të shtrenjtë, pra më të kërkuar. Fausti dhe Margoti janë gati të shndërrohen në dashnorë ideale, për t'i shpëtuar llumit të shoqërisë (anti) njerëzore që diktojnë antinjerëzit e diktaturës remët dhe romulët e racës njerëzore.

Dashuria dhe barka e Noes asnjëherë nuk humbasin dot. Instinkti i urrejtjes i bartur kaq gjatë nëpërmjet dy ujqërve dhe njerëzve të ngjashëm me ta, e kërcënon vazhdimisht "marrëzinë" e dashurisë, por kjo nuk zhduket dot. Nuk fiton dot bujshëm mbi këtë instinkt por gjithsesi nuk humbet. Asgjë në botë nuk është bërë nëpërmjet urrejtjes. Gjithçka është bërë nëpërmjet dashurisë, edhe pse ajo nuk përbën më shumë, ndoshta, se 1000 vjet prej këtyre mijëra viteve të ekzistencës njerëzore.

Nga mijëra vjet jetë njerëzore, Gazeta "Republika", 21 gusht 1994

"11 DITËT SHQIPTARE QË TRONDITËN BOTËN"

Faruk Myrtaj *Shkrimtar*

Pasi lexon librin e titulluar "11 ditë shqiptare që tronditën botën" të autorit të njohur Shefki Karadaku, natyrshëm të shkon mendimi te "10 ditët që tronditën botën" të shkrimtarit dhe gazetarit amerikan Xhon Rid, që evokoi fitoren e Revolucionit proletar sovjetik të fillimit të shekullit. Dhe në të vërtetë, janë po ato 10 ditë që detyruan jo vetëm Shqipërinë por edhe Botën, t'i hynte një rruge të vështirë jete dhe mendimi. Miti i krijuar me dhunë në Pallatin e Dimrit në Petrograd, u ndëshkua keqas edhe në Shqipëri.

"Pushtuesit e ambasadave", siç u quajtën me kohë në shtypin shqiptar, braktisën vendin e tyre në pamundësi për të braktisur atë dhunë dhe atë ideologji që i detyroi të zgjidhnin si alternativë braktisjen. Të akuzuar për faje dhe mëkate që ata vet nuk i patën kurrë, pushtuesit e ambasadave morën rrugët e Europës, u bënë ikës të vendit të vet, natyrisht për t'u rikthyer në një ditë më të mirë, që ende nuk ka ardhur, pa dyshim, për shkak të atyre 10 ditëve që nisën shëmtimin dhe dhunimin e shpirtit njerëzor. Shefi Karadaku kumton pikërisht këtë gjë. Argonautët kërkojnë atë që nuk e kanë pasur kurrë, Kolkidën e Artë, shpresën e premtuar përjetësisht dhe kurrë të realizuar.

"Argonautët" është në të vërtetë vazhdimi i po atij realiteti

historik dhe letrar, që Sh. Karadaku ka nisur të plazmojë këndshëm dhe me shpirt, te romani i mëparshëm i tij "1000 vjet dashuri". Leximi i këtij romani është një mundësi për të ripërtypur atë që Tirana dhe Shqipëria përjetuan në ditët e korrikut 1990. Poeti dhe prozatori, të ushqyer rreptë dhe dhimbshëm nga detyrimi i qytetarit, e kanë shpënë autorin tek "Argonautët", një roman që nuk mund të mos lexohet deri në fund, sidomos kur ke lexuar "1000 vjet dashuri".

Vlen të theksohet se Sh. Karadaku është ndër shkrimtarët më prodhimtarë dhe më të botuar në këtë periudhë tekanjoze të tranzicionit edhe kulturor shqiptar.

Gazeta "Aleanca Nacionale", 10 mars 1995.

POETI DHE PROZATORI SHEFKI KARADAKU BOTOHET NË GJUHËN GJERMANE

Halil Rama & Sakip Cami, *Gazetarë, shkrimtarë dhe studiues*

Revista letrare gjermane "Literatura nr. 11", ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare Marburg e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.



Kohët e fundit u ribotua vëllimi me novela "Arkadia e largët" i shkrimtarit Shefki Karadakut.

Këto novela sirtari të viteve 1975-1978 nuk e njohën dritën e botimit kur u krijuan, para viteve ’90, por vetëm tani. Janë botuar në vitin 1994 dhe janë ribotuar në vitin 2012 për vetë trajtesën e tyre dhe stilin e tyre të veçantë letrar. Teksa lexon këtë vëllim shumë tërheqës vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet “Njëmijë vjet dashuri”, “Argonautët”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panegjerikus”, “Gjergj Elez Alia”, “Sagë mbretërore” si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë të tjera europiane.

Autorët shqiptarë të botuar tashmë në vende të ndryshme të botës dhe të Europës janë shtuar, por e veçanta qëndron në faktin që autorë të talentuar vlerësohen dhe botohen jashtë vendit ndërsa qëndrojnë jashtë vëmendjes së shtetit dhe të kritikës letrare në Shqipëri.

Shefki Karadaku shkruan dhe vetëm shkruan gjëra të bukura dhe me vlerë për brezat që janë sot dhe për ata që do të vijnë. Të shkruash 12 vëllime me poezi , 10 romane dhe 8 libra me novela, që të gjithë me subjekt të zgjedhur e të arrirë nuk është pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen që të mos ketë “Puthje të ngrirë”, që fjala e lirë të rrjedhë si “Ujëvarë”, që “Gjergj Elez Alia” t’u transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij, por edhe vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që “Shkumbini” të mos shkatërrojë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që “Elbasani i bukur” të çlirohet nga ndotja dhe të shndërrohet në turizmin tradicional shekullor.

Në këtë shkrim do të ndalemi shkurtimisht te novelat e

sirtarit, te vëllimi me novela “Arkadia e largët”. Janë dhjetë novela të shkurtra që lexohen me një frymë, si për mënyrën e të shkruarit me kulture dhe konçize, por edhe për mesazhin që transmetojnë.

Erika Beermann
Am Glaskopf 38
D-35030 Marburg

Z.
Shefki Karadaku
Qendra Administrative Nr. 5
Lagja nr. 31
Pallati 53/1 Shtesa anesore
Shkalla 1 Apartamenti 1
Tirana
Albanien

Marburg, me 21. nentori 1994

I nderuar z. Karadaku,

Jufalemnderit per letren Tuaj si edhe për librat, qe lexoj me shume interes. Kam përkthyer menjëherë tregimin "Karibda", që mund të botohet në një vëllim tregimash nga Evropa juglindore, që do ta botoje, me gjase, profesori ynë për letërsinë sllave - natyrisht, vetëm në qoftë se pranoni propozimin tim. Mjerisht, autoret nuk mund të presin honorar nga ky botim, sepse me fitimet do të financohet prodhimi i librit. Por nga ana tjetër, kjo mund të jetë rasti i parë që lexuesit gjermane do të lexojnë veprat të shkrimtareve që janë te ne krejt panjohur, ose veprat te panjohur të shkrimareve të famshëm. Ju lutem, mendoheni per ofertën.
Ju dërgoj edhe një letër për zotin Ramiz Lushaj; ju lutem, ia dorëzoni.

Me nderime
Erika Beermann

(Erika Beermann)

Në novelën e parë, me titull "Karibda", del në pah forca e njeriut të dashuruar, e njeriut që dashurinë njerëzore e ka dhe vë mbi gjithçka. Ndonëse ky njeri ndodhet super i izoluar në një shpellë, ai di të mbijetojë dhe mbijeton në sajë të dashurisë. Dashuria në këtë novelë si nocion dhe si veprim, ndonëse në pak faqe, del me një forcë të madhërishme. Autori në gojën dhe në psikikën e njeriut të vetmuar në kanionin e thepisur vë atë pasuri të vetme që ka, forcën e dashurisë dhe të shpresës. Por, ndërkohë, autori ndien dhimbje kur shpesh dëgjojmë të thonë: "E theri", "E vrau", "E rrahu", "E zhduku", "E torturoi", "E futi në burg", "E la pa ngrënë", dhe sa pak dëgjojmë: "Të dua", "Të kam në zemër", "Je shpirt njeriu".

Mungesa e dashurisë në këtë vend të vetmuar e bën personazhin më fatkeq se kurrë. Ja si e përshkruan ai momentin e përpjekjeve për t'u larguar nga kjo shpellë e nëmur: "Tërhiqem për të mos mbetur në kurthin e këtij kanioni të nëmur. Tërhiqem dhe ulërij si mamuthët, megjithëse kam bindjen se dua të dal prapë në grykë, ku kam shpresë të gjej prapë ata që dua. Provoj shanset e fundit të jetës. Kam një udhërrëfyese të fshehtë që e fsheh nga dhëmbët e bishës, DASHURINË. Ajo e di se ku më çon sepse është gjëja më e bukur që kam arritur. Ajo duket sikur fle, por, në fakt, rri zgjuar, më udhëheq me shkopin e dirigjentit, më largon nga ulërimat e lashta dhe shpreson me këmbëngulje të më kthejë përsëri në Shën Pjetër, për t'u thënë njerëzve se mesazhi i saj nuk mbaron as me Rafaelin, as me Çajkovskin, as me Brakun. Një subjekt mjaft interesant ka novela "Minosi". Minosi është një gjykatës, njeri makinë, siç e quan autori. Ka zhvilluar mijëra gjyqe, ka dënuar me mijëra njerëz të fajshëm dhe të pafajshëm, numëron dhe shënon në fletoren e tij gjyqet e pafund. Kur e zinte dhimbja e poshtër e kolitit, ai patjetër

dënonte ndonjë qyqar, që merrej më tepër me libra ose lexime të ndaluara me dhjetë ose njëzet vjet burg. Më në fund, këtë gjyqtar që vetëm njeri nuk ishte e zuri paraliza kardiake. Iu nënshtrua operacionit, por nuk mbijetoi dot. Se nuk kish si të mbijetonte sepse ky njeri nuk kishte zemër, por një kanaçe konserve në vend të saj. Subjekte të tilla të këtyre dhjetë novelave, që përbëjnë vëllimin që duken disi të kërkuara, janë, pa dyshim risi për autorin dhe letërsinë në tërësi për të shkruar jashtë kornizave dhe kërkesave të rrymave letrare në shërbim të regjimeve. Shkrimtarë të tillë si Karadaku, që kanë sjellë risi në letërsinë tonë, meritojnë vëmendje nga kritika letrare dhe, në mungesë të Lidhjes së Shkrimtarëve, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Jo vetëm Karadaku, por edhe shumë të tjerë që sot po botohen në Europë dhe po bëhen lektorë e profesorë në universitetet e Europës, meritojnë vëmendje, sepse janë truri i kombit.

Gazeta "Metropol", 29 shtator 2012

NJË ZË I FUQISHËM QË DUHET RIVLERËSUAR

Halil Rama & Sakip Cami, *Gazetarë, shkrimtarë dhe studiues*

Shkrimtarët dhe artistët e Shqipërisë si të gjithë njerëzit e kësaj bote nuk janë të përjetshëm. Dhe, si të tillë, ata duhet të vlerësohen dhe të rivlerësohen vazhdimisht. Nuk u kujtuam t'i nderonim në të gjallë të tyre Lasgushin, Kutelin, Shvarcin, Kadri Roshin, Violeta Manushin dhe viganë të tjerë të artit dhe të letërsisë shqipe. Tani që nuk i kemi midis nesh, themi me njëritjetrin: "Po si ikën kështu pa na thënë, pa marrë leje, pa i intervistuar, pa shkruar biografinë e tyre, pa i nderuar dhe vënë atje ku u takon, atje, në piedestalin e nderit, nder që e merituan me veprat e tyre?!

Sigurisht, ka shumë zëra të rinj dhe të vjetër që duhen rivlerësuar. Por kritika letrare nuk funksionon. Ajo është shndërruar në fragmentare dhe sektare ashtu si edhe politika.

Kohët e fundit u ribotua, pas pesëmbëdhjetë vjetësh, romani "Puthja e ngrirë" i Shefki Karadakut. Teksa lexon

këtë roman shumë tërheqës, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet "1000 vjet dashuri", "Argonautët", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panegjerikus", "Gjergj Elez Alia", "Sagë mbretërore" si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Shefki Karadaku është 70 vjeç dhe askush nuk është kujtuar të bëjë bilancin e këtij shkrimtari shumë prodhimtar. Këtu bën përjashtim autori Bardhyl Ajazi, cili i ka shkruar monografinë: "Elbasan i bukur, Elbasan", me syrin e poetit Shefki Karadaku, por përsëri askush nuk është ndalur të bëjë një kritikë të plotë letrare për këtë poet dhe prozator tanimë me 30 libra me poezi dhe prozë.

Duke mos qenë kritikë profesionistë, nuk marrim përsipër të bëjmë një kritikë të plotë letrare për veprat e Shefki Karadakut, të këtij shkrimtari të palodhur që krijon çdo ditë pa u mburrur, ndërkohë që krijues të tjerë mediokër paguajnë për shkrime dhe kritika plot lavdërime dhe të pamerituara. Thirrja jonë do të ishte që në shkollat e mesme dhe në universitete të mund të organizoheshin debate letrare, mbrëmje poetike me veprat letrare të Karadakut dhe të autorëve të tjerë të letërsisë shqipe. Atëherë, çdokush do të bindej se atdheu, vendlindja, kënga, gëzimi, hareja, dashuria, mirësia, janë aty, në brendësi të librave të këtij autori të talentuar. Para vitit '90, kur trokisnim në dyert e redaksisë së revistës letrare "Ylli", ato na hapeshin me dashamirësi nga poeti dhe redaktori Shefki Karadaku. Tani ndoshta është një borxh i vjetër për t'u kthyer, është një detyrim njerëzor për t'u shlyer, për të bërë një analizë të thjeshtë letrare të veprës së tij kaq të gjerë.

Që në librin e tij të parë poetik, në baladën "Shkronjat e shqipes" poeti elbasanas shkruan për mësuesin e nderuar

elbasanas, Dhaskal Todri:

"Ai në gjumë ra dhe në ëndërr
Pa Elbasanin dhe të madhen botë
Fëmijët nëpër udhë duke rendur
Me libra shtypur si në Europë"

Mjaftojnë këto katër vargje për të nxjerrë konkluzionin e poezisë së Karadakut. Në këtë poezi, do të gjesh vendlindjen e tij, Elbasanin, do të gjesh Europën, dhe dëshirën e shqiptarëve ndër shekuj për të ndjekur dhe për t'u bërë si Europa, do të gjesh rilindësin Dhaskal Todri dhe nderimin që bën autori për të, do të gjesh fëmijët shqiptarë dhe dashurinë e tyre për dituri. Pa dyshim, në këto vargje të shkëputura nga mijëra vargje të librave të tij do të dallosh qartë origjinalitetin artistik, ritmin, vargun e skalitur, mendimin e thellë, mesazhin patriotik dhe qytetar.

Po kështu, vargje brilante dhe mahnitëse do të gjesh në baladën tjetër kushtuar përsëri një tjetër bashkëqytetareje elbasanase, Haxhire Myzyrit:

"Në shtrat të virgjër
Nga dritaret
Aromë e portokajve
hidhej lehtë
Edhe mbi kaçurrelat
Si alabastër Veriu
fëshfërinte qetë-qetë
Përtej deriçkës Elbasani
priste Agimin e lirisë në çdo prag"

Dashurinë për vendlindjen dhe mallin për çdo gur të tij autori e ka shprehur në dy libra, në librin poetik "Melodité e Shkumbinit", lumit më të dashur që e ka lidhur jetën ky

qytet dhe në librin "Elbasan, dashuria ime", pa përfshirë edhe poezitë e çdo vëllimi tjetër.

Thjeshtësia, bukuria deri në modernitet, fjala e gdhendur, në çdo rresht, si në poezi dhe në prozë, mesazhi qytetar dhe patriotik që transmeton është dallimi që e bën Karadakun të qëndrojë denjësisht si një gur i madh në murin e lartë të letërsisë shqipe. Karadaku shkroi kaq shumë për Elbasanin, po Elbasani vallë, ç'bëri për Karadakun?

Karadaku shkroi kaq shumë dhe me kaq talent, duke kontribuar për letrat shqipe, po Instituti i letrave shqipe kur do të kujtohet për të?

Ai shkruan, shkruan dhe vetëm shkruan gjëra të bukura dhe me vlerë për brezat që janë sot dhe për ata që do të vijnë. Të shkruash 12 vëllime me poezi, 10 romane dhe 8 libra me novela, që të gjithë me subjekt të zgjedhur e të arrirë, nuk janë pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen, që të mos ketë "Puthje të ngrirë", që fjala e lirë të rrjedhë si "Ujëvarë", që "Gjergj Elez Alia" t'u transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij, por edhe vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që "Shkumbini" të mos shkatërrojë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që "Elbasani i bukur" të çlirohet nga ndotja dhe të shndërrohet në turizmin tradicional shekullor.

Gazeta "Republika", 18 mars 2012

Libra të autorit

Kënga e karrove të drithit - poezi - 1967
Rrugët e para - novelë - 1968
Meloditë e Shkumbinit - poezi - 1968
Kur kërcasin boçat e e pishave - novela -1973
Ylberi - poezi - 1973
Sokol Marini - poemë -1974
Mozaik Lirikash - 1976
Toka e etërve - poema - 1981
Ujëvarë - poezi - 1985
Feniks - poezi e sirtarit - 1993
Puthja e ngrirë - roman - 1993
Arkadia e largët - novela - 1994
Gjenerali nuk dëshiron të vdesë kot - novela - 1995
Lumi me njëqind zemra - poezi -1995
Njëmijë vjet dashuri - roman, pjesa e parë - 1995
Argonautët - roman pjesa e dytë - 1995
Perëndim i gjatë - poezi - 1995
Krrillat e shiut - novela - 1996
Vila e magjepsur - roman - 1996
Salamandrat - roman - 1997
Elbasan dashuria ime - poezi - 1998
Filantropi - roman -1999
Panegjerikus - roman - 2000
Letra mbretërve - novela - 2001
Etnos - poezi - 2004
Gjergj Elez Alia - roman - 2004
Sagë mbretërore - roman epope - 2006

Puthja e ngrirë - ribotim - 2008



Shefki Karadaku në moshën e rinisë

Me prindërit, nënën Adile dhe babain Xhaferr Karadaku

Familja dhe shoqëria në 75 -vjetorin e ditëlindjes së shkrimtarit

Bashkëshortët Nadire dhe Shefki Karadaku

Familja Karadaku



Me dy miqtë e tij, Bardhyl Ajazi dhe Vehap Xhindoli

Në shtëpinë e lindjes, lagjia Spahikorre, Elbasan



Gjatë një vizite në Dibër të Madhe

Me mbesën, Adela

Në Akademinë Përkujtimore me rastin e 81- vjetorit të lindjes të shkrimtarit Shefki Karadaku.

Bashkia Elbasan dhe Bordi i gazetës “Nacional”, nderojnë me mirënjohje shkrimtarin Shefki Karadaku.

Përmbajtja

I- PROFILI & REPORTAZHI & INTERVISTA.....5
Adn-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut 7
Shtëpia e shpirtit të tij... 9
Të mëdhenjtë e letrave për Karadakun.....12
Koorpusi letrar i Sh.Karadakut përbën një thesar të çmuar... 15
Kanë thënë e shkruar për poezinë dhe prozën e Karadakut 20
Akademia Përkujtimore – Elita krijuese vlerëson veprën letrare të Karadakut 22
Prof.Bujar Kapexhiu: Profili i Karadakut, në një dokumentar mjaft cilësor.....25
Karadaku lindi për të krijuar artin e tij.....28
Maksim Vinçani: Shefki Karadaku ishte mik i ngushtë i veteranëve.....31
Nderimi nga kryebashkiaku Gledi Llatja i Elbasanit dhe Qendra Kombëtare e Artit dhe Letërsisë “Nacional”32
Nadire Karadaku rrëfen 50 vitet e jetës me bashkshkortin e saj, shkrimtarin e mirënjohur Shefki Karadaku.....35

II - NGA AKADEMIA PËRKUJTIMORE.....47
Margarita Xhepa: Poezia e Shefki Karadakut ka botë, ka ritëm e muzikalitet.....49
Shkrimtari Shefki Karadaku, individualiteti krijues dhe njerëzor.....51
Kur punonim me Shefki Karadakun në revistën “Ylli” 56

Disa tipare dalluese të prozës së shkrimtarit Shefki Karadaku 58
Poezia e sendërtuar në prozën e Shefki Karadakut 62
Simbolika e romanit "Puthja e ngrirë" të Shefki Karadakut. 65
Shefki Karadaku - ky apostull i poezisë, romanit dhe filozofisë në letrat shqipe 69
Tipare të përgjithshme poetike, përftuar nga leximi i librit "Toraks", të Shefki Karadakut 76
Si e njoha poetin e shkrimtarin elbasanas Shefki Karadaku 82
Si e kujtoj vëllain tim Shefkiun 86
Fisnik në shpirt, në art i fisëm 93

III - PJESË TË ZGJEDHURA NGA KRIJIMTARIA E SHEFKI KARADAKUT 97
Karibda 99
Puthja e ngrire 114
Poezi të zgjedhura nga librat "Feniks" dhe "Toraks" 136
Atdheu 136
Jam si feniks 138
Femër! 140
Dielli çam 142
Kali që vrapon 147
Kitara e lodhur 149
Etyd dite 150
Ripërtëritje 151
Biondja 152
Erdha si Esenini 153
Sykaltër moj 154

Vargu im 155
Khajam i pavdekshëm 157
Lira 159
Sfinksi i vdekshëm 160
Lejleku ylber 161
Një mijë bebe 162
Nados 163
Jam 164
Këngëtari i reve 165
Shekulli XX 166
Adile, Adile 171
Nadires 177
Dorian, shpirt 179
Albanës 180
Në revistën "Ylli" 182
Paqe 186

IV - KRITIKA LETRARE PER VEPRËN E SHEFKI KARADAKUT 193
Lirika polisemantike e Shefki Karadakut 195
Identiteti si katarzë 198
"Sagë mbretërore", një dokument historik për tokën e lashtë – perlë e natyrës 205
Koha e akullt dhe puthja e ngrirë 212
Vetëm "1000 vjet dashuri..." 216
"11 Ditët shqiptare që tronditën botën" 219
Poeti dhe prozatori Shefki Karadaku botohet në gjuhën gjermane 221
Një zë i fuqishëm që duhet rivlerësuar 226
Libra të autorit 230

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rama, Halil

ADN-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut : monografi letrare /
Halil Rama ; red. Bujar Kapexhiu. – Tiranë : Streha, 2022
242 f. : me foto ; 14 x 20.5 cm.

ISBN 978-9928-367-09-9

1.Letërsia shqipe 2.Autorë shqiptarë
3.Kritika, interpretimi 4.Karadaku, Shefki
821.18 .09
929(496.5) [Karadaku, Shefki]